



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Raporti përfundimtar i auditimit të performancës ËPËRDORIMI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE NË BUJQËSI DHE SIGURIA USHQIMORE”





PËRMBAJTJA

<u>1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT</u>	3
<u>1.1 Konteksti i problemit social</u>	3
<u>1.2 Rëndësia e auditimit të performancës</u>	4
<u>2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM</u>	5
<u>2.1 Hyrje në subjektet nën auditim</u>	6
<u>2.2 Politikat e subjektit</u>	6
<u>2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit</u>	8
<u>2.4 Pësja në buxhet dhe PBB</u>	9
<u>2.5 Risqet e aktivitetit të subjektit</u>	10
<u>2.6 Feedback-u i subjektit në fazën studimore</u>	12
<u>3. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT</u>	12
<u>3.1 Fokusimi dhe perkufizimi i problemit</u>	19
<u>3.2 Objektivi i auditimit</u>	12
<u>3.3 Piramida e pyetjeve audituese</u>	13
<u>3.4 Kriteret</u>	16
<u>3.5 Qasja/metodologjia e auditimit</u>	17
<u>4. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE</u>	
A kanë rezultuar efektive politikat për menaxhimin e PMB-ve në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe sigurinë ushqimore për periudhën 2018-2020?.....	18
4.1 A sht hartuar një kuadër ligjor dhe strategjik i plot për regjistrimin, administrimin, tregtimin, përdorimin e PMB-ve për të garantuar sigurinë ushqimoreí í í í í í í í ..í	18
4.2 A janë zbatuar në mënyra të përshtatshme politikat për regjistrimin, administrimin, tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve për të garantuar sigurinë ushqimoreí í í í í í í í í í ..í í	38
4.3 A janë parashikuar burimet financiare dhe operacionale për realizimin e proceseve të menaxhimit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimoreí í í í í í í í í í í í í í í í í í í	45
<u>5. PËRMBLEDHJA</u>	60
<u>6.GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSIT HIERARKIKE</u>	63

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
BE	Bashkimi Evropian
3E	Ekonomiciteti, Efienca, Efektiviteti
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (The International Organisation of Supreme Audit Institutions)
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (International Standards of Supreme Audit Institutions)
SKMBZHR	Tstrategjia Kombëtare e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ARSHVMB	Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinare dhe Mbrojtjes së Bimëve
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
PMB	Produktet e Mbrojtjes së Bimëve
SU	Siguria Ushqimore
SPMB	Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve
DRAKU	Drejtoritë Rajonale të AKU
EFSA	Autoritetit Evropian për Sigurinë Ushqimore
OMGJ	Organizma të Modifikuar Gjenetiki
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
CAP	Politika e Përbashkët Bujqësore
DMB	Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (pranë ISUV)
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
SOU	Sëmundje me Origjinë Ushqimore
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
ËHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë
EU-RL	Laboratorë Evropianë të Referencës
DRAKU	Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit
KARENCA	Koha e përdorimit të PMB-ve në bimë
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
KRPMB	Komisioni i Regjistrimit të PMB
SPP	Spektori i Produkteve Plehëruese

PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

“Toka prodhon mjaftueshëm sa për nevojat e çdo njeriu, por jo për sa për babëzinë e çdo njeriu”. Gandi

Qeveria Shqiptare i konsideron Politikat për **Produktet e Mbrojtjes së Bimëve (PMB)** dhe sigurinë ushqimore si një prioritet të rëndësishëm të saj, nën përgjegjësinë e MBZHR-së, si institucioni qendror përgjegjës për krijimin e kuadrit ligjor, koordinimin e harmonizimit të legjislacionit me kuadrin ligjor të BE-së dhe zbatimin e tij.

Në fushën e sigurisë së ushqimit, çështjeve veterinarë dhe fitosanitare, përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve ka për qëllim mbrojtjen e bimëve bujqësore nga parazitët, me ndikim sa më minimal në shëndetin e njerëzve, sigurinë ushqimore, kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit. PMB ót janë një agjent kimik ose biologjik si pesticid, virus, baktere, antimikrobik ose dezinfektues. Përdorimi i pesticideve është jashtëzakonisht i zakonshëm. Termi pesticid përdoret shpesh në mënyrë sinonime me një produkt për mbrojtjen e bimëve. Llojet më të zakonshme të pesticideve janë insekticide që përdoren për të vrarë insektet, herbicide që përdoren për të vrarë barërat e këqija, brejtësit që përdoren për të vrarë brejtësit dhe fungicidet që përdoren për të shkatërruar kërpudhat, mykun dhe bakteret.

Mos përdorimi i PMB-ve, çënon sigurimin e ushqimit të nevojshëm për njerëzimin dhe nuk garanton një shëndet cilësor. Ushqimet e prodhuara pa përdorimin e PMB-ve janë më të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve si rezultat i përmbajtjes së fitotoksinave.

Përdorimi i PMB-ve ndihmon në ruajtjen e mjedisit dhe biodiversitetit, pasi për të njëjtën sasi ushqimesh nga bujqësia organike do të përdorej 65-200 % më tepër tokë e kultivuar e do kishim pasoja si: rritja e erozionit, dëmtimi i peisazhit, florës dhe faunës së egër deri në zhdukjen e shumë specieve të egra.

Përdorimi i PMB-ve është i domosdoshëm për sigurimin në sasi dhe cilësi të ushqimit me një impakt të lartë social. Asnjëherë nuk mund të garantohet që rreziku nga përdorimi i tyre është zero.

Bazuar në kuadrin rregullator kombëtar e ndërkombëtar, PMB-të janë kimikatet më të testuara dhe kontrolluara në botë, të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së jetës së njeriut.

Kostoja e prodhimit (sintetizimit) të lëndës vepruese është shumë e lartë (në vlerë që shkon deri në 200 milion euro) dhe përbëhet nga tre elementë: a) efikasiteti i lëndës kimike, zë 1/3 e kostos. b) shqyrtimi i biologjisë, zë 1/3 e kostos dhe c) testimi për mbetjet, toksikologjinë dhe mjedisin, zë 1/3 e kostos. Nisur nga kostoja shumë e lartë, prodhuesit e tyre e konsiderojnë fat, nëse dështojnë në fillim deri në mes të ciklit të prodhimit. Pra të tre elementët i shërbejnë një qëllimi: *Mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe sigurisë ushqimore.*

Por, shqetësim mbeten importi dhe përdorimi i PMB-ve të fallsifikuara dhe të paregjistruara, ku: në tregun e vendeve të BE arrin 10-15%, ndërsa në vendet Europës Lindore të BE-së është deri 25%.¹

Në Shqipëri nuk ka të dhëna zyrtare, por bazuar në kontrollat e AKU-së, si dheraportimet mediatike gjykohet se ky tregues është në nivelin e 5-10%.²

Në raportin e ri të Autoritetit Europian për Sigurinë Ushqimore (EFSA) është cituar se në mbi 96% të ushqimit, *niveli i mbetjeve të pesticideve është brenda limiteve ligjore*³ dhe ushqimi në dispozicion të konsumatorëve është i kontrolluar dhe i sigurt, por në këtë raport nuk është përfshirë Shqipëria.

Shqetësimet në rritje lidhur me aplikimin e PMB-ve dhe kërkesat në rritje për ushqim e drejtojnë vëmendjen drejt sigurisë së ushqimit, si dhe në rregullimin global të prodhimit të ushqimit. Popullsia në tërësi, individët dhe familjet si grupe sociale, në ditët e sotme janë më të shqetësuar për sigurinë e produkteve ushqimore për shkak të një serie skandalesh ushqimore që kanë ndodhur gjatë dekadave të fundit dhe për shkak të faktit se nuk ka shenja të uljes së shpeshtësisë së shfaqjes së skandaleve të ushqimit. Që sistemi i sigurisë së produkteve ushqimore të jetë sa më efikas, institucionet shtetërore dhe ato të financuara nga shteti kontribuojnë në krijimin e legjislacionit, sigurinë e vazhdueshme dhe

¹Burimi: Raportet e auditimit të BE-së.

²Dokumenta me të dhëna informative zyrtare nga SPMB në MBZHR

³Raporti i EFCA 2018

rigoroze të shëndetit dhe kontrollin e cilësisë, aplikimin e njohurive shkencore në praktikë dhe edukimin e konsumatorëve në fushën e ushqimit. Përsëritja e çështjeve që lidhen me përhapjen e ushqimit të dëmshëm për shëndetin, rastet e kontaminimit të ushqimit, shfaqjen e sëmundjeve të reja lidhur me ushqimin dhe ndotja e ekosistemeve nga substanca të huaja të cilat rezultojnë në ndotjen e zinxhirit ushqimor për shkak të ndotjes së mjedisit, ka një efekt të rëndësishëm në sjelljen e konsumatorëve në tregun e ushqimit.

Gjatë dekadave të fundit ka pasur një rritje të kërkesave për ushqime të sigurisë së lartë. Zhvillimi i shpejtë ekonomik dhe ndryshimet e fundit në zinxhirin e furnizimit ushqimor, kanë kontribuar në rritjen e interesit për çështjen e cilësisë në sektorin e ushqimit. Shqetësimi në lidhje me sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore përfshin çdo fazë të zinxhirit të prodhimit.

1.2 RËNDËSIA E AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e *ekonomicitetit*, *eficiencës* dhe *efektivitetit* dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Gjatë dekadës së fundit, KLSH i ka kushtuar gjithmonë e më shumë rëndësi auditimeve të performancës, shtimit të numrit dhe cilësisë së tyre. Misioni i KLSH si një institucion i pavarur kushtetues, është të shërbejë qytetarit shqiptar, duke qenë òagjentò i Kuvendit dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.⁴

Auditimi i PMBështë i rëndësishëm pasi synon të kontribuojë në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit, si edhe garantimin e sigurisë ushqimore në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në kushtet e përfshirjes së Shqipërisë në zhvillimet globale, rritjes së kërkesave të konsumatorit shqiptar për sigurinë ushqimore, auditimi i PMB-ve dhe i proceseve në zinxhirin e furnizimit ushqimor do të kontribuojë në rritjen e interesit publik për cilësinë e ushqimit dhe mbrojtjen e mjedisit.

2. SUBJEKTI / ET NËN AUDITIM

2.1. HYRJE NË SUBJEKTET NËN AUDITIM

Subjekte të këtij auditimi janë institucionet përgjegjëse në menaxhimin dhe administrimin e PMB-ve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin me sukses të procedurave deri në përdorimin e tyre nga përdoruesi i fundit. Vlerësimi i performancës do të bëhet për institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Drejtoritë Rajonale të AKU-së.
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.
- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
- Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve.


2.2. POLITIKAT E SUBJEKTIT

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), është ministria përgjegjëse për PMB-të, për zbatimin e politikave të zinxhirit të kontrollit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore, duke mbuluar të gjithë zinxhirin nga niveli qendror në atë lokal, si, regjistrimin, administrimin, ruajtjen dhe përdorimin e PMB-ve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin me sukses të procedurave deri në përdorimin e tyre nga përdoruesi i fundit, nëpërmjet institucioneve të specializuara të fushës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera shtetërore dhe privatët, në bazë të marrëveshjeve apo formave të bashkëpunimit, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e qeverisë në fushën e bujqësisë, harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për PMB-të, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e administrimin e tyre. Organigrama e pjesshme e strukturës përgjegjëse për PMB-të në MBZHR

⁴ Vendim i Kryetarit të KLSH nr.229, datë 31.12.2017 òPër miratimin e strategjisë së zhvillimit të KLSH- së për periudhën 2018 ó 2022ò

paraqitet si më poshtë:

Skema 1: Struktura e MBZHR-së në funksion të zinxhirit të PMB-ve



Burimi: Përpunoi grupi i auditimit, bazuar në organigramën e MBZHR-së.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) është institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e standardeve në fushën e sigurisë ushqimore në Shqipëri në përmbushje të kërkesave ligjore, ekonomike por edhe ato sociale. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është autoriteti kompetent me funksione inspektuese për menaxhimin në nivel kombëtar të fushës së sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së bimëve.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit drejton procesin e vlerësimit të riskut në fushën e ushqimeve dhe mbrojtjes së bimëve, planifikon, bashkërendon dhe realizon kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe mbrojtjes së bimëve, siguron unifikimin e praktikave të kontrollit të sigurisë së ushqimeve dhe mbrojtjes së bimëve në shkallë vendi, bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të autorizuar të sistemit të kontrollit zyrtar të ushqimeve dhe të mbrojtjes së bimëve, kryen kontrole paraprake për të vërtetuar nëse janë plotësuar kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare dhe veterinarë, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për licencimin e operatorëve të biznesit ushqimor dhe mbrojtjes së bimëve, ndalon në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, veprimtarinë e operatorëve të biznesit të ushqimit në fazat e prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe tregtimit të ushqimit, kur vërtetohet se ushqimi dhe operatorët përkatës të biznesit nuk plotësojnë standardet e sigurisë ushqimore, të përcaktuara në legjislationin në fuqi. Kryen studime shkencore të nevojshme për vlerësimin e riskut në fushën e sigurisë së ushqimit dhe të mbrojtjes së bimëve, jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore, për të siguruar veprimtarinë e komitetit shkencor dhe të paneleve shkencore, informon publikun për fushën e sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë dhe të mbrojtjes së bimëve, organizimin e punës për trajnimin e inspektorëve të kontrollit të ushqimit, mbrojtjes së bimëve dhe inuteve bujqësore.

Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU) kryejnë, kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe kontrollin zyrtar në pikën e inspektimit kufitar të produkteve të mbrojtjes së bimëve, kontrollet paraprake për përmbushjen e kërkesave tekniko-teknologjike, higjienosanitare, fitosanitare

dhe veterinare,verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për licencimin e operatorëve të biznesit të tregtimit të produkteve tëmbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, mbledhin dhe organizojnë informacion bazë, cilësor dhe sasior, në fushën e sigurisë sëushqimeve, të mbrojtjes së bimëve dhe të inputeve bujqësoredhe e përcjellin në Drejtorinë ePërgjithshme të AKU-së, sipas kërkesave të saj, ndalojnë, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, veprimtarinë e operatorëve të biznesittë ushqimit kur vërtetohet se ushqimi nuk plotëson standardet e sigurisë ushqimore, tëpërcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe përgatisin raportin vjetor për veprimtarinë e drejtorisë rajonale përkatëse, sipas formatitdhe udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV) është përgjegjës për hartimin në bashkëpunim me DSHK të strategjive të gjurmimit dhe luftimit të sëmundjeve infektive, parazitare. Ai kryen programe testuese për kontrollin e sëmundjeve epizootike, ilaçeve veterinare dhe diagnozat e sëmundjeve të përgjithshme, është përgjegjës për zbatimin e programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve, për kryerjen e testimeve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik. ISUV bashkëpunon me FAO, ËHO, OIE dhe laboratorë të tjerë reference për konfirmimin e sëmundjeve të ndryshme infektive, analizon për treguesit cilësor prodhimet me origjinë bimore të prodhuara në vend, analizon dhe certifikon prodhimet ushqimore me origjinë bimore për eksport, bën analiza për identifikimin e falsifikimeve të ndryshme, vlerëson parastandardet dhe rregullat teknike për prodhimet e reja ushqimore, kryen analiza per etiketimin e produkteve ushqimore, monitoron situatën epizootike në vend për sëmundjet virale, bakteriale, mykotike, parazitare, zoonotike dhe helmimeve, diagnostikon sëmundjet, kontrollin kimik, radiobiologjik, toksikologjik të produkteve dhe nënprodukteve ushqimore me origjinë shtazore dhe ushqimeve të prodhuara në vend ose të eksportuara.Kontrollin e mbetjeve të substancave me efekt anabolik dhe të pa autorizuara, të biopreparateve dhe të medikamenteve veterinare dhe produkteve të tyre, kontrollin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore të produkteve me origjinë shtazore e jo shtazore,trajnimin e mjekëve veterinar dhe inspektorëve të cilësisë e sigurisë ushqimore, etj.

Në lidhje me komentet dhe shpjegimet e subjektit të audituar të paraqitura pas mbajtjes së Projektraportit të Auditimit mbi Auditimin e Performancës, pas trajtimit të çdo gjetje në se ka komente për Projekt Raportin të dërguar nga KLSH me shkresën nr. 613/3 prot., datë 26.01.2022, grupi i auditimit i KLSH-së në përmbushje të pikave të programit të auditimit nr. 613/1 prot., datë 02.08.2021, me objekt “Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi dhe siguria ushqimore”, ka paraqitur disa sqarime me shkresën e protokolluar në ISUV me nr. 165 prot., dt. 21.02.2022 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 613/4 prot., datë. 23.02.2022, si më poshtë:

Pika 1. Në lidhje me TOR (detyrat) e Qendrës kombëtare të referencës laboratorike, ISUV të përshkruara në projekt raport, fq.7 ju sqarojmë se nuk ka përputhshmëri përse i përket detyrave tona institucionale. Ato i gjeni të përshkruara sipas fushave ku operon bazuar legjislacionit, si më poshtë vijon:

Ligji i Veterinarisë

Ligji i Ushqimit

Ligji i Mbrojtjes së Bimëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket sqarimeve nga ana juaj ritheksojmë se detyrat institucionale të ISUV, janë marrë nga ligji për mbrojtjen e bimëve.

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), ka mision të zbatojë politikat dhe strategjitë për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve, bimëve dhe mjedisit.

Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, kanë për detyrë:

- a) Monitorimin e gjendjes fitosanitare të bimëve, produkteve bimore dhe të objekteve të tjera brenda territorit në administrimin e tyre.
- b) Kryerjen e kontrollit fitosanitar dhe pajisjen me *ōCertifikatë fitosanitare të brendshmeō* bimët ose produktet bimore të afta për të mbartur parazitë karantinorë apo të rrezikshëm, që lëvizin brenda

territorit të vendit.

c) Kryerjen e kontrollit fitosanitar dhe pajisjen me *ōCertifikatē fitosanitare për eksportō* bimēt ose produktet bimore të afta, për të mbartur parazitē karantinorē apo të rrezikshēm, që lēvizin jashtē territorit të vendit.

ç) Kryerjen e kontrollit fitosanitar dhe pajisjen me *ōCertifikatē fitosanitare për rieksporō* bimēt ose produktet bimore në rastin e hyrjes në territorin e vendit, për qëllim rieksporiti, dhe të qëndrimit të tyre brenda vendit për më shumë se 14 ditē.

dh) Kryen monitorimin e parazitëve të bimëve të kultivuara apo spontane, si dhe të fondeve për mbrojtjen e bimëve, që planifikohen në buxhetin vjetor për ministrinë.

e) Njofton menjēherē SPMB-nē, kur në një zonē shfaqet një parazit karantinor, si dhe me shpalljen e kēsaj zone si zonē e prekur, ndjek masat për kufizimin e pērhapjes së parazitit karantinor, deri në çrrēnjosjen e tij në zonēn pērkatēsē.

ē) Ndjek zbatimin e praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve, si dhe të kriterëve të mbrojtjes së integruar.

f) Ndjek zbatimin e masave të veçanta për rastet emergjente të pērhapjes e të shtimit masiv të parazitëve, të cilēt nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të kontrollit.

g) Ofron trajnim të pērshtatshēm dhe lēshon dēshmi aftēsie për pērdorimin e PMB-ve.

gj) Ofron informacion për gjithē komunitetin e fermerëve dhe publikun, nëpērmjet medias.

h) Zbaton strategjitē afatshkurtra, afatmesme e afatgjata të veprimtarive të mbrojtjes së bimëve.

Agjencitē Rajonale të Shērbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve(MB) për shērbimin veterinar (SHV) kanë për detyrē:

a)Zbatimin e politikave të shēndetit dhe të mirēqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, të kontrollit, eliminimit deri në çrrēnjosjen e sēmundjeve infektive në kafshē, sipas pērcaktimeve të legjislacionit veterinar.

b)Zbatimin e strategjiave afatshkurtra, afatmesme e afatgjata të veprimtarive veterinare.

ç) Monitoron dhe harton raporte për situatēn epidemiologjike të sēmundjeve infektive në kafshē në territorin e caktuar, në rajonin pērkatēs, në bashkēpunim me strukturat që kryejnē veprimtari veterinare.


d) Administron mjetet financiare për mbrojtjen e shēndetit dhe të mirēqenies së kafshëve, mbrojtjen nga zoonozat.

dh) Mbron shēndetin dhe mirēqenien e kafshëve në, mbarēshtimin e tyre, prodhimin dhe ruajtjen e produkteve embrionale, tregtimin, shkēmbimin dhe transportimin e kafshëve e të produkteve embrionale, etj.

e) Mbikēqyr e kontrollon, prodhimin, ruajtjen, tregtimin dhe pērdorimin e produkteve mjekēsore veterinare, biosigurinë, të dezinfektantëve e dezinfestantëve të çertifikuar, që prodhohen ose tregtohen në territorin e Republikēs së Shqipērisēs.

ē) Mban dhe pērditēsōn regjistrin zyrtar pērlabororēt veterinarē dhe zbaton proçesin eidentifikimit e të regjistrimit të kafshëve dhe fermave blegtorale, në pērputhje me legjislacionin kombētar në fuqi.

Skema 2: Struktura funksionale e institucioneve të varēsisë për PMB-tē



2.3. RËNDËSIA E PRODUKTEVE TË SUBJEKTIT

Zhvillimet globale, ndryshimet klimatike dhe social kulturore, nxjerrin detyrë para Qeverisë shqiptare hartimin e politikave për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit si një prioritet të rëndësishëm. Këto politika janë nën përgjegjësinë e MBZHR-së, e cila është përgjegjëse për krijimin e kuadrit ligjor dhe koordinimin e harmonizimit të legjislacionit me kuadrin ligjor të BE-së. Në fushën e sigurisë së ushqimit, çështjeve veterinarë dhe fitosanitare, janë adoptuar në legjislacionin kombëtar shumë akte ligjore dhe nënligjore të BE-së dhe janë ndërmarrë disa hapa madhorë për zbatimin e tyre, në zbatim të marrëveshjeve kombëtare e ndërkombëtare për PMB-të dhe sigurinë ushqimore. Legjislacioni aktual që ka të bëjë me sigurinë ushqimore në Shqipëri, është pjesërisht në linjë me dispozitat e BE-së, dhe për këtë duhet të kryhet një rishikim i legjislacionit kombëtar, duke marrë parasysh mundësinë për t'u bërë një shtet anëtar i BE-së në të ardhmen. Ndërkohë, nga institucionet përgjegjëse të identifikohen nevojat dhe të hartohen strategji afatgjata për menaxhimin e PMB-ve, në respekt të parimeve kushtetuese të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. MBZHR dhe institucionet përgjegjëse duhet të rishikojnë strategjitë kombëtare, me qëllim orientimin e tyre drejt zhvillimeve globale.

Krijimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave në secilin hap të zinxhirit të kontrollit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore, duke mbuluar të gjithë zinxhirin nga niveli qendror në atë lokal, është thelbësor për organizimin e një sistemi eficient të kontrollit të ushqimit. Aktualisht është krijuar një sistemi IT-je për mbledhjen e të dhënave zyrtare të kontrolleve, i cili është funksional, por ende nuk është i plotë. Duhet të rriten kapacitetet inspektuese në terren nëpërmjet trajnimeve profesionale bashkëkohore. Gjithashtu, plan kontrollet shumëvjeçare dhe planet vjetore të kontrolleve në fushat e sigurisë ushqimore, mbrojtjes së shëndetit të kafshëve dhe bimëve, duhet të rishikohen në mënyrë që të jenë në përputhje të plotë me dispozitat e BE-së.

Menaxhimi i mbetjeve është një shqetësim serioz. Në këtë aspekt, një problem i madh mjedisor në Shqipëri, është mungesa e impianteve ricikluese. Ka një nevojë të theksuar për përmirësimin e mbrojtjes mjedisore duke ndërtuar impiante ricikluese, investuar në pajisje dhe ambiente për ripërpunimin e produkteve të ndërmjetme dhe mbetjeve, trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve, dhe objekte për ujërat e përdorura në thertore e pajisje për ndarjen e yndyrave në stabilimentet e përpunimit të mishit. Për këtë, MBZHR duhet të rishikojë politikat e veta lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe sigurinë ushqimore, duke futur një qasje më të integruar në punën e përafritit midis dy fushave, përfshirë një koordinim të përmirësuar brenda dhe ndërmjet ministrive me përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës, për të rritur cilësinë e jetës së qytetarëve.

Së fundi, në fushën e mbrojtjes së bimëve, ka nevojë për përmirësime të mëtejshme të sistemeve për sa i përket mirëmbajtjes, aksesit dhe qëndrueshmërisë. Duhet të shikohet me përparësi marrja e masave për identifikimin dhe krijimin e zonave të pastra, me synim rritjen e rendimentit të prodhimit të tyre dhe rritjen e sigurisë ushqimore. E rëndësishme është që me krijimin e strukturave të reja, të përmirësohet koordinimi dhe alokimi i detyrave dhe përgjegjësisë, të forcohet bashkëpunimi dhe komunikimi më i mirë midis autoriteteve kompetente të sistemit të sigurisë së ushqimit në nivel qendror, si dhe midis autoriteteve qendrore dhe zyrave lokale përgjegjëse, për zbatimin e legjislacionit.

Produktet dhe shërbimet kryesore që MBZHR dhe institucionet përgjegjëse për PMB-të, referuar kuadrit ligjor dhe Planeve të Veprimit, kanë synuar:

1. Koordinim dhe bashkëpunim të përmirësuar, përfshirë ndarjen e qartë të përgjegjësisë lidhur me sigurinë ushqimore dhe mirëqenien, midis autoriteteve përgjegjëse në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.
2. Zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare, si edhe futja e standardeve të reja, t'u japë kohë të mjaftueshme operatorëve privatë për të përmbushur standardet për të siguruar zbatim efikas.

Në lidhje me Projekt Raportin mbi Auditimin e Performancës, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 613/3 prot., datë 26.01.2022, grupi i auditimit i KLSH-së në përbushje të pikave të programit të auditimit nr. 613/1 prot., datë 02.08.2021, me objekt “Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi dhe siguria ushqimore”, ka paraqitur disa sqarime me shkresën e protokolluar në ISUV me nr. 165 prot., dt. 21.02.2022 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 613/4 prot., datë 23.02.2022, si më poshtë:

Pika 2. Fq.9, “Lidhur me produktet dhe shërbimet kryesore që MBZHR dhe institucionet përgjegjëse për PMB-të, referuar kuadrin ligjor dhe planeve të veprimit kanë synuar: “Përmirësimin e kapaciteteve të laboratorëve fitosanitar rajonal, vënia në eficiencë e tyre me synim akreditimin brenda një periudhë afatmesme”, ndërkohë që me ligjin e Mbrojtjes së Bimëve Nr.105/2016, laborator reference për fitosanitetin është përcaktuar në ISUV si rrjedhojë në produktet dhe shërbimet kryesore të MBZHR duhej të ishte i përfshirë **ngritja e kapaciteteve të laboratorëve fitosanitar në ISUV**. Mungesa e kësaj mbështetje ka sjellë kolaps në shërbimin fitosanitar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket pikës 2, sqaruar nga ana juaj, ritheksojmë se ISUV-i duhet të adresojë nevojat për ngritjen e kapaciteteve të veta në MBZHR.

3. Zhvillimin më tej të kapaciteteve administrative për të kryer inspektimet dhe kontrollet e nevojshme për përputhjen me standardet e BE-së në kuadrin e zbatimit të programeve ndërkombëtare.
4. Përmirësimin e strukturës organizative dhe shtimin e stafit të administratës fitosanitare në nivel qendror.
5. Përmirësimin e kapaciteteve të laboratorëve fitosanitarë rajonalë, vënia në eficiencë e tyre me synim akreditimin brenda një periudhe afatmesme.
6. Përditësimin e regjistrit të tregtuesve të PMB-ve.
7. Të sigurohet zbatimi i legjislacionit për sa i përket grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve të kafshëve.

2.4. PESHA NË BUXHET

Për periudhën objekt auditimi, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë akorduar fonde nga buxheti i shtetit në total 29,166 milionë lekë.

Më konkretisht: Në vitin 2018 akorduar 9,252 milionë lekë, prej të cilave 3,508 milionë lekë për shpenzime operative (shpenzime direkte për PMB-të), ose 38% e totalit të shpenzimeve. Në vitin 2019, akorduar 9,104 milionë lekë prej të cilave 2,366 milionë lekë për shpenzime operative, ose 26 % e totalit të shpenzimeve dhe në vitin 2020, akorduar 10,810 milionë lekë prej të cilave 2,455 milionë lekë për shpenzime operative, ose 22.7 % e totalit të shpenzimeve.

Tabela 1: Plani buxhetor përfundimtar për MBZHR për vitet 2018-2020.

Në milionë lekë

Emërtimi i programit	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Totali i programeve	9,252	9,104	10,810
Shpenzime per fond pagash	1,562	1,582	1,728
Shpenzime operative	3,508	2,366	2,455
Investime të brendshme	1,661	2,463	2,997
Investime të huaja	2,521	2,693	3,630

Burimi: DB në MBZHR

Shpenzimet për mbrojtjen e bimëve janë pjesë e shpenzimeve operative të programit “Siguria Ushqimore”, i cili është planifikuar në buxhet sipas tabelës tabelës së mëposhtme:

Tabela 2: Plani buxhetor përfundimtar për programin e Sigurisë Ushqimore për vitet 2018-2020*Në milionë lekë*

Emërtimi i programit	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
<i>Siguria ushqimore</i>	2,060	1,462	1,503
Shpenzime per fond pagash	751	580	614
Shpenzime operative në total	766	614	514
Shpenzime operative në Mbrojtje bimesh	0	41	72
Investime të brendshme	310	70	135
Investime të Huaja, në total, prej të cilave:	233	198	240
Grant i BE "Fuqizimi i Laboratorëve të Sigurisë Ushqimoreö	0	1,3	

Burimi: DB në MBZHR

Shpenzimet operative për vitin 2018 sipas planit buxhetor, paraqiten në vlerën 766 milionë lekë me një realizim në vlerën e njëjtë, nga të cilat 160 milionë lekë ose 21% të totalit e zënë shpenzimet për mbrojtjen e bimëve. Gjatë vitit 2018, fondet buxhetore janë rialokuar dhe plani përfundimtar i buxhetit për këtë zë rezulton në vlerën 0 lekë.

Shpenzimet operative për vitin 2019 paraqiten në vlerën 614 milionë lekë, prej të cilave 40,9 milionë lekë ose 6.6 % të totalit e zënë shpenzimet e planifikuara për mbrojtjen e bimëve. Shpenzimet operative të planifikuara dhe faktike të mbrojtjes së bimëve për këtë vit zënë 1.7% të totalit të shpenzimeve operative të planifikuara të MBZHR-së. Shpenzimet operative për vitin 2020 paraqiten në vlerën 514 milionë lekë, prej të cilave 72 milionë lekë ose 14% të totalit e zënë shpenzimet e planifikuara për mbrojtjen e bimëve. Shpenzimet operative të planifikuara dhe faktike, të mbrojtjes së bimëve, për vitin 2020, zënë **2.9 %** të totalit të të planifikuar të shpenzimeve operative të MBZHR.

Në lidhje me financimin për investime për programin "Siguria Ushqimoreö, konstatohet se, për periudhën objekt auditimi vetëm në vitin 2019 është investuar në zërin "Investime të huajaö, grand nga BE për produktin "Fuqizimi i Laboratorëve të Sigurisë Ushqimoreö në shumën 1.3 milionë lekë, ose 0.6% e totalit të investimeve të huaja për sigurinë ushqimore për këtë vit.

Spektori i PMB ka kontribuar me të ardhura në buxhetin e shtetit në total për të tre vitet objekt auditimi në shumën 19 milionë lekë, të ardhura këto nga pagesat për licencat dhe tarifat e regjistrimit të PMB-ve, prej të cilave: Në vitin 2018 janë derdhur në buxhet 4.4 milionë lekë. Në vitin 2019 janë derdhur në buxhet 5.8 milionë lekë dhe në vitin 2020 janë derdhur në buxhet 8.8 milionë lekë. Ndërsa kontributi në buxhet i PMB-ve, ka ardhur në rritje (nga 4.4 milionë lekë në vitin 2018, në 8.8 milionë lekë në vitin 2020), financimi dhe përdorimi i fondeve (plan=fakt) për zërin "Shpenzime operativeö për programin "Siguria Ushqimoreö, për periudhën objekt auditimi ka ardhur në rënie nga vlera 766 milion ose 21 % e totalit në vitin 2018 në vitin 2020 është pakësuar në vlerën 514 milion lekë ose 14 % e totalit.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave nga PMB-të për periudhën 2018-2020*Në lekë*

VITET	Lloji i të Ardhurave			Derdhur në Buxhet
	Licenca (Farmaci Bujqësore)	Rregjistrim PMB	TOTALI (2+3)	
Viti 2018	118,000	4,300,000	4,418,000	4,418,000
Viti 2019	289,100	5,494,938	5,784,038	5,784,038
Viti 2020	10,000	8,800,000	8,810,000	8,810,000
TOTALI	417,100	18,594,938	19,012,038	19,012,038

Burimi: DB në MBZHR

2.5. RISQET E AKTIVITETEVE TË SUBJEKTIT

Nëpërmjet evidentimit të pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi, për të adresuar dhe ndarë faktorët /e riskut sipas përkatësisë së tyre, ÷brenda kontrollit menaxherialë dhe ÷jashtë kontrollit menaxherialë. Këto risqe janë analizuar, evidentuar dhe klasifikuar sipas analizës SWOT, në faktorë të brendshëm (pikat e forta dhe të dobëta) dhe faktorë të jashtëm (mundësitë dhe kërcënimet). Në vijim është bërë edhe kategorizimi i risqeve në strategjik, financiar, juridik dhe operacional, për të adresuar përgjegjësitë vendim-marrëse, të ÷nputitë, ÷procesitë apo ÷outputitë, etj.



Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i Riskut	Niveli i Riskut
1	Reformat strukturore dhe burimetnjerëzore.	Operacional	Lartë
2	Kuatër rregullator i parishikuar tërësisht.	Juridik	Mesëm
3	Mungesë analizë fondesh për PMB dhe SU.	Financiar	Lartë
4	Mungesa e kapaciteteve profesionale dhe infrastrukturës së nevojshme.	Operacional	Lartë

5	Mungesa e transparencës nga institucionet përgjegjëse për sigurimin dhe besueshmërinë e informacionit.	Operacional	Mesëm
6	Mbivendosja e kompetencave midis institucioneve publike qëmerren me PMB dhe kordinimi i dobëtdërinstitucional.	Strategjik Financiar dhe Operacional	Lartë
7	Dezinformimi nëpërmjet përhapjes së thashethemeve.	Operacional	Mesëm
8	Politika konkurruese dhe kërcënuese në rajon, si edhe rënia enivelit ekonomik.	Financiar dheOperac.	I lartë
9	Ekonomia e vendit, fatkeqësitë natyrore dhe pandemitë.	Strategjik	I mesëm

2.6. FEEDBACK-U I SUBJEKTIT NË FAZËN STUDIMORE

Sa i përket, bashkëpunimit të subjekteve në auditim me grupin e auditimit për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm për fazën studimore, ka rezultuar si më poshtë:

- ✓ Nga subjekti MBZHR dhe SPMB ka patur bashkëpunim korrekt me dhënien e dokumentacionit të kërkuar.
- ✓ Subjekti AKU është treguar bashkëpunues dhe i është përgjigjur në kohë dhe me përgjegjësi grupit të auditimit.
- ✓ Subjekti ISUV është treguar bashkëpunues dhe i është përgjigjur në kohë dhe me përgjegjësi grupit të auditimit.
- ✓ Subjektet DRAKU janë treguar bashkëpunuese dhe i janë përgjigjur në kohë dhe me përgjegjësi grupit të auditimit.

3.DETAJET E AUDITIMIT

Grupi i auditimit vendosi mbi qasjen e përshtatshme për zhvillimin e këtij auditimi bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë fazës studimore, komunikimet me institucionet e përfshira në auditim. Qasjet audituese që do të përdoren:

1. Qasja cilësore duke qenë më tepër qasje problemore dhe ku problemi nuk mund të kuantifikohet, do të përdoret për atë pjesë të materialeve ku treguesit janë të pamatshëm si për shembull efektet sociale ndaj PMB dhe sigurisë ushqimore.
2. Qasja pragmatike për shkak të kompleksitetit të auditimit.

3.1. Fokusimi dhe përkufizimi i problemit

Në këtë auditim do të përqendrohemi në analizën e efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi dhe politikave që synojnë në menaxhimin e PMB-ve dhe sigurinë ushqimore. Periudha kryesore objekt auditimi do të jetë Janar 2018-Dhjetor 2020. Fokusi i auditimit krahas shqyrtimit në tërësi të zbatimit të politikave qeveritare lidhur me efektivitetin e menaxhimit të PMB-ve do të jetë veçanërisht në masat e marra në kuadrin ligjor dhe ekonomik ashtu dhe në politikat dhe aktivitetet e ndjekura nga institucionet përgjegjëse në menaxhimin me efektivitet të PMB-ve dhe garantimin e sigurisë ushqimore të qytetarëve.

3.2 Objektivat e auditimit

Auditimi me temë *“Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve/përdorimi i pesticideve në bujqësi dhe siguria ushqimore”* ka për qëllim analizën e efektivitetit të institucioneve subjekt auditimi, përgjegjëse për menaxhimin e PMB-ve dhe sigurisë ushqimore, me synim garantimin dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit, si edhe ritjen e cilësisë së jetës. Ky auditim synon të vlerësojë dhe ofrojë një tablo të qartë mbi integritetin, besueshmërinë dhe transparencën e sistemit.

Skema 3: Analiza e Programit

NEVOJAT

- Dokumente politike
- Burime njerëzore
- Infrastrukturën e nevojshme
- PMB-të
- Mjetet e komunikimit për informimin publik
- Grupet e interesit.

REZULTATET

-Qasje më të integruar në menaxhimin e PMB dhe sigurisë ushqimore, nëpërmjet koordinimit të përmirësuar të ministrive dhe gjithë aktorëve përkatës, për të rritur efektivitetin e përdorimit të tyre, gjë e cila do të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve.

-Rritja e rolit të institucioneve në përdorimin me ekonomicitet dhe eficiencë të PMB-ve, për mirëmenaxhimin e tyre dhe garantimin e sigurisë ushqimore.

OBJEKTIVAT

- Intensifikimi i procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me Acquis të BE-së.
- Përmirësimi i strukturës organizative, shtimi i stafit të administratës fitosanitare dhe garantimi i qëndrueshmërisë së tyre në nivel qendror dhe rajonal.
- Koordinim dhe bashkëpunim të përmirësuar, ndarje të qartë të përgjegjësi lidhur me sigurinë ushqimore midis autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror, rajonal dhe lokal.
- Zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore, si dhe rritje të inspektiveve operatorëve privatë për të siguruar zbatimin efikas të tyre.
- Krijimi i zonave të pastra nga sëmundjet virale dhe bakteriale për prodhimin e fidanëve dhe farave pa baktere.
- Luftimi i parazitëve të rrezikshëm të kulturave bimore.

INPUTET

- Ligji 37/2015, Marrëveshje kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e paratarrësimit (IPA II)ö.
- Ligji nr. 105/2016 për Mbrojtjen e Bimëveö;
- Ligji nr. 9863/2008 për ushqiminö, i ndryshuar;
- VKM nr. 532, datë 11.09.2018, për miratimin e rregullave për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëveö.
- VKM nr. 317, datë 15.05.2019 për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesitö.
- VKM nr. 335, datë 06.06.2018, për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëveö.


PROCESI

- Zbatimi i kuadrit rregullator.
- Zbatimi i standardeve të sigurisë ushqimore nëpërmjet PMB
- Kufizimet ndërkufitare.
- Trajnim i stafit në vijueshmëri.
- Masa mbi rritjen e ndërgjegjësimit.
- 119,716, 000 lekë fonde të dhëna për projekte të mbrojtjes së bimëve.

OUTPUTET

- Studime dhe kërkime të reja mbi PMB-të dhe sigurinë ushqimore.
- Rritja e kapaciteteve Profesionale, nëpërmjet trajnimeve.
- Bashkëpunimi me grupet e interesit.
- Bashkëveprim ndërinstitucional.
- Komunikim, publikim dhe ndërgjegjësim qytetar.

3.3. PYETJET E AUDITIMIT



Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

3.4.Kriteret

- ✓ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- ✓ Ligji nr. 37/2015, Marrëveshje kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anatarësimit (IPA II)ö.
- ✓ Marrëveshje financiare për IPARD 2018, Marrëveshje financimi 2014-2020 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian në emër të Bashkimit Evropianö.
- ✓ Rregullorja (EC) Nr 1107/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 tetor 2009 për hedhjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëveö.
- ✓ Rregullorja implementuese e Komisionit (EU) No 540/2011, datë 25.05.2011 duke implementuar Rregulloren (EC) Nr 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, lidhur me miratimin e listës së lendeve vepruese. Celex 32011R0540.
- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2014-2020.
- ✓ Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.
- ✓ Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022.
- ✓ Ligji nr. 154/2014 për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së.
- ✓ Ligji nr. 152/2013, për nëpunësin civil, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr.109/2017 për buxhetin e vitit 2018ö.
- ✓ Ligji nr.99/2018 për buxhetin e vitit 2019ö.
- ✓ Ligji nr.88/2019 për buxhetin e vitit 2020ö.
- ✓ Ligji nr.9936, datë 29.06.2018 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëö i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 105, datë 27.12.2016, për Mbrojtjen e Bimëveö.
- ✓ Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, për Bujqësinë dhe Zhvillimin Ruralö.
- ✓ Ligji nr. 27/2016, datë 17.03.2016, për menaxhimin e kimikateveö.
- ✓ Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, për inspektimin në Republikën e Shqipërisëö.
- ✓ Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008, për ushqimin, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 10390, datë 03.03.2011 për plehrat e përdorimit për bimësinë, të ndryshuar.
- ✓ Ligji nr.17, datë 17.02.2020 për produktet plehërueseö.
- ✓ Ligji nr.10081, datë 23.02.2009, për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr.709, datë 29.10.2014, për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020ö.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 532, datë 11.09.2018, për miratimin e rregullave për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëveö.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 15.05.2019, për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesitö.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 06.06.2018, për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëveö.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 25.07.2019, për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të laboratorëve të diagnostikimit të parazitëve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëveö.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1081, datë 21.10.2009, ndryshuar me VKM nr. 708, datë 09.09.2020, për organizimin dhe funksionimin e AKUö.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 146, datë 13.03.2018, për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ARSHVMBö.

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 02.09.2020, òPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve.
- ✓ Udhëzim nr. 4, datë 20.04.2018, òPër miratimin e planit kombëtar të kontroleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIKò.
- ✓ Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 72, datë 2.3.2017, òPër miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-veò, të ndryshuar.
- ✓ Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 174, datë 4.5.2020 òPër miratimin e të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-veò.
- ✓ Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 377, datë 05.09.2017 òPër miratimin e rregullores së brendshme Për organizimin dhe funksionimin e AKUò.
- ✓ Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 10.3.2020, òPër rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druriò.

3.5. Qasja/ Metodologjia e auditimit

Metodat e përdorura në metodologjinë e përzgjedhur janë si vijon:

- ✓ Rishikimi, analiza dhe vlerësimi i raporteve dhe të dhënave të mbledhura gjatë fazës studimore të auditimit.
- ✓ Intervista dhe pyetje të hapura me përfaqësuesit e MBZHR, SPMB, AKU, ISUV, ASHVMB pyetësorë me palët e interesit, përpunim dhe analizim cilësor e sasior i përgjigjeve të tyre.
- ✓ Mbledhje të dhënash nga burime sekondare dhe analizë e tyre.
- ✓ Marrje të dhënash dhe studim i tyre nga botime dhe publikime të ndryshme për PMB dhe sigurinë ushqimore.
- ✓ Analizë cilësore e të dhënave të mbledhura gjatë fazës studimore dhe politikave të ndjekura në menaxhimin e PMB dhe sigurinë ushqimore.
- ✓ Konsulta me ekspertë të fushës, jashtë subjekteve të auditimit.
- ✓ Vëzhgim në terren i gjendjes dhe situatës, për të parë nga afër problematikat që shtrohen në këtë auditim.
- ✓ Konsultim i literaturës, standardeve dhe praktikave të mira lidhur me PMB-të dhe sigurinë ushqimore.

4. 4. Shtjellimi i pyetjeve të auditimit

A kanë rezultuar efektive politikat për menaxhimin e PMB-ve në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe sigurinë ushqimore për periudhën 2018-2020?

Mesazhi i auditimit

Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pavarësisht masave të marra në funksion të arritjes së një niveli të kënaqshëm të sigurisë ushqimore, konstatojmë se reformat strukturore nuk janë kryer bazuar plotësisht në nevoja dhe kritere të qarta vlerësuese, në analiza të sakta të kostove, veçanërisht në fushën e investimeve për laboratorë dhe infrastrukturë ndihmëse në institucionet e zinxhirit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve (PMB), si dhe në praktikat më të mira. Mungesa e një planifikimi strategjik, si dhe programimi të dedikuar, të pambështetur në plane konkrete veprimi, nuk ofron garanci për monitorimin e procesit për sigurinë ushqimore. Mungesat e konstatuara në kuadrin e ri rregullator dhe në standardet e reja të sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe atë fitosanitare, rrezikojnë menaxhimin jo efektiv në shumë hallka të zinxhirit të kontrollit të PMB-ve.

Kapacitetet institucionale të MBZHR në fushën e vlerësimit të riskut dhe monitorimit të mbetjeve, kritereve mikrobiologjike dhe ndotësve, si dhe kapacitetet administrative të ISUV sa i takon inspektimeve dhe kontroleve, rezultuan të jenë të kufizuara; si pasojë, zbatimi i standardeve të sigurisë ushqimore dhe fitosanitare nuk realizohet në mënyrë të plotë. Mos përmbushja nga ana e ISUV, e detyrimit ligjor mbi marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave brenda afatit të parashikuar, ose moskryerja fare e tyre (gjatë periudhës 2018-2019), ka ndikuar që AKU të mos kryejë në kohë marrjen e masave për bllokimin e tregtimit të PMB-ve që kanë rezultuar jo konformë, duke ekspozuar kështu konsumatorin përpara riskut të përdorimit të tyre. Moskryerja e kontrollit në pikat e inspektimit kufitar (PIK) nëpërmjet sistemit online “*e-inspektim*”; mungesa e regjistrimit të fermave, mosmonitorimi i fermerëve në përdorimin e PMB-ve, si dhe mosdokumentimi nga ana e tyre i shërbimeve agroteknike për kulturat bujqësore (respektimi i karencës⁵); mungesa e udhëzimit mbi rregullat specifike për ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve, nuk i kanë shërbyer garantimit të sigurisë ushqimore.

Në kushtet kur, mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit garantohej jo vetëm, nga përdorimi i PMB-ve por dhe nga produktet plehëruese për ushqyerjen e bimëve, të cilat përmirësojnë cilësitë fiziko-kimike dhe rrisin pjellorinë e tokës, mungesa e një sektori të dedikuar për produktet plehëruese si dhe e akteve nënligjore në këtë fushë, ka lënë jashtë vëmendjes, monitorimin e këtij procesi duke mbartur risqe për garantimin e sigurisë ushqimore dhe atë mjedisore.

Reflektimi i detyrave të vendosura në progres raportet e BE ósë, në lidhje me PMB-të, nuk ka ndikuar shumë në parandalimin e regjistrimit të PMB-ve helmuese e shumë helmuese, si rezultat i reformave institucionale joefektive, përdorimit dhe menaxhimin joeficient të kapaciteteve institucionale përgjatë gjithë zinxhirit të monitorimit.

⁵Koha e nevojshme e rritjes së bimës

Në lidhje me Projekt Raportin mbi Auditimin e Performancës, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 613/3 prot., datë 26.01.2022, grupi i auditimit i KLSH-së në përmbushje të pikave të programit të auditimit nr. 613/1 prot., datë 02.08.2021, me objekt “Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi dhe siguria ushqimore”, ka paraqitur disa sqarime me shkresën e protokolluar në ISUV me nr. 165 prot., dt. 21.02.2022 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 613/4 prot., datë. 23.02.2022, si më poshtë:

Pika 4. Mesazhi i auditimit ‘Shtjellimi i pyetjeve dhe nënpyetjeve, rreshti 10 fq.18 ku thuhet: “mosfunksionimi i laboratorëve të analizave cilësore të PMB, si dhe ai i mbetjeve të tyre në bimë dhe produktet me origjinë bimore të ISUV dhe AKU, sqarojmë se: ISUV ka kapacitet teknik të plotë në funksion të analizimit të PMB dhe të mbetjeve të tyre në bimë dhe produkte bimore. Gjatë viteve objekt auditimi (2018-2019) nuk janë realizuar analizat cilësore të PMB-ve pasi nuk e kemi patur të mundur të parashikonim kite-reagente, bazë materiale laboratorike të domosdoshme për këtë proces analitik. Këto analiza janë të përfshira në Planin me Bazë Risku vjetor të AKU i cili nuk është parashikuar në buxhetin e miratuar nga Autoriteti Kompetent për ISUV si institucion varësie. Gjithashtu dhe plani lidhur me kampionet e PMB-ve ka ardhur i vonuar në ISUV. Theksojmë se ISUV si një institucion buxhetor varet nga Prokurimet publike dhe si i tillë parashikimet i mbyll në fillim të çdo viti kalendarik.

Përsa u perket analizave në kuadër të kontrollit të mbetjeve të PMB në produktet me origjinë bimore theksojmë se ISUV ka kapacitet të plotë analitik dhe e ka realizuar planin e miratuar nga autoriteti kompetent.

Lidhur me gjetjen në fq.35 ku citohet “Për shkak të mos kërkesës dhe plotësimit nga ISUV të buxhetit të nevojshëm për zbatimin e këtij detyrimi ligjor në programimet buxhetore vjetore”, theksojmë edhe njëherë se ISUV është institucion zbatues i politikave dhe programeve të ministrisë dhe i mbështetur 100% me buxhet nga MBZHR, pra nuk harton apo miraton programe kontrolli. ISUV ka kërkuar vazhdimisht që cdo plan kontrolli të shoqërohet me buxhetin përkatës për realizimin e tij. Pra, edhe një herë ju bëjmë me dije që në asnjë vit plani vjetor me bazë risku i cituar për tu zbatuar nga ISUV në shumë lloje analizash përfshirë analizat cilësore të PMB-ve nuk është shoqëruar me buxhetin përkatës për realizimin e tij, të miratuar nga MBZHR.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket sqarimit të mësipërm nga ana juaj, theksojmë se, ne kemi evidentuar mungesën e kryerjes së këtyre analizave dhe kemi adresuar zgjidhjen e problemit përmes bashkëpunimit ndërinstytucional. Lidhur me pretendimet tuaja sqarojmë se është përgjegjësi institucionale përmbushja e detyrimeve ligjore.

4.1. Nënpyetja e parë me komponentët e saj

A është hartuar një kuadër ligjor dhe strategjik i plotë për regjistrimin, administrimin, tregtimin, përdorimin e PMB-ve për të garantuar sigurinë ushqimore?

4.1.1. Sa efektiv është kuadri rregullator për PMB -të?

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, II, për periudhën 2015-2020, për arritjen e vizionit “**Shqipëria–një demokraci në forcim, në rrugën e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkurruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme dhe me garanci për të drejtat themelore dhe liritë e njeriut**”, janë përcaktuar tre shtyllat kryesore të zhvillimit:

- Nxitja e një rritje ekonomike të qëndrueshme që nuk dëmton mjedisin si dhe e njëtrajtshme gjatë gjithë periudhës deri në vitin 2020 e siguruar përmes, një stabiliteti makroekonomik në rritje, një mjedisi biznesi më konkurrues dhe novator, përdorimit më të qëndrueshëm të

burimeve të cilat do të mbështeten në historinë e një rritjeje ekonomike të Shqipërisë gjatë dy dekadave të fundit.

- Përdorimi i pasurive të krijuara nga kjo periudhë e gjatë rritjeje dhe sigurimi i mirëqeniesmë të madhe për qytetarët në një shoqëri me kohezion në rritje e cila kujdeset për nevojat dhe të drejtat e të gjithë qytetarëve të saj.
- Të qënit në gjendje të demonstrojë deri në vitin 2020 përpara partnerëve në BE se, institucionet dhe shoqëria shqiptare kanë përparuar mjaft në rrugën e përfundimit me sukses të negociatave që Shqipëria të bëhet një anëtar i plotë i Bashkimit Evropian.

Në këtë strategji, janë përcaktuar dhe objektivat strategjike në fushën e bujqësisë, lidhur me menaxhimin e PMB-ve dhe sigurinë ushqimore, me synim, fuqizimin e konsumatorëve dhe sigurinë e tyre, besimin në një treg të sigurt dhe konkurrues, ku ata të marrin pjesë aktivisht duke ushtruar të drejtat dhe pushtetin e tyre për të bërë zgjedhje të mirë-informuara.

Menaxhimi i PMB-ve dhe rritja e sigurisë ushqimore të konsumatorëve do të arrihet nëpërmjet:

- Kontrollit të produkteve ushqimorë sipas parimit *ōnga ferma në tavolinë* me anë të harmonizimit me legjislacionin e BE-së.
- Mekanizmave të sigurimit të mbrojtjes së bimëve.
- Rritjes së inspektimeve zyrtare të produkteve ushqimore me synim pakësimin e mungesës së konformitetit dhe zbatimin e sistemit të gjurmueshmërisë.
- Forcimit të kapaciteteve administrative dhe profesionale të mbrojtjes së bimëve në nivel qendror (krijimit të autoritetit kompetent si strukturë më vete dhe me staf të plotë).
- Forcimit të kapaciteteve administrative dhe profesionale të AKU-së dhe strukturës së tij operacionale.
- Forcimit të kapaciteteve administrative dhe profesionale të ISUV-it, etj, nëpërmjet: trajnimit të kapaciteteve njerëzore në laboratorët rajonalë dhe pikat e inspektimit kufitar, unifikimit të metodave analizës së produkteve ushqimore, forcimit të ISUV-it si qendër kombëtare laboratorike referimi, duke kryer njohjen e rezultateve në nivel evropian.
- Arritjes së njohjes nga BE-ja të raporteve të testeve të laboratorëve testues, të organeve të çertifikimit dhe inspektimit të akredituar në Shqipëri.

Gjatë këtyre viteve, Shqipëria ka zbatuar disa reforma në fushën e menaxhimit të PMB-ve dhe mbrojtjes së konsumatorit, për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve. Këto politika kanë synuar ofrimin e produkteve më të sigurta për konsumatorin dhe rritjen e transparencës së praktikave tregtare. Në kuadër të funksionimit të një mjedisi tregu të sigurt dhe konkurrues, nga institucionet përkatëse janë miratuar aktet ligjore dhe nënligjore në fushat e menaxhimit të PMB-ve, sigurisë ushqimore, në fushën e veterinarisë dhe fitosanitare, të cilat synojnë përafrimin me standardet e BE-së.

Shqipëria si anëtare e organizmave ndërkombëtare është e detyruar të respektojë masat sanitare dhe fitosanitare të saj, në lidhje me mallrat bujqësore që kalojnë kufijtë, certifikatat, dhe ato sanitare, në lidhje me dëmtuesit dhe shkaktuesit e sëmundjeve, etj.

Politikat për menaxhimin e PMB-ve, me qëllim rritjen e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit, si një prioritet i rëndësishëm, janë nën përgjegjësinë e MBZHR-së, e cila gjatë periudhës objekt auditimi, siç ka qenë e përcaktuar dhe në SKMBZHR, II, 2015-2020 ka patur për të realizuar disa nga aktivitetet kryesore të parashikuara në fushën e çështjeve fitosanitare dhe të mbrojtjes së bimëve, konkretisht:

- Përafrimin e legjislacionit bazuar në planin e detajuar të veprimit, duke përfshirë miratimin e një ligji të ri për mbrojtjen e bimëve, synon përafrimin e kuadrit ligjor me Acquis të BE-së.
- Përmirësimin e strukturës organizative dhe shtimin e stafit të administratës fitosanitare në

nivel qendror.

- Forcimin e laboratorëve fitosanitarë me stafin dhe pajisjet e nevojshme, me synimin e akreditimit të tyre, si dhe krijimin e një regjistri të prodhuesve dhe tregtuesve të bimëve dhe produkteve me origjinë bimore.
- Krijimin e një zone të pastër nga sëmundjet për prodhimin e fidanëve në rrethin e Korçës, si qendra më e rëndësishme për prodhimin dhe shpërndarjen e materialit për mbjelljen e pemëve frutore.
- Krijimin e pemëtoreve òmëmëo me qëllim garantimin e materialit për mbjelljet, të cilat nuk kanë sëmundje.
- Luftimin e parazitëve të rrezikshëm të kulturave bimore, të tillë si karkalecat, minjtë e arave dhe miza e ullirit.

Për të realizuar qëllimin e deklaruar, për t'u bërë shtet anëtar i BE-së, MBZHR-ja duhet të hartojë dhe zhvillojë politika që të jenë në harmoni me parimet kryesore të politikave të ardhshme të BE-së, PPB-në (*Politika e Përbashkët Bujqësore*) dhe politikat e para-aderimit IPARD (Instrumenti për Asistencë Paraaderimit për Zhvillimin Rural), të afta për të përballuar presionin e konkurrencës dhe për të përmbushur kërkesat e tregut të BE-së, përmes një shfrytëzimi të qëndrueshëm të burimeve dhe zonave rurale produktive, duke ofruar aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi më të mirë jete për qytetarët.

Në Strategjinë Kombëtare të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (SKMBZHR), bazuar në objektivat strategjike të përcaktuara për periudhën 2015-2020, do të miratohej një plan i hollësishëm veprimi për sigurinë ushqimore dhe fitosanitare. Plani i veprimit do të përfshinte prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme, në mënyrë që të arrihej përshtatja graduale dhe harmonizimi i plotë, duke përfshirë edhe kapacitetin e zbatimit. Ky plan veprimi do të përcaktonte dhe afatet kohore të rishikimit të legjislacionit dhe përafrimin me atë të BE-së, do të garantonte dhe monitorimin e zinxhirit në përdorimin e PMB-ve, duke filluar nga: shitja me pakicë, libri i fermës deri të përdoruesi i fundit, i cili duhet të jetë i trajnuar dhe i pajisur me Dëshmi Aftësie si përdorues i PMB-ve òhelmueseò.

Ky është një proces në vazhdimësi që kërkon bashkëpunim të ngushtë institucional me ministrinë dhe institucionet përkatëse, me njësitë e vetqeverisjes vendore si edhe të gjithë grupet e tjera të interesit, të përfshirë në të. Nga çfarë konstatohet në kuadrin rregullator të MBZHR-së dhe institucioneve të varësisë, mund të themi se ka një progres të arritur në hartimin e dispozitave, por MBZHR nuk ka hartuar një plan konkret veprimi që të përfshijë prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme lidhur me menaxhimin e PMB-ve, që garanton përshtatjen graduale dhe harmonizimin e plotë, duke përfshirë edhe kapacitetin e zbatimit. Pa një planifikim, programim dhe buxhetim, nuk mund të ketë efektivitet të politikave për menaxhimin e PMB-ve, si edhe përafrim të legjislacionit me Acquis të BE-së dhe, për më tepër, të ndiqet ky proces nga zbatimi efikas i tyre në praktikë.

Në progres raportin e BE-së 2019⁶ përcaktohet se ulja e buxhetit kombëtar të bujqësisë është shqetësuese, pasi IPARD II nuk duhet të shihet si zëvendësim i mbështetjes kombëtare. Në këtë raport vihet në dukje mungesa e një strategjie të qartë të miratuar për të përfunduar reformën e sistemit këshillimor të fermave, edhe pse ky shërbim këshillimor në nivel rajonal u riorganizua në katër rajone kryesore, me VKM-në Nr. 146, datë 13.3.2018 òPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëveò.

⁶<http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/63-progres-raportet> [http://www.instat.gov.al/al/integrimi/dokumente/dokumentet-e-be-s%C3%AB/Progres raporti i KE-së 2019](http://www.instat.gov.al/al/integrimi/dokumente/dokumentet-e-be-s%C3%AB/Progres%20raporti%20i%20KE-s%C3%AB/2019)

1. Gjetje nga auditimi

Bazuar në Strategjinë Kombëtare II, të MBZHR2015-2020 (SKMBZHR), konstatoam se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka hartuar një plan konkret veprimi që të përfshijë prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme lidhur me menaxhimin e PMB-ve, në mënyrë që të arrihet përshtatja graduale dhe harmonizimi i plotë me òacquis të BE-së, duke përfshirë edhe kapacitetet e zbatimit. Edhe pse shërbimi këshillimor i fermave, në nivel rajonal u riorganizua në katër rajone kryesore, ende nuk ka një strategji të qartë të miratuar për të përfunduar reformën e këtij sistemi.

1. Konkluzioni

Pa një planifikim strategjik, programim dhe buxhetim për PMB-të, detajuar në plane konkrete të veprimit, me afate kohore të përcaktuara nuk mund të ketë efektivitet të politikave për menaxhimin e PMB-ve, si edhe përafrim të legjislacionit me Acquis të BE-së. Në mungesë të një planifikimi strategjik, risqet që situatat e fatkeqësive natyrore, të mos menaxhohen si duhet dhe sipas nevojave përkatëse, për t'u ardhur në ndihmë fermerëve dhe qytetarëve, rriten.

1.1 Rekomandimi

MBZHR dhe institucionet e varësisë të marrin masa që të hartojnë dokumentin strategjik për vitet në vijim, i cili të shoqërohet me një plan konkret veprimi për menaxhimin e PMB-ve, bazuar dhe mbështetur në objektivat strategjike të zhvillimit dhe integritit të vendit drejt BE-së, si edhe referuar rekomandimeve të lëna në Progres raporti i Komisionit Evropian.

Brenda datës 30.09.2022

Siç dihet, në fillim të muajit Mars 2020, Evropa u bë qendra globale e pandemisë dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) klasifikoi shpërthimin e COVID-19 si një pandemi globale në botë. Në këto kushte më 24 Mars 2020 me VKM Nr.243/2020 Qeveria Shqiptare shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Në fushën e bujqësisë, pezullimi i aktivitetit të bizneseve, mbyllja e kufijve, pezullimi i transportit dhe kufizimet e tjera shtuan vështirësitë dhe kostot për fermerët, gjë e cila është vënë në dukje nga mediat audio vizive dhe informacionet e raportuara nga grupet e ndryshme të interesit. (Ënputet bujqësore ku përfshihen farërat, plehrat, pesticidet dhe të tjera, u siguruan me vonesë dhe jo brenda kohës së caktuar.

Prodhimi i drithërave, si gruri dhe misri u ndikuan negativisht nga COVID-19 për shkak të moskryerjes në kohë të shërbimeve të pranverës dhe furnizimit të pamjaftueshëm me bazën materiale për prodhimin e kulturave bujqësore.⁷ Sektori i bujqësisë u përball me një sërë rreziqesh që kërcënuan prodhimtarinë, gjenë e gjallë dhe infrastrukturat mbështetëse të fermave. Dukuri natyrore si breshëri, ngricat, përmbytjet, stuhitë, thatësirat e temperaturat ekstreme, vërshimet e insekteve, sëmundjet e ndryshme të bimëve (epifiti), janë rreziqe kërcënuese për sistemin bujqësor.⁸ Të gjitha këto reflektohen në probleme social ekonomike, jo vetëm për fermerët (kosto të shtuara), për punëtorët të cilët nuk mund të sigurojnë të ardhurat për familjet e tyre, por dhe për të gjitha grupet e interesit që bashkëpunojnë në këto veprimtari. Duke qenë se Shqipëria është një vend që i ka potencialet kryesisht të bujqësisë dhe turizmi, edhe pse strategjitë e menaxhimit të rrezikut dhe krizave në nivel të BE-së, nuk janë aktualisht të integruara në CAP (Politika e Përbashkët Bujqësore)⁹, përfshirja e qeverisë është thelbësore pasi situata të tilla janë të papërballueshme nga fermerët vetëm me subvencione qeveritare dhe/ose

⁷<https://faktoje.al/hallet-e-padukshme-te-fermerëve-te-Korçës-në-kohë-pandemie/>.

⁸<https://www.monitor.al/òSigurimi-i-fermerëve-a-mund-të-bëhet-dhe-si..?>

⁹ European Commission, Agriculture Directorate-General. (2006). Agricultural Insurance Schemes. Final Report. Administrative arrangement n °.agri-2005-0321....between DG Agriculture (dg agri) and DG Joint Research Centre. òAgricultural insurance schemes for the development of rural economyö.

risigurime publike për zhvillimin e sigurimeve dhe në fushën e bujqësisë.

Komisioni Evropian ka përpunuar disa dokumente të cilat shqyrtojnë menaxhimin e riskut të sistemeve bujqësore në vendet evropiane, rreziqet dhe menaxhimin e krizave në raste fatkeqësish natyrore. Bazuar, në këto politika të BE¹⁰, në disa nga praktikat më të mira botërore, si edhe në SKMBZHR, II, 2015-2020¹¹ ku një nga objektivat e parashikuara ka qenë dhe Sistemi i Sigurimeve në Bujqësi, (i përcaktuar), MBZHR me mbështetjen dhe të donatorëve duhet të shikojë mundësinë e ngritjes së disa sistemeve të lehtësuara sigurimesh në bujqësi. Kjo duhet të arrihet në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe me institucionet e tjera qendrore dhe donatorët.

Gjykuar në sa më sipër, në kushtet e fatkeqësive natyrore dhe në zbatim të pikës 2 të Nenit 22 të Ligjit Nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civile: *“Çdo ministër dhe drejtues institucioni qendror është përgjegjës për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore apo të kompetencave të tyre. Ministrinë dhe institucionet qendrore kanë këto detyra: a) hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe e dërgojnë atë në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analize dhe planifikimi”*. MBZHR nuk rezultoi të ketë një plan të emergjencave civile, për t’u ardhur në ndihmë fermerëve, konsumatorëve, operatorëve të biznesit, etj, me qëllim zvogëlimin e pasojave negative të diktuar nga rreziqet dhe menaxhimi i krizave në raste fatkeqësish natyrore, gjë e cila nuk është realizuar as në fazë projekti, siç ka qenë e parashikuar dhe e përcaktuar në SKMBZHR, II, 2015-2020. Ky është një proces në vazhdimësi, por nga auditimi rezulton se një plan i tillë nuk është hartuar nga institucionet përkatëse.

2. Gjetje nga auditimi

Në zbatim të pikës 2, të nenit 22, të Ligjit nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civile, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural **nuk** ka një plan të emergjencave civile, ku të përcaktohet menaxhimi i PMB-ve, për t’u ardhur në ndihmë fermerëve dhe konsumatorëve, në raste fatkeqësish natyrore dhe pandemive fitosanitare, për të zvogëluar pasojat negative të diktuar, gjë e cila **nuk** është realizuar, as pjesërisht në fazë projekti, siç ka qenë e parashikuar në SKMBZHR 2015-2020, dhe as në ndonjë akt tjetër nënligjor.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 22-23 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

2. Konkluzioni

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me institucionet e varësisë, në mungesë të planit të veprimit, rrezikon që t’u vijë në ndihmë fermerëve në mënyrë të strukturuar dhe efektive, si dhe mbështetur mbi plane dhe buxhete konkrete, për të zvogëluar pasojat negative të diktuar në raste fatkeqësish natyrore dhe pandemish fitosanitare.

2.1 Rekomandimi

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të hartojë planin e emergjencave civile, për t’u ardhur në ndihmë fermerëve dhe konsumatorëve, për të zvogëluar pasojat negative të diktuar në raste fatkeqësish natyrore dhe pandemish fitosanitare.

Brenda datës 30.09.2022

Në zbatim të objektivave strategjike është hartuar Ligji nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëve, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Por vihen re vonesa në miratimin e disa akteve nënligjore si dhe disa të tjera që janë në proces, nuk janë miratuar ende, gjatë periudhës objekt auditimi.

¹⁰ <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/handle/JRC51982>

¹¹ Vendim i KM nr. 709, datë 29.10.2014 òPër miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020 Paragrafi 3.2.4.

Konkretisht:

-Bazuar në pikën 7, të nenit 23, të Ligjit nr. 105/2016 *oPër mbrojtjen e bimëve*, Udhëzimi i ministrit *“Për kriteret teknike të mjeteve dhe makinerive, të cilat përdoren për trajtimet me PMB”*, nuk është hartuar dhe është parashikuar të hartohet në vitin 2023.

-Bazuar në pikën 5, të nenit 14, të Ligjit nr. 105/2016 *oPër mbrojtjen e bimëve*, *“Rregullat për inspektimin karantinor fitosanitar”*, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. Kjo VKM nuk është rishikuar bazuar në ndryshimet ligjore. Është në fuqi VKM Nr.750, datë 14.07.2010 *oPër miratimin e rregullave të inspektimit karantinor fitosanitar*, ndërkohë që institucionet përkatëse kanë pësuar dhe ndryshime strukturore, diktuar nga reformat e ndryshme. Nga eprorët në MBZHR pretendohet se përafrimi i rregullores së re të BE-së në PKIE është parashikuar në vitin 2023.

-Bazuar në pikën 3, të nenit 15, të Ligjit nr. 105/2016 *oPër mbrojtjen e bimëve*, *“Rregullat për mënyrën e njoftimit të shërbimit të mbrojtjes së bimëve në rastin e parazitëve”*, përcaktohen me udhëzim të ministrit, i cili nuk është miratuar me pretendimin se nuk ka patur raste emergjente të përhapjes së parazitëve, të cilat nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të kontrollit. Në detyrat funksionale janë të përcaktuara monitorimi dhe kontrolli i parazitëve, ndjekja e masave të veçanta për rastet emergjente të përhapjes dhe shtimit masiv të parazitëve, etj. Në këto kushte duhet të ketë një plan veprimi dhe një metodologji, si edhe rregullat për mënyrën e njoftimit të shërbimit të mbrojtjes së bimëve në rastin e parazitëve që mund të rishikohen rast pas rasti, për parazitë të ndryshëm, veçanërisht për parazitët karantinor, me qëllim ruajtjen e prodhimit dhe reduktimin e kostos së fermerëve si dhe të pasojave negative që shoqërojnë këto dukuri.

-Në zbatim të pikës 4, të nenit 6, të Ligjit nr. 105/2016 *oPër mbrojtjen e bimëve*, citohet: *“Tarifat e shërbimeve dhe të analizave, që kryhen nga laboratorët kombëtarë të referencës dhe laboratorët e miratuar të kontrollit”*, përcaktohen me udhëzim të ministrit. Ky udhëzim nuk është miratuar.

-Bazuar në Ligjin nr. 105/2016, *“Për Mbrojtjen e Bimëve”*, Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Nr.1, datë 10.03.2020 *“Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri*, ka dalë katër vite më vonë pas daljes së ligjit, ndërkohë që inspektorët e mbrojtjes së bimëve dhe inpueteve bujqësore në pikat e inspektimit kufitar (PIK), kryejnë kontrollet e ambalazheve dhe paletave prej druri, në të cilin janë të përcaktuara modelet e vulave që duhet të shoqërojnë materialet prej druri.

-Bazuar në pikën 3, të nenit 36, KREU X, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *“Për ushqimin”*, të ndryshuar, mënyra e etiketimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Ky vendim është i përafruar pjesërisht me direktivat e BE-së dhe ka dalë me dy vite vonë pas daljes së ligjit. (VKM Nr. 434, datë 11.07.2018 *“Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”*)¹². Pra siç vihet re ka një vonë në miratimin e akteve nënligjore nga periudha e daljes së ligjit, gjë e cila ka bërë që të mos ketë transparencë, rritje besimi dhe sigurie në përdorimin si të PMB-ve ashtu dhe produkteve ushqimore.

-Bazuar në pikën 2, të nenit 7, të Ligjit nr. 105/2016 *oPër mbrojtjen e bimëve*, citohet: *oÇdo bimë ose produkt bimor, i aftë për të mbartur parazitë karantinorë apo të rrezikshëm, që lëviz brenda territorit të vendit, duhet t'i nënshtrohet kontrollit fitosanitar dhe duhet të pajiset me*

¹² Ky vendim është përafruar pjesërisht me: Rregulloren (BE) nr. 1169/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 tetor 2011, *oPër dhënien e informacionit ushqimor për konsumatorët*, që ndryshon rregulloret (KE) nr. 1924/2006 dhe (KE) nr. 1925/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon direktivën e komisionit 87/250/KEE, direktivën e Këshillit 90/496/KEE, direktivën e komisionit 1999/10/KE, direktivën 2000/13/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, direktivat e komisionit 2002/67/KE dhe 2008/5/KE, dhe rregulloren e komisionit (KE) nr. 608/2004; CELEX 02011R1169; FZ L 304, 22.11.2011, f. 18.

“Certifikatë fitosanitare të brendshme””, të lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë Drejtorisë Rajonale Bujqësore, ose “Pasaportë bimore”, lëshuar nga prodhues të autorizuar. MBZHR nuk ka hartuar udhëzimin për kushtet dhe kriteret për autorizimin e prodhuesve të bimëve dhe produkteve bimore, pasi në Republikën e Shqipërisë nuk ka prodhues të autorizuar. Prodhuesit e autorizuar janë fermerët, të cilët trajnohen dhe autorizohen për lëshimin e ÷Pasaportës Bimoreë. Nisur nga fakti që akoma nuk është implementuar ÷Pasaporta Bimoreë, rrjedhimisht nuk ka as prodhues të autorizuar. Në përgjigjet e ardhura nëpërmjet pyetësorëve, pretendohet se edhe me miratimin e ÷Pasaportes Bimoreë, periudha e implementimit do kërkojë kohë, ndërkohë që të gjitha detyrimet që mbulon ÷Pasaporta Bimoreë aktualisht mbulohej nga ÷Certifikata Fitosanitare e Brendshmeë. Ligji aktual në fuqi nuk ka dispozitë autorizuese për nxjerrjen e aktit nënligjor për regjistrimin e përdoruesve profesionist, regjistrimi i të cilëve është i lidhur me pasaportën bimore.

-Bazuar në pikën 7, të nenit 7, të Ligjit nr. 105/2016 ÷Për mbrojtjen e bimëveë, citohet: “Rregullat e praktikave të mbrojtjes së bimëve, si dhe hartimi i praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve dhe i kriterëve të mbrojtjes së integruar hartohen nga DMB-të dhe miratohen me urdhër të ministrit, me propozim të SPMB-së”. Gjatë periudhës objekt auditimi këto struktura kanë pësuar ndryshime dhe nuk ka urdhër të miratuar deri sot, pasi Ligji nr. 105/2016 ÷Për mbrojtjen e bimëveë nuk ka parashikuar afat konkret. Në përgjigjet e ardhura nga institucioni shprehen se aktualisht janë në proces draftimi.

-Bazuar në pikat 1 dhe 3, të nenit 8, të Ligjit nr.105/2016 ÷Për mbrojtjen e bimëveë, citohet se: “Masat e veçanta për rastet emergjente të përhapjes e të shtimit masiv të parazitëve, të cilët nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të kontrollit, si dhe mobilizimi për këtë qëllim i subjekteve shtetërore e private, të cilat zotërojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore e materiale”, si edhe “Rregullat në lidhje me masat e veçanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollin e parazitëve” përcaktohen me urdhër dhe udhëzim të ministrit. Këto akte nënligjore nuk janë miratuar gjatë periudhës objekt auditimi dhe në vijim deri më sot.

-Bazuar në pikën 4, të nenit 11, të Ligjit nr. 105/2016 ÷Për mbrojtjen e bimëveë, citohet: “Rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të bujqësisë dhe ministrit përgjegjës për mjedisin”. Ky udhëzim nuk është miratuar.

-Bazuar në pikën 3, të nenit 12, të Ligjit nr.105/2016 ÷Për mbrojtjen e bimëveë citohet: “Procedurat, kushtet dhe kriteret për pajisjen me “Pasaportë bimore”, përcaktohen me udhëzim të ministrit”, i cili nuk është miratuar deri më sot.

-Rregullat e përgjithshme për klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve zbatohen në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave që rregullon klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e kimikateve. Rregullat specifike për ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve përcaktohen me udhëzim të ministrit. VKM Nr. 488 datë 29.06.2016, miratuar nga Ministria e Mjedisit ka dalë përpara daljes së Ligjit nr. 105/2016, i cili është miratuar në datën 27.10.2016. Udhëzimi i Ministrit ÷Për rregullat specifike për ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-veë është parashikuar të miratohet në vitin 2021.

3. Gjetje nga auditimi

Në nenin 31, të Ligjit nr. 105/2016 ÷Për mbrojtjen e bimëveë, janë përcaktuar aktet nënligjore që do të hartohen në zbatim të tij, por **nuk** janë përcaktuar afatet kohore për miratimin e tyre. Gjithashtu, nuk është përcaktuar përshtatshmëria për të siguruar periudhat e tranzicionit mjaftueshëm të gjata, deri në daljen e nismave të reja rregullatore.

3. Konkluzioni

Mospërcaktimi i afateve kohore për miratimin e akteve nënligjore në nenin 31 të Ligjit nr. 105/2016 ÷Për mbrojtjen e bimëveë, ka sjellë vonesa në hartimin e këtyre akteve, nga periudha e daljes së ligjit, deri edhe mungesën e disa prej tyre. Sa më sipër rrezikon të çënojë përmbushjen

me sukses të qëllimit të vetë ligjit për të mbrojtur dhe parandaluar përhapjen e parazitëve tek bimët dhe produktet bimore, si dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Mungesa e kuadrit të ri rregullator dhe e standardeve të reja të sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare, të shoqëruara me menaxhim jo me efektivitet të zinxhirit të kontrollit të PMB-ve, si dhe nuk ka ndihmuar grupet e interesit për të përmbushur standardet dhe kapacitetet e nevojshme për inspektime dhe kontrole funksionale dhe efikase.

3.1 Rekomandimi

MBZHR, të marrë masa të rishikojë nenin 31, të Ligjit nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëve, për të përcaktuar afatet kohore në miratimin e akteve nënligjore, si dhe të hartojë aktet e reja nënligjore për menaxhimin e zinxhirit të kontrollit të PMB-ve, me qëllim parandalimin në përhapjen e parazitëve tek produktet bimore për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Brenda datës 30.09.2022

-Në nenin 1, të Ligjit nr. 16/2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, òPër ushqimin, të ndryshuar, citohet: *“Kudo në ligj, emërtimet “ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit” dhe “Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”, zëvendësohen përkatësisht me emërtimet “ministri përgjegjës për ushqimin”, “institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë” dhe “instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë”*. Në bazën ligjore të fushës së vet të përgjegjësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka një mospërputhje në emërtimet e institucioneve të varësisë. Në ligjet specifike të miratuara nga MBZHR, në VKM nr. 708, datë 9.9.2020 òPër organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, si dhe në të gjitha aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me këto përcaktime, këto ndryshime emërtimeve duhet të reflektohen, pasi janë emërtime të fushës përkatëse të përgjegjësisë

4. Gjetje nga auditimi

Në bazën ligjore të fushës së përgjegjësisë, MBZHR ka një mospërputhje në emërtimet e institucioneve të varësisë, pasi këto nuk janë të reflektuara në ligjet e tjera dhe aktet nënligjore sipas kërkesave të nenit 1, të Ligjit nr. 16/2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, òPër ushqimin, të ndryshuar. Ndryshimet e emërtimeve duhet të ishin të reflektuara në të gjitha ligjet specifike të miratuara nga MBZHR, pasi janë emërtime të fushës përkatëse të përgjegjësisë.

4. Konkluzioni

Mospërputhja në emërtimet e institucioneve të varësisë, mosndryshimet e emërtimeve në bazën ligjore të fushës së vet të përgjegjësisë si edhe në të gjitha ligjet specifike të miratuara nga MBZHR dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), krijojnë paqartësi për punonjësit në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave, si edhe për të gjitha grupet e interesit dhe publikun.

4.1 Rekomandimi

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të rishikojnë bazën ligjore për të reflektuar në aktet ligjore dhe nënligjore në vijim ndryshimet e emërtimeve të institucioneve përkatëse sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë.

Brenda datës 30.09.2022

VKM-ja Nr. 146, datë 13.3.2018 òPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve, bazohet në: nenin 128, të Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, òPër shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar dhe

nenin 3, të Ligjit nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëveò.

Referenca ligjore e VKM-së Nr. 683, datë 03.09.2020 òPërkrijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëveò, është neni 128, i Ligjit nr.10465 datë 29.9.2011 òPër shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar.

Në VKM-në Nr. 683, datë 03.09.2020 òPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëveò, nuk ka referencë ligjore Ligjin nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëveò, ndërkohë që kjo strukturë një nga përgjegjësitë funksionale të saj ka organizimin e punës për ofrimin e kontrollit zyrtar dhe shërbimit të mbrojtjes së bimëve nga dëmtuesit. AKVMB, si strukturë e re, si autoritet kombëtar nuk ka të plotë referencën ligjore, me synim realizimin me eficiencë të plotë të përgjegjësisë të saj funksionale. Në realizimin e detyrave lidhur me procesin e mbrojtjes së shëndetit të bimëve, duhet të ishte përfshirë ligji specifik i fushës përkatëse. Kjo, për më tepër që në periudhën aktuale ka ndryshuar dhe struktura organizative e MBZHR-së, gjë e cila është e lidhur me strukturat e mbrojtjes së bimëve në zbatim të këtij ligji.

Ndërkohë që VKM-ja për krijimin e ARVMB-së ka patur referencë ligjore ligjin për mbrojtjen e bimëve, VKM-ja për krijimin e AKVMB nuk ka këtë referencë ligjore.

Në VKM-në Nr. 683, datë 03.09.2020, gjithashtu nuk përmenden afatet kohore për ngritjen/rishikimin e funksioneve të strukturave të reja, bazuar në ndryshimet ligjore përkatëse, të cilat janë ngritur me Urdhrin e KM nr.165, datë 16.12.2020 òPë miratimin e strukturës dhe të organikës së veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëveò.

Gjithashtu, në përgjigjet e pyetësorëve, punonjësit e AKU-së shprehen se lirimi nga shërbimi civil, pas shumë trajnimesh dhe testimesh, nuk i shërben motivimit të fuqishëm në angazhimin e përditshëm për realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë.

5. Gjetje nga auditimi

Në referencën ligjore të VKM-së nr. 683, datë 03.09.2020 òPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)ò, nuk është përfshirë Ligji nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëveò, ndërkohë që AKVMB, një nga përgjegjësitë funksionale të saj ka organizimin e punës për ofrimin e kontrollit dhe shërbimit të mbrojtjes së bimëve nga dëmtuesit. Për më tepër, në periudhën aktuale ka ndryshuar dhe struktura organizative e MBZHR, gjë e cila është e lidhur me strukturat e mbrojtjes së bimëve në zbatim të këtij ligji.

5. Konkluzioni

Mospërfshirja e ligjit për mbrojtjen e bimëve, si ligj specifik i fushës në bazën ligjore të AKVMB-së, si strukturë e re, ka sjellë mos ushtrimin e përgjegjësisë së plotë funksionale për mbrojtjen e shëndetit të bimëve, gjë e cila është e lidhur me strukturat e mbrojtjes së bimëve në zbatim të këtij ligji.

5.1 Rekomandimi

MBZHR të rishikojë referencën ligjore brenda fushës së vet të përgjegjësisë, për të shmangur mospërfshirjen dhe në aktet e tjera, që bazohen në Ligjin nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëveò, si edhe Ligjin nr. 9863/2008 òPër ushqiminò, të ndryshuar.

MBZHR të rishikojë dhe plotësojë referencën ligjore të VKM-së nr. 683, datë 03.09.2020 òPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëveò, me synim garantimin e funksionimit normal dhe me eficiencë të këtij institucioni, si dhe të drejtorive rajonale të saj.

Brenda datës 30.09.2022


4.1.2 Sa efektive dhe të qëndrueshme janë strukturat sipas zinxhirit funksionues për

menaxhimin e PMB-ve dhe sigurinë ushqimore?

Strukturat sipas zinxhirit funksionues për menaxhimin e PMB-ve dhe sigurinë ushqimore në zbatim të Ligjit nr. 105/2016 ðPër mbrojtjen e bimëveö,janë:

- Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB) në ministri.
- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe drejtoritë rajonale (AKVMB /DRVMB).
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).
- Shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë drejtorive rajonale të bujqësisë (DRB).
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV).
- Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (DMB) pranë ISUV-it.

SKEMA 4: ZINXHIRI I PMB-VE ðFARM TO FORKÖ



Përpunoi: Grupi i auditimit

Një nga objektivat strategjike përcaktuar në SKMBZHR 2015-2020, përfshirë dhe periudhën e auditimit ka qenë përmirësimi i strukturës organizative dhe shtimi i stafit të administratës fitosanitare në nivel qendror, laboratorëve fitosanitarë të zhvilluar dhe të akredituar dhe krijimi i një regjistri të prodhuesve dhe tregtuesve të bimëve dhe produkteve me origjinë bimore.

SPMB-ja në MZHBR ka këto detyra:

- është autoriteti kompetent që harton politikat e mbrojtjes së bimëve dhe për përshtatjen e legjislacionit të mbrojtjes së bimëve me atë të BE-së.
- zhvillon procedurat që lidhen me regjistrimin e PMB-ve, të lëndëve vepruese, si dhe të shtuesve e të bashkëvepruesve.
- ndjek dhe zbaton aktivitetin e shërbimit në kuadër të mbrojtjes së bimëve në nivel qendror dhe rajonal, në zbatim të këtij ligji.

Lidhur me SPMB-në theksojmë se:

-Në strukturën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 168, datë 05.10.2017, ðPër miratimin e strukturës dhe të organikës së MBZHRö, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Bujqësore, ka patur në përbërje dy drejtori:

- Drejtoria Veterinare.

2. Drejtoria e Sigurisë Ushqimore .

Sektori i Mbrojtjes së Bimëve ka qenë pjesë e Drejtorisë së Sigurisë Ushqimore dhe detyrat janë të përcaktuara në këtë rregullore në kuadrin e Drejtorisë së Sigurisë Ushqimore.

-Në strukturën e miratuar në vitin 2019 në MBZHR, në zbatim të së cilës është Rregulloria nr. 1, datë 27.02.2019 për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme përbëhet nga tre drejtori:

- Drejtoria e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

- Drejtoria e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës.

- Drejtoria e Derregullimit, Lejeve dhe Licencave.

Sektori i PMB-ve ka qenë pjesë e Drejtorisë së Derregullimit, Lejeve dhe Licencave, e cila ka qenë pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural.

Në strukturën aktuale, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural përbëhet nga 4 drejtori, ku tashmë, Sektori i Mbrojtjes së Bimëve është në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, dhe ky sektor ka emërtimin òSektori i Shëndetit të Mbrojtjes së Bimëve dhe OMGJò.

Siç konstatohet, në MBZHR, para dhe gjatë periudhës objekt auditimi janë kryer reforma strukturore, janë krijuar drejtori të reja, të cilat kanë zbatuar detyrat e mëparshme funksionale të parishikuara në rregulloret përkatëse të miratuara. Nga përgjigjet e pyetësorëve evidentohet se reformat strukturore nuk i kanë shërbyer plotësisht rritjes së efektivitetit të menaxhimit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore. Siç ka qenë e përcaktuar dhe në objektivat e MBZHR-së, ndryshimet e strukturave nuk duhet të mjaftohen me ndryshime emërtime, shtime/zvogëlime drejtorish, autoritetesh kombëtare drejtuese, etj. Për të qenë më efektive dhe eficiente, ristrukturimet duhet të shoqërohen me ritjere numrit të stafit profesional, duke respektuar kriteret sipas formimit, profesioneve në fushën e bujqësisë, trajnimet dhe testimet e tyre, sidomos të strukturat për mbrojtjen e bimëve në gjithë zinxhirin e menaxhimit të PMB-ve, por edhe të kapaciteteve administrative.

Ndryshimet në strukturat administrative të institucioneve të MBZHR-së nuk janë kryer bazuar në, nevojat, kompleksitetin, kriteret të qarta vlerësuese, politikat për një menaxhim më të mirë të PMB-ve, si edhe praktikat më të mira. Pra kjo tregon një mosefektivitet të ndryshimeve të shpeshta strukturore në realizimin e qëllimit të menaxhimit të PMB-ve.

6. Gjetje nga auditimi

Në MBZHR, përpara por edhe gjatë periudhës objekt auditimi, janë kryer reforma strukturore të cilat nuk i kanë shërbyer plotësisht rritjes së efektivitetit të menaxhimit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore, pasi ato nuk janë shoqëruar me rritjen e numrit të stafit profesional, duke respektuar kriteret sipas formimit profesional në fushën e bujqësisë, trajnimet dhe testimet e tyre, sidomos në strukturat për mbrojtjen e bimëve, në gjithë zinxhirin e menaxhimit të PMB-ve, si edhe të kapaciteteve administrative. Konkretisht, ndryshimet e vazhdueshme të varësisë së Sektorit të Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve nga drejtori të ndryshme, nuk i kanë shërbyer efektivitetit të procesit të menaxhimit të PMB-ve.

6. Konkluzioni

Ristrukturime të tilla, të shpeshta dhe të pambështetura në nevojat, kompleksitetin, kriteret e qarta vlerësuese, politikat për një menaxhim më të mirë të PMB-ve, si edhe në praktikat më të mira, jo vetëm që nuk i shërbejnë realizimit të objektivave të sektorit, por sjellin konfuzion edhe ndaj përgjegjshmërisë funksionale sipas varësisë që ka patur ky sektor.

6.1 Rekomandimi

MBZHR, përpara inicimit të reformave strukturore, të analizojë dhe studiojë me kujdes nevojat që diktojnë këto reforma, nivelin e kërkuar të profesionalizmit, kompleksitetin e çështjeve,

politikat që kërkon një menaxhim i mirë i PMB-ve, si edhe praktikat më të mira të pasqyruara në aktet rregullatore, për të rritur efektivitetin dhe eficiencën në realizimin e qëllimit të menaxhimit të PMB-ve.

Brenda vitit 2022

Në kuadër të reformave strukturore, në vitin 2018 me VKM-në Nr. 146, datë 13.03.2018 òPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve, u krijuan 4 agjenci rajonale, Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Elbasan ku referenca ligjore janë: neni 6, i Ligjit nr. 90/2012, òPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, neni 128, i Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, òPër shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar dhe neni 3, i Ligjit nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëve.

Në pikën 8 të VKM-së nr. 146, datë 13.03.2018, citohet: “*Strukturat dhe organikat e agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve miratohen nga Kryeministri, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”.

Agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve (aktualisht DRAVMB), kanë patur për detyrë:

a) Monitorimin e gjendjes fitosanitare të bimëve, produkteve bimore dhe të objekteve të tjera brenda territorit në administrimin e tyre.

b) Kontrollin fitosanitar dhe pajisjen me òCertifikatë fitosanitare të brendshme bimët ose produktet bimore të afta për të mbartur parazitë karantinorë apo të rrezikshëm, që lëvizin brenda territorit të vendit.

c) Kontrollin fitosanitar dhe pajisjen me òCertifikatë fitosanitare për eksportim bimët ose produktet bimore të afta për të mbartur parazitë karantinorë apo të rrezikshëm, që lëvizin jashtë territorit të vendit.

ç) Kontrollin fitosanitar dhe pajisjen me òCertifikatë fitosanitare për rieksporim bimët ose produktet bimore në rastin e hyrjes në territorin e vendit, për qëllim rieksporimi, dhe të qëndrimit të tyre brenda vendit për më shumë se 14 ditë.

d) Kontrollin fitosanitar dhe pajisjen me òCertifikatë fitosanitare materialet bimore për shumëzim ose mbjellje.

dh) Monitorimin e parazitëve të bimëve të kultivuara apo spontane, si dhe të fondeve për mbrojtjen e bimëve, që planifikohen në buxhetin vjetor për ministrinë.

e) Njofton menjëherë SPMB-në kur në një zonë shfaqet një parazit karantinor, si dhe me shpalljen e kësaj zone si zonë e prekur, ndjek masat për kufizimin e përhapjes së parazitit karantinor, deri në çrrënjosjen e tij në zonën përkatëse.

ë) Ndjek zbatimin e praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve, si dhe të kriterëve të mbrojtjes së integruar.


f) Ndjek zbatimin e masave të veçanta për rastet emergjente të përhapjes e të shtimit masiv të parazitëve, të cilët nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të kontrollit.

g) Ofron trajnim të përshtatshëm dhe lëshon dëshmi aftësie për përdorimin e PMB-ve.

gj) Ofron informacion për gjithë komunitetin e fermerëve dhe publikun, nëpërmjet medias.

Me VKM Nr. 683, datë 03.09.2020 òPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, ARSHVMB-të bëhen DRVMB, dhe me Urdhrin nr. 165, datë 16.12.2020, òPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, është miratuar struktura e AKVMB, si më poshtë vijon:

Skema 5: Struktura e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve



Përpunoi:Grupi i auditimit


Por kjo strukturë e miratuar, tashmë:

- Me një mision dhe funksion tjetër.
- Me një refencë ligjore ku nuk përfshihet ligji për mbrojtjen e bimëve, i cili është ligji specifik kryesor për PMB-të.
- Pa afate kohore të ngritjes dhe miratimit/rishikimit të funksioneve të strukturave të reja, pasi ato aktualet do të funksiononin deri në momentin e funksionimit të plotë të AKVMB, ndërkohë që VKM nr. 146 datë 13.03.2018 është shfuqizuar, tashmë. Pra siç duket këto reforma strukturore në fushën e mbrojtjes së bimëve, nuk janë të plota dhe të mbështetura në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) krijuar me VKM nr. 1081, datë 21.10.2009, òPër organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimitò, të ndryshuar, është organi inspektues, i cili ka detyrë kontrollin e zbatimit të Ligjit nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëve dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, si dhe të akteve të tjera ligjore në fushën e inspektimeve. AKU-ja ka fushë përgjegjësie sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë në të gjithë zinxhirin e saj, sigurinë e shëndetit të kafshëve në pikat kufitare dhe shëndetit të bimëve e të produkteve bimore kur ato kanë dalë në treg, ku një përgjegjësi specifike është organizimi i punës për trajnimin e inspektorëve të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inpleteve bujqësore. Në nivel rajonal, AKU-ja ka ngritur një strukturë të kontrollit territorial për sigurinë e ushqimit, e vendosur në 12 rajonet administrative. AKU-ja është përgjegjëse për kontrollin e sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore të importuara, të prodhuara dhe tregtuara në vend dhe të lëndëve të para të përdorura në industrinë e ushqimit. Inspektorët e sigurisë ushqimore (inspektorë PIK-U) janë të vendosur në pikat e kontrollit kufitar.

Gjatë periudhës objekt auditimi,AKU ka funksionuar me rregulloren e brendshme òPër organizimin dhe funksionimin e AKU'ò miratuar me Urdhrin nr. 377, datë 05.09.2017. Kjo rregullore është në fuqi dhe në momentin aktual. Ndërkohë me daljen e VKM-së nr. 708, datë 09.09.2020 òPër Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimitò, pranë AKU -së është ngritur grupi i punës për draftimin e Rregullores se re të AKU-së dhe hartimin e përshkrimeve të punës për çdo pozicion. Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes nga grupi i auditimit, rezulton se, rregullorja e brendshme e institucionit nuk është miratuar.Struktura e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është miratuar me Urdhrin Nr. 128, datë 26.10.2020, òPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimitò, si më poshtë vijon:

Skema 6: Struktura e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit



Përpunoi : Grupi i Auditimit

Nga mbikëqyrja në terren në PIK dhe vlerësimit të përgjigjeve të pyetësorëve të dërguar nga grupi i auditimit është konstatuar se inspektorët në PIK janë të detyruar të punojnë në ditët e pushimeve zyrtare dhe pa orar zyrtar. Puna e tyre është në varësi të mbërritjes së produkteve nga importi ose dhe në eksportet e tyre, por nuk kemi një urdhër administrativ apo pasqyrim në rregulloren ekzistuese, ku të përcaktohet mënyra e shpërblimit dhe eficiencës në punë, pasi kushtet e punës nuk janë të përshtatshme dhe nuk plotësojnë kërkesat për rendiment të lartë pune.

Në pikat 4 dhe 5, të nenit 64, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *ËPër ushqimin*, të ndryshuar, në zbatim të të cilit kanë dalë të dyja VKM-të për AKU-në gjatë periudhës objekt auditimi, citohet: “4. Kryetari i bordit propozohet nga anëtarët e bordit dhe emërohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për një periudhë dyvjeçare”. Në asnjë nga VKM-të e mësipërme, nuk është përcaktuar kryetari i bordit referuar aktit ligjor. (VKM Nr.1081, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave, *ËPër organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit*, të ndryshuar, po ashtu dhe në VKM nr. 708, datë 09.09.2020 *ËPër Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit*).

Pikat e inspektimit kufitar janë në varësi të drejtorive rajonale përkatëse të AKU-së dhe kryejnë kontrollin e ngarkesave të ushqimit, të mbrojtjes së bimëve dhe të inpleteve bujqësore, etj, të cilat hyjnë, dalin ose tranzitojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjykuar në sa më sipër, duke marrë në konsideratë dhe fushën e përgjegjësisë së AKU-së, është pa vend mospërfshirja e Ligjit nr. 105/2016 *ËPër mbrojtjen e bimëve* në referencën ligjore të VKM-së nr. 708, datë 09.09.2020. Është shumë e nevojshme që të reflektohen në rregulloren e re të AKU-së, të gjitha efektet e përgjegjëshmërisë institucionale sipas Ligjit nr. 105/2016 *ËPër mbrojtjen e bimëve*, gjë e cila garanton mirëfunksionimin e këtij institucioni në menaxhimin e PMB-ve.

7. Gjetje nga auditimi

AKU, gjatë periudhës së auditimit ka funksionuar me rregullore të parishikuar kundrejt ndyshimeve ligjore. Me miratimin e VKM-së nr. 708, datë 09.09.2020 *ËPër Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit*, është ngritur grupi i punës për hartimin e rregullores së re, e pa miratuar deri në kohën e kryerjes së këtij auditimi datë 30.10.2021.

7. Konkluzioni

Mosrishikimi i rregullores në koherencë me Ligjin nr. 105/2016 *ËPër mbrojtjen e bimëve*, sjell sjellur paqartësi kompetencash dhe përgjegjshmëri në menaxhimin e aktiviteteve të kontrollit të PMB-ve dhe nuk garanton mirëfunksionim të këtij institucioni në menaxhimin e PMB-ve.

7.1 Rekomandimi

MBZHR dhe AKU të marrin masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të AKU-së, duke reflektuar të gjitha efektet e detyrueshme të përgjegjshmërisë institucionale që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 105/2016 *ËPër mbrojtjen e bimëve*, me qëllim ritjen e efektivitetit të menaxhimit të zinxhirit të PMB-ve.

Brenda datës 30.09.2022

8. Gjetje nga auditimi

Është konstatuar se bordi i AKU-së për periudhën e auditimit ka funksionuar me 15 anëtarë, dhe pa kryetar Bordi të emëruar në kundërshtim me pikën 4, të nenit 64, të Ligjit nr. 9863, datë 21.01.2008 *ËPër ushqimin, të ndryshuar*.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 30-32 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

8. Konkluzioni

Funksionimi i bordit të AKU-së pa kryetar të emëruar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9863, datë 21.01.2008 *ËPër ushqimin, të ndryshuar*, ndikon në vendimmarrje pasi vota e kryetarit është e vlefshme, gjë që sjell problematika në mos funksionimin e këtij bordi sipas statutit të miratuar dhe moszbatim të kompetencave të kryetarit të Bordit. Rishikimi i mënyrës së administrimit të AKU-së nëpërmjet Bordit me kryetar të emëruar dhe rregullores së rishikuar është domosdoshmëri për të mos krijuar vakum ligjor dhe kaos në menaxhimin dhe funksionimin e tij.

8.1 Rekomandimi

MBZHR dhe AKU, të marrin masat për emërimin e Kryetarit të Bordit, reflektimin e këtij ndryshimi në aktet nënligjore dhe administrative, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor dhe funksionalitetin efektiv të Bordit.

Menjëherë

Shqipëria si anëtare e organizmave ndërkombëtare është e detyruar të respektojë masat sanitare dhe fitosanitare të saj, në lidhje me mallrat bujqësore që kalojnë kufijtë, certifikatat sanitare, në lidhje me dëmtuesit dhe shkaktuesit e sëmundjeve, etj.

Pavarësisht se ka përparim në kapacitetet zbatuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe ISUV-it, janë krijuar institucione të reja si AKMBV-ja dhe drejtoritë rajonale përkatëse DRVMB, *kapacitetet njerëzore janë të kufizuara në fushën e vlerësimit të riskut dhe monitorimit të mbetjeve, kriterëve mikrobiologjike dhe ndotësve.* Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në fushat e politikave të bujqësisë, menaxhimit të PMB-ve, politikave të sigurisë ushqimore dhe fitosanitare duhet të përmirësohen duke futur një qasje më të integruar në punën e përafrimit midis fushave të politikave, koordinimit të përmirësuar brenda dhe ndërmjet ministrive me përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës. Bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet MBZHR, AKU, ISUV është bërë i mundur nëpërmjet bashkëpunimit për hartimin e planit të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave për vitet 2018-2020, informacioneve periodike dhe raporteve vjetore të dërguara në MBZHR.

9. Gjetjenga auditimi

Kapacitetet institucionale (infrastrukturë, burime njerëzore dhe financiare), në fushën e

vlerësimin të riskut dhe monitorimit të mbetjeve, kritereve mikrobiologjike dhe ndotësve, rezultuan të jenë të kufizuara.

Si pasojë, zbatimi i standardeve të sigurisë ushqimore dhe fitosanitare **nuk** realizohet në mënyrë të plotë për shkak të dobësive dhe mungesave në kapacitete profesionale e infrastrukurore, si dhe ato administrative të ISUV-it, për të kryer inspektimet dhe kontrollet e nevojshme.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 33-34 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

9. Konkluzioni

Pavarësisht se ka përparim në kapacitetet zbatuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe ISUV-it, janë krijuar institucione të reja si AKMBV-ja dhe drejtoritë rajonale përkatëse-DRVMB, *kapacitetet njerëzore janë të kufizuara në fushën e vlerësimit të riskut dhe monitorimit të mbetjeve, kritereve mikrobiologjike dhe ndotësve.* Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në fushat e politikave të bujqësisë, menaxhimit të PMB-ve, politikave të sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare nuk iu nënshtrihen një qasjeje më të integruar në punën e përafrimit midis fushave të politikave, koordinimit të përmirësuar brenda dhe ndërmjet ministrive me përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës.


9.1 Rekomandimi

MBZHR në bashkëpunim me institucionet e varësisë të marrë masat për të rivlerësuar kapacitetet institucionale në fushat e politikave të bujqësisë, menaxhimit të PMB-ve, politikave të sigurisë ushqimore dhe fitosanitare, planifikimet Brenda sistemit të inspektimit dhe gjurmueshmërisë së tyre, sipas procedurave të vendosura. Kjo të arrihet, duke futur një qasje më të integruar në punën e përafrimit midis fushave të politikave, përfshirë një koordinim të përmirësuar brenda dhe ndërmjet ministrive me të gjithë aktorët përkatës të zinxhirit të PMB-ve.

Brenda datës 30.09.2022

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është krijuar me VKM Nr. 515, datë 19.06.2006 ÷Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, të ndryshuar, struktura e të cilit është miratuar me Urdhrin Nr. 126, datë 23.10.2020, ÷Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, si më poshtë vijon:

Skema 7: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë



Burimi: website i MBZHR

Bazuar në pikën 1.2, të nenit 4, të Ligjit nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëveò, laboratori i analizave cilësore të PMB-ve, si dhe ai i mbetjeve të tyre në bimët e në produktet me origjinë bimore, pranë ISUV-it, ka për detyrë:

- a) Vlerësimin e dokumentacionit të PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit të tyre.
- b) Kontrollin cilësor të PMB-ve të regjistruara dhe të hedhura në treg.
- c) Analizën e mbetjeve të PMB-ve në bimët dhe produktet me origjinë bimore të prodhuara në vend dhe/ose të importuara, në zbatim të legjislacionit për sigurinë ushqimore.

Siç është e përcaktuar në pikën 3, të nenit 13, të Ligjit Nr.105/2016 òPër mbrojtjen e bimëveò, Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent, miraton shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve financiare të mbrojtjes së bimëve. Gjykar mbi këtë përcaktim ligjor dhe siç konstatohet nga përgjigjet e pyetësorëve, shumë analiza nuk kryhen për mungesë fondesh. Kjo të lë të nënkuptosh se institucionet përkatëse nuk kryejnë planifikim dhe analizë kostosh për proceset që kanë përgjegjësi juridike, si edhe bashkëpunimi ndërinstytucional midis institucioneve të zinxhirit të menaxhimit të PMB-ve, i cili është bërë i mundur nëpërmjet bashkëpunimit për hartimin e planit të kontroleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave për vitet 2018-2020, informacioneve periodike dhe raporteve vjetore të dërguara në MBZHR, nuk ka qenë shumë efektiv.

Nga përgjigjet e pyetësorëve, dokumentacioni dhe të dhënat e administruara nga grupi i auditimit, bazuar në detyrat e ISUV, ku përcaktohet vetëm analizimi i PMB-ve, mbi bazën e një plani i cili propozohet nga AKU në bashkërendim me ISUV dhe që miratohet me urdhër ministri, bashkëpunimi midis këtyre institucioneve ka qenë i kufizuar dhe nuk ka funksionuar në nivelin e duhur, për shkak të mos kërkesës dhe plotësimit nga ISUV të buxhetit të nevojshëm për zbatimin e këtij detyrimi ligjor, në programimet buxhetore vjetore.

Mos kryerja e analizave në kohën e duhur, brenda afateve ligjore të përcaktuara ka pasojat e veta lidhur me tregtimin e PMB-ve dhe nuk shmang në kohën e duhur efektet negative që ato mund të mbartin.

Sipas përgjigjeve të pyetësorëve kapacitetet laboratorike për kryerjen e analizave të PMB-ve i ka vetëm ISUV-i dhe nuk ka asnjë laborator rajonal që i mbulon ato. Përsa i përket testimeve në nivel ndërkombëtar për PMB-të nuk ka ente që ofrojnë testime të tilla.

Për vitet 2018-2019 nuk ka analiza të kryera, për arsye të mungesës së planifikimit të buxhetit. Bazuar në udhëzimin për tarifatat e analizave të PMB-ve, përsa i përket të ardhurave nga analizat ISUV nuk ka krijuar asnjë të ardhur pasi është një shërbim i cili kryhet me nënkontraktim.

Në lidhje me buxhetin e alokuar për vitin 2020, ky buxhet, po me kërkesën e ISUV-it u alokua në tremujorin e fundit të vitit, ku ishte e pamundur që ky shërbim të ofrohej nga ISUV, duke qenë se procedurat tenderuese dhe përgatitja e laboratorit duan kohën e tyre. Në këto kushte ISUV ishte i detyruar që kampionet e planifikuara t'ia dërgonte për analizë në laboratorin e referencës në Hollandë (Wageningen Food Safety Research) WFSR).

Përveç planifikimit të detajuar të PMB-ve dhe mbështetjes me buxhet për realizimin e këtyre analizave, në mënyrë që ISUV-i të mundet të përgatis laboratorin e vet për realizimin e planit për vitin 2022 dhe në vijim, duhet që e njëjta vlerë për këtë qëllim të alokohej brenda vitit 2021. Në të kundërt ISUV do të mbetet në këtë vull të nënkontraktimit pa limit¹³.

Në bazë të Ligjit nr. 105/2016, SPMB është autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve. Mbështetur në parashikimet e ardhura nga shërbimi rajonal i mbrojtjes së bimëve (SHRMB) dhe, në varësi të nivelit dhe përhapjes së infeksionit, përcaktohet buxheti për kontrollin e parazitëve. Buxheti parashikohet për 3 vjet në PBA dhe rishikohet çdo vit. Programi buxhetor i Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit ka edhe zërin e Luftimit të sëmundjeve në bujqësi.

Nga përgjigjet e pyetësorëve konstatohet se mos kthimi ose vonesat mbi 10 ditë në marrjen e përgjigjeve të analizave nga ISUV, ka bërë të mundur që AKU, të mos kryej në kohë marrjen e masave për bllokimin e tregimit të PMB-ve që kanë rezultuar jo konformë. Për të shkuar më tej vonesat në marrjen e përgjigjeve nga institucionet shtetërore përkatëse, krijojnë premisa për vënien në eficiencë të laboratorëve privat.

10. Gjetje nga auditimi

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) nuk ka përmbushur detyrimin ligjor dhe administrativ të ngarkuar me Urdhrin e Ministrit (të përvitshëm) mbi planin e kontrollit për periudhën 2018-2020, në marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave brenda afatit 10 ditor. Në dy vitet 2018-2019¹⁴, ISUV **nuk** ka bërë asnjë analizë me pretendimin se i kanë munguar burimet financiare që në planifikimin buxhetor të viteve përkatëse. Kjo situatë është krijuar nga mungesa e një planifikimi paraprak, bazuar në nevojat e parashikuara, analizën e kostove dhe infrastrukturën e nevojshme për përmbushjen e detyrimit në kryerjen e analizave.

10. Konkluzioni

Moskthimi ose vonesat mbi 10 ditë në marrjen e përgjigjeve të analizave nga ISUV, ka bërë të mundur që AKU, të mos kryejë në kohë marrjen e masave për bllokimin e tregimit të PMB-ve që kanë rezultuar jo konformë.

10.1 Rekomandimi

MBZHR, të marrë masat që të analizojë shkaqet e mospërmbushjes së detyrimit ligjor dhe administrativ, të ngarkuar me urdhrin e ministrit mbi planin e kontrollit për periudhën 2018-

¹³ Përgjigje e pyetësorit nga ISUV

¹⁴ Në përgjigjet e pyetësorëve konstatohet se AKU ka dërguar mostrat për analizë të PMB-ve në ISUV.

2020 në marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave brenda afatit 10 ditor, me qëllim evidentimin e personave përgjegjës dhe marrjen e masave përkatëse.

Menjëherë

10.2 Rekomandimi

-ISUV të marrë masa që menjëherë të fillojë kryerjen e analizave duke respektuar afatin ligjor dhe mundësuar bllokimin në kohë të produkteve të dëmshëm për shendetin e njerëzve.

-MBZHR, si institucion përgjegjës, të marrë masa për të koordinuar bashkëpunimin me ISUV dhe AKU, duke ngritur grup pune në çdo vit paraardhës buxhetor, për marrjen e përgjegjësive përkatëse lidhur me strukturat e mbrojtjes së bimëve dhe sigurinë ushqimore midis autoriteteve përgjegjëse në nivel kombëtar dhe rajonal.

-Në çdo rast, sektori përgjegjës për buxhetin në ISUV, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të përcaktojë saktë nevojat për fonde me qëllim përfshirjen në buxhet të procesit të kryerjes së analizave në funksion të sigurisë ushqimore.

Brenda datës 30.06.2022

Në lidhje me Projekt Raportin mbi Auditimin e Performancës, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 613/3 prot., datë 26.01.2022, grupi i auditimit i KLSH-së në përmbushje të pikave të programit të auditimit nr. 613/1 prot., datë 02.08.2021, me objekt “Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi dhe siguria ushqimore”, ka paraqitur disa sqarime me shkresën e protokolluar në ISUV me nr. 165 prot., dt. 21.02.2022 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 613/4 prot., datë. 23.02.2022, si më poshtë:

Gjetja Nr. 11 ku citohet: “Është konstatuar që ISUV nuk ka përmbushur detyrimin ligjor dhe administrativ të ngarkuar me urdhrin e ministrit (të përvitshëm mbi planin e kontrollit për periudhën 2018-2020 në marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave brenda afatit 10 ditor” Për vitin 2020 analizat e PMB janë dërguar me nënkontraktim jashtë, për arsyet e sipërpërmendura, dhe si rrjedhojë nuk mund të respektohet afati 10 ditor i përcaktuar për kthimin e përgjigjes.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket sqarimit të mësipërm nga ana juaj, ritheksojmë se ISUV duhet të përmbushë detyrimin ligjor brenda afatit kohor të përcaktuar.

11. Gjetje nga auditimi

ISUV-i nuk ka rregullore të brendshme të miratuar, mbi bazën e të cilave do të disiplinohej realizimi i misionit dhe qëllimit të tij. Edhe pse DraftRregullorja e hartuar nga ISUV, me shkresën nr. 56 prot., datë 14.01.2021, i është dërguar ministrit të MBZHR-së për miratim, si edhe ri-dërguar përsëri MBZHR-së me shkresën nr.74/1 prot., datë 20.09.2021, ajo ende **nuk** është miratuar.

11. Konkluzioni

Në mungesë të akteve rregullatore, por dhe si pasojë e mungesës së bashkëpunimit midis drejtorive përkatëse në MBZHR dhe AKU, ka munguar përgjegjshmëria institucionale dhe menaxhuese e këtij institucioni.

11.1 Rekomandim

MBZHR në bashkëpunim me ISUV të marrë masat për miratimin e rregullores së brendshme të depozituar në MBZHR, brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Brenda datës 30.06.2022

Në PRKE për vitin 2020¹⁵ theksohet se siguria ushqimore ndër të tjera sigurohet me cilësinë e produktet për mbrojtjen e bimëve, mbrojtjen nga organizmat e dëmshëm dhe është lënë detyrë që Shqipëria duhet të përmirësojë kontrollin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe të konsolidojë kapacitetet e monitorimit të mbetjeve të pesticideve në produktet ushqimore. Në lidhje me sigurinë e përgjithshme ushqimore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer kontrole të rregullta zyrtare në përputhje me planin vjetor me bazërisht dhe ka marrë masat përkatëse, duke përfshirë paralajmërime, gjoha, konfiskim dhe asgjësim të ushqimit jo të konsumueshëm dhe pezullim të aktivitetit, por kapaciteti i vlerësimit të riskut bazuar në të dhëna dhe mbi opinione shkencore duhet të përmirësohet.

12. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi është konstatuar se kapaciteti i vlerësimit të riskut bazuar në të dhëna dhe mbi opinione shkencore, nuk është në pritshmëritë e duhura për shkak të mungesës së infrastrukturës (sistem IT). Kjo ka sjellë mangësi në përmirësimin e procesit të vlerësimit të riskut. Gjithashtu, si mangësi vlerësohet edhe mos implementimi i kërkimeve shkencore dhe mungesa e bashkëpunimit me institucionet e tjera të kërkimit shkencor të arsimit të lartë publik në fushën e PMB-ve.

12. Konkluzioni

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer kontrole të rregullta zyrtare, në përputhje me planin vjetor, të bazuar në risk dhe ka marrë masat përkatëse, duke përfshirë paralajmërime, gjoha, konfiskim dhe asgjësim të ushqimit jo të konsumueshëm dhe pezullim të aktivitetit, por kapacitetet e vlerësimit të riskut bazuar në opinionin shkencor duhet të përmirësohen.

12.1 Rekomandimi

MBZHR dhe AKU, të marrin masa për forcimin e kapaciteteve infrastrukturore për të përmirësuar procesin e vlerësimit të riskut, bazuar në të dhëna dhe opinione shkencore në bashkëpunim dhe me institucionet e kërkimit shkencor të arsimit të lartë, si edhe me grupet e interesit, në fushën e PMB-ve.

Brenda datës 30.06.2022

13. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi u konstatua se ende nuk është krijuar plotësisht regjistri i fermave, që synon sigurimin e të dhënave të vlefshme për menaxhimin e zinxhirit të kontrollit të PMB si edhe politikëbërjen, cituar dhe në Progres Raportin 2019-2020¹⁶

13. Konkluzioni

Moskrijimi i regjistrit të fermave, nuk garanton sigurimin e të dhënave të vlefshme për politikëbërje, domosdoshmëri për mbështetjen e fermerëve, menaxhimin dhe kontrollin e zinxhirit të PMB-ve, si edhe garantimin e sigurisë ushqimore për një perceptim më të mirë të publikut. Konstatohet se në disa raste fermerët mbeten të pa monitoruar në përdorimin e PMB dhe nuk mbajnë të dokumentuar shërbimet agroteknike për kulturat bujqësore dhe si rezultat nuk dokumentohet respektimi i karencës¹⁷, përdorimet jashtë etiketës apo tejkalimi i dozave të përdorimit.

13.1 Rekomandimi

MBZHR, të marrë masa për krijimin e regjistrit të fermave, si dokument që siguron bazën e të dhënave të vlefshme për politikëbërjen dhe zbatimin e politikave të qeverisë, në mënyrë që regjistrimi paraprak dhe hedhja në treg e PMB-ve, të bazohet në kërkesa rreptësisht të përcaktuara, të cilat nevojiten të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme e në përshtatje dhe me legjislacionin europian për PMB-të.

Brenda datës 30.09.2022

¹⁵PRKE 2020

¹⁶Rekomandimeve të BE Raport progresi 2019-2020.

¹⁷ "Karencë-koha e nevojshme për zhvillimin normal të bimës.

4.2 A janë zbatuar në mënyra të përshtatshme politikat për regjistrimin, administrimin, tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve për të garantuar sigurinë ushqimore?

4.2.1 A janë ndërmarrë masa efektive për zbatimin e procedurave të zinxhirit funksionues të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore?

Nëse nuk përdoren PMB, nuk mund të sigurohet ushqimi i nevojshëm për njerëzimin. Sipas FAO, edhe në këto kushte, më tepër se 1 miliard njerëz në botë vuajnë nga uria. Shpesh, ushqimet e prodhuara pa përdorimin e PMB-ve, janë më të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve si rezultat i përmbajtjes së fitotoksinave. Përdorimi i PMB-ve ndihmon në ruajtjen e mjedisit dhe biodiversitetit. Për prodhimin e të njëjtës sasi ushqimesh nga bujqësia organike do duhej të përdorej 65-200 % më tepër tokë e kultivuar. Kështu do rritej erozioni, do dëmtohej peisazhi dhe do vihej në rrezik, deri ekzistenca e shumë specieve të egra.

Ndryshimet klimatike çojnë në zhvillimin e dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija të reja ose në zgjerimin e arealit të tyre. Shumë specie që konsiderohen të padëmshme ose pak të dëmshme, shpesh bëhen dëmtues seriozë dhe rrezikojnë deri dëmtimin total të bimëve.

Përdorimi i PMB-ve është i domosdoshëm për sigurimin në sasi dhe cilësi të ushqimit. PMB-të janë kimikate më të testuara dhe kontrolluara në botë.

Mosrespektimi i kushteve dhe kriterëve të përdorimit të tyre, mund të shkaktojë dëmtim të shëndetit të përdoruesve, konsumatorëve të produkteve të trajtuara, si dhe ndotje të mjedisit dhe dëmtim të florës e faunës, gjë e cila çon dhe në perceptimin e gabuar të njerëzve lidhur me domosdoshmërinë e përdorimit.

Shqetësimet në rritje lidhur me aplikimin e PMB-ve dhe kërkesat në rritje për ushqim e kanë drejtuar vëmendjen e shoqërisë drejt sigurisë së ushqimit, si dhe në rregullimin global të prodhimit të ushqimit. Produktet për mbrojtjen e bimëve (PMB), në përgjithësi përdoren për të eliminuar ose kontrolluar dëmtues të ndryshëm bujqësorë, që mund të dëmtojnë bimët dhe të ulin produktivitetin e fermave. Përparësia më e madhe e PMB-ve është se ato shpëtojnë fermerët, mbrojnë bimët nga insektet dhe dëmtuesit e tjerë, zvogëlojnë diversitetin e përgjithshëm biologjik në tokë, etj. Që sistemi i sigurisë së produkteve ushqimore të jetë sa më efikas, institucionet shtetërore dhe ato të financuara nga shteti, duhet të kontribuojnë në krijimin e legjislacionit, sigurinë e vazhdueshme dhe rigoroze të shëndetit dhe kontrollin e cilësisë, aplikimin e njohurive shkencore në praktikë, trajnimin e stafit dhe edukimin e konsumatorëve në fushën e ushqimit.

Mbi regjistrimin e PMB-ve.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi, organi i caktuar për vlerësimin e dokumentacionit që kryen regjistrimin e PMB-ve është Komisioni i Regjistrimit të PMB-ve (KRPMB), i ngritur në MBZHR. Ky komision kryesohet nga Zëvendësministri dhe 4 anëtarë specialist të fushës dhe mbledhet periodikisht, sipas kërkesave të paraqitura nga subjekte të ndryshme.

Regjistrimi kryhet sipas kriterëve në 2 nivele, këto bazuar në kërkesat e BE:

- Regjistrimi i lëndëve vepruese në BE.
- Regjistrimi i PMB-ve në vendet anëtare të BE- se (sipas ndarjes në 3 zona).

Ambienti rregullator në BE është bërë shumë më i vështirë, pasi është vendosur një regjim më strikt për kontrollin e rrezikut, shoqëruar me kërkesa për të dhëna të reja, udhëzuesit e rinj teknikë dhe rregullat shtesë të kontrollit që duhen zbatuar për përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve.

Aktualisht, nga 1453 lëndë vepruese gjithsej në qarkullim sipas listës së FAO-s, janë:

- përfshirë në listën e BE-së (të miratuara) 468 lëndë vepruese.

- aplikuar për regjistrim (me status pezull) 62 lëndë vepruese.
- jashtë liste (hequr) 906 lëndë vepruese.

Në BE, pjesa e substancave aktive me profile të *rrezikut të lartë është shumë e ulët (2%)* dhe ka tendencë ulje në të ardhmen, ndërsa përqindja e substancave aktive me profile të *rrezikut të ulët është relativisht e madhe (37%)* dhe me tendenca rritje. Në fakt, në vitet e fundit, gjysma e aplikimeve për miratimin e substancave të reja aktive (nga të cilat ka mesatarisht 10 aplikime në vit) janë për mikroorganizma (jo kimike), ose substanca që pritet të plotësojnë kriteret për substanca me rrezik të ulët. Nga viti 2011 deri në vitin 2018, janë marrë vendime për të mos aprovuar dhe për të mos rinovuar aprovimin, ose për të tërhequr 22 substanca aktive për shkak të shqetësimeve që lidhen me shëndetin ose mjedisin, të cilat kanë kontribuar në zvogëlimin e rreziqeve serioze për konsumatorët, operatorët, punëtorët dhe banorët në BE dhe për mjedisin. Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, pritet të përmirësohet më tej në vitet e ardhshme, kur shqyrtimi i parë i të gjitha miratimeve ekzistuese do të përfundojë (sipas pritshmërive deri në vitin 2025).

Fermerët e vendeve të BE-së ankohen se ka mungesë të PMB-ve në treg, ndërsa numri i substancave aktive të aprovuara në të vërtetë është ritur nga 427 në vitin 2011 në 484 në vitin 2018 dhe numri i PMB-ve në dispozicion është rritur në shumicën e shteteve antare.

Marrëveshja e gjelbër evropiane dhe Strategjia “Farm to Fork” ndikojnë në uljen e varësisë nga pesticidet dhe lëvizjen drejt substancave aktive me rrezik të ulët.

Palët e interesit nga i gjithë spektri konsiderojnë se kërkesat rregullatore për pesticidet në BE janë ndër më të rreptat në botë.

Në Shqipëri, regjistrimi i PMB-ve bazohet në VKM nr. 335, datë 06.06.2018 òPër miratimin e rregullave për regjistrimin, procedurën dhe kriteret e vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëveò, e cila përcakton rregullat, procedurat dhe mënyrën e vlerësimit të regjistrimit të PMB-ve, në nivel kombëtar. Kjo kërkon kushtin që PMB të jetë e regjistruar në një nga vendet e BE-së, duke e marrë të mirëqenë analizën e riskut të produktit të kryer nga Autoriteti Europian i Sigurisë Ushqimore (EFSA). PMB-të tregtohen dhe përdoren brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, vetëm nëse janë të regjistruara. Është e ndaluar përdorimi i tyre nga burime të tjera, konkretisht e hyrjeve kontrabandë, të fallsifikuara dhe të paregjistruara, etj. VKM-ja trajton vetëm regjistrimin e PMB-ve dhe jo të lëndëve vepruese, meqenëse sipas Ligjit nr. 105/2016, datë 14.10.2016, òPër mbrojtjen e bimëveò, këto miratohen dhe përditësohen me urdhër ministri. Në VKM përcaktohet që regjistrimi kryhet në MBZHR, pranë strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve që është KRPMB, si organ vendimmarrës dhe ISUV-i, i cili është i vetmi institucion që bën vlerësimin e dokumentacionit teknik të dosjes së PMB-ve, në procesin e regjistrimit të tyre.

Aktualisht, janë të regjistruara 325 PMB, të cilat lejohet të importohen, tregtohen dhe përdoren në vendin tonë. Ndërsa 89 PMB janë çregjistruar dhe për to nuk lejohet importi por vetëm tregtimi dhe përdorimi brenda afateve të skadencës së tyre. Vlefshmëria e regjistrimit të tyre është e ndryshme dhe përcaktohet me Urdhrin e ministrit nr. 72, datë 02.03.2017, òPër miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-veò, të ndryshuar. Ky urdhër është përgatitur dhe përditësuar bazuar në legjislacionin e BE-së.

Klasifikimi i PMB-ve për efekt të arsytimit të ecurisë dhe evoluimit të tyre ndër vite në Shqipëri dhe vendet e BE-së:

1. Insekticide, për kontrollin e insekteve dhe merimangave të bimëve. Fillimisht (që nga vitet -40) janë përdorur thujse të gjithë lëndët e klasave kimike, kryesisht me veprim të shumfishtë, si:

-Klor-organikët (mbi 30 substanca gjithsej, të gjitha të hequra), me ndikim shumë helmues dhe

afatgjatë tek njerëzit dhe gjallesat e tjera.

-Fosfor organikët (mbi 50 substanca gjithsej, nga të cilat kanë mbetur të miratuara 5), me ndikim shumë helmues dhe afat gjatë tek njerëzit dhe gjallesat e tjera.

-Karbamatet (mbi 10 substanca gjithsej, të gjitha të hequra), me ndikim shumë helmues dhe afat gjatë tek njerëzit dhe gjallesat e tjera.

-Piretroidet (mbi 40 substanca gjithsej, nga të cilat kanë mbetur të miratuara 5-6), me ndikim shumë helmues tek bleta dhe pjalmuesit e bimëve, si dhe helmues me frymemarrje tek njerëzit.

-Neonikotinidet, me ndikim shumë helmues tek bleta dhe pjalmuesit e bimëve (edhe pse janë sintetizuar pas viteve 80, nga 7 gjithsej, vazhdon e miratuar vetëm 1 substancë).

2. Fungicide, për kontrollin e sëmundjeve kërpudhore dhe bakteriale të bimëve. Fillimisht (që nga vitet -40) janë përdorur thujse të gjithë lëndët e klasave kimike kryesisht me veprim të shumfishtë, si:

- Benzimidazolet (mbi 10 substanca gjithsej, të gjitha të hequra).

- Thiophanatet (mbi 10 substanca, nga të cilat kanë mbetur të miratuara 2).

- Dicarboximidet (mbi 15 substanca, mbetur të miratuara 3).

- Strobilurinat (mbi 20 substanca, mbetur të miratuara 5).

- Triazolet (mbi 40 substanca, mbetur të miratuara 8).

- Morpholinat (mbi 10 substanca, mbetur të miratuara 3).

- Dithiocarbamatet (mbi 30 substanca, mbetur të miratuara 3)

Pas viteve 90 dhe në vazhdim, përparësi i është dhënë lëndëve vepruese të reja, që kanë veprim specifik tek sëmundjet, si dhe me periudhë zbrërthimi të shkurtër (1-7 ditë) tek bimë që trajtohen, ku përfshihen edhe biopreparatet (me origjinë bimore dhe mikroorganizma).

3. Herbicide, për kontrollin e bimëve të dëmshme. Fillimisht (që nga vitet -40) janë përdorur thujse të gjitha lëndët e klasave kimike kryesisht me veprim të shumfishtë, si:

- Sulfonylureat (mbi 20 substanca gjithsej, nga të cilat kanë mbetur të miratuara 4).

- Triazinat (mbi 30 substanca, mbetur të miratuara 6).

- Ureat (mbi 30 substanca, mbetur të miratuara 5).

- Kloroacetamidet (mbi 10 substanca, mbetur të miratuara 2).

- Thiocarbamatet (mbi 20 substanca, mbetur të miratuara 3).

a. Nematocide, për kontrollin e nematodave të bimëve. Evoluimi ndër vite është i njëjtë me Insekticidet.

b. Rodenticide, për kontrollin e brejtësve (minjve). Janë hequr thujse të gjithë nga qarkullimi.

- Antiókoagulantet, (mbi 10 substanca gjithsej, të gjitha të hequra).

- Cyanide Gjeneratorët, (mbi 5 substanca, të gjitha të hequra).

- Hypercalcaemicet, (mbi 10 substanca, të gjitha të hequra).

- Narcotiket (mbi 5 substanca, të gjitha të hequra).

- Inorganiket (mbi 10 substanca, nga të cilat kanë mbetur të miratuara 3).

c. Rregullatore të ritjes së bimëve, për rregullimin e rritjes dhe proceseve të tjera të bimëve.

Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit, garantohet jo vetëm nga përdorimi i PMB-ve, por dhe nga produktet plehëruese për ushqyerjen e bimëve, përmirësimin e cilësive fiziko-kimike dhe rritjen epjellorisë së tokës. Ky proces arrihet nëpërmjet përcaktimit të rregullave për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe organizimin dhe funksionimin e strukturave përkatëse.

Rëndësi të veçantë ka evidentimi i çdo hallke të zinxhirit ushqimor, ku produktet plehëruese janë grupi më i rëndësishëm i inputeve bujqësore dhe me një shumëllojshmëri formulimesh dhe

përmbajtje të lëndëve ushqyese, me veprim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e bimëve dhe të prodhimit të cilësisë së prodhimit, pa përjashtuar edhe ndikimin në sigurinë ushqimore.

Gjatë periudhës objekt auditimi, Ligji nr. 10390, datë 03.03.2011, për plehrat e përdorimit për bimësinë së bashku me paketën nënligjore, nuk i është përgjigjur në nivelin e duhur trendit të ri të regjistrimit, tregtimit dhe përdorimit të plehrave dhe në shumë raste të tjera ka lënë hapësira për abuzime, sidomos tek kategoria e EC Fertilizers, të cilat zenë pjesën më të madhe në sasi dhe llojshmëri të plehrave që importohen, siç përcaktohet në nenin 2 të Ligjit nr. 10390, datë 3.3.2011 për plehrat e përdorimit për bimësinë,¹⁸ gjë e cila është shmangur me ligjin nr. 17/2020, i cili detyron regjistrimin e të gjitha produkteve plehëruese në RSH.

Edhe pse ligji i ri e minimizon riskun e abuzimit me këtë produkt, konstatohet se në këtë ligj nuk parashikohet periudhë kalimtare për mënyrën e tregtimit të produkteve plehëruese të importuara dhe vendosura në treg para hyrjes në fuqi të këtij ligji, referuar kjo Rregullores së BE 2019/1009 mbi rregullat e tregut të produkteve të fertilizimit të BE-së dhe ndryshimet në rregulloret e Komisionit Evropian nr. 106/2009, nr. 1107/2009 dhe 2003/2003. Në pikën 2 të nenit 33 të Ligjit nr. 17/2020 për produktet plehëruese citohet: 02. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktuara në nenin 32, të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 10390, datë 3.3.2011, për plehrat e përdorimit për bimësinë, për aq sa përputhen me ligjin në fuqi. Gjykuar sa më sipër, me miratimin dhe vënien në fuqi të Ligjit nr. 17/2020 është ndaluar përdorimi i EC Fertilizers të përcaktuara në RSH, gjatë periudhës kalimtare deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të tij.

Plehra të regjistruara (jo EC Fertilizers) për vitet 2018-2019 janë 341 lloje plehrash¹⁹ deri në Janar 2020. Ky ligj nuk ka patur të përcaktuara rregulla të qarta për, prodhimin e produkteve plehëruese në vend, kontrollin nga prodhimi deri te përdorimi, procedurat e regjistrimit të plehrave për përdorim për bimësinë, tregtimin dhe etiketimin e tyre. Ndryshimet dhe reformat e zbatuara vitet e fundit në MBZHR, kanë bërë që të mos të ketë ndarje të qarta të përgjegjësisë dhe kompetencave për menaxhimin, monitorimin dhe analizimin e produkteve plehëruese. Në MBZHR nuk ka patur të përcaktuar strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e plehrave për përdorim për bimësinë.

Zbatimi i programit politik të qeverisë shqiptare për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe veçanërisht konsolidimi dhe siguria juridike në fushën e sigurisë ushqimore, është pasqyruar në objektivin nr. 5 “Përmirësimi i prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore për të rritur sasinë dhe sigurinë ushqimore të tyre” dhe objektivin nr. 17 “Rritja e kontrollit të origjinës së produkteve bujqësore dhe blegtorale për të rritur nivelin e sigurisë ushqimore në tregjet bujqësore, blegtorale dhe në industrinë agroushqimore”.

Pavarësisht legjislacionit aktual, problemet e hasuara në lidhje me inputet bujqësore ku përfshihen tre grupet (plehrat për përdorimin e bimësisë, materiali mbjellës dhe shumëzues bimor dhe produktet për mbrojtjet e bimëve), nxjerrin në pah domosdoshmërinë e trajtimit sipas një paketë më të plotë ligjore dhe një strukture të mirë përcaktuar për hartimin, implimentimin dhe monitorimin e saj. Po kështu, ka patur mungesë të strukturave përkatëse, duke u nisur nga institucioni qëndror MBZHR, ku nuk kemi një sektor të veçantë por është mbështetur si procesi sektorial të PMB-ve, kjo e reflektuar dhe tek mungesa e monitorimit dhe kontrollit nga institucionet zbatuese në varësi, si ish DRB dhe sot aktualisht DRAVMB e DRB pranë bashkive të vendit

Ndërsa produktet e mbrojtjes së bimëve dhe materiali mbjellës shumëzues bimor janë thuajse të kompletura në këto dy aspekte, ato kërkojnë plotësime të tjera në kuadrin e përafrimit me legjislacionin e BE-së.

¹⁸...Plehrat vendosen në treg vetëm në qoftë se: a) janë plehra me emërtimin EC Fertilizers, të cilat lejohen të qarkullojnë lirshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) janë plehra që nuk kanë emërtimin EC Fertilizers, por janë të pajisura me certifikatë regjistrimi, sipas dispozitave të këtij ligji.

¹⁹<https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Lista-e-plehrave-janar-2020.pdf>

Përveç mangësive të zbatimit të ligjit të mëparshëm që ka përfshirë 2 vitet e periudhës së auditimit 2018-2019, është evidentuar fakti se për procesin e regjistrimit ka patur neglizhencë dhe kanë munguar strukturat përgjegjëse në MBZHR e njësitë e varësisë.

Mosefektiviteti i zbatimit të ligjit nr. 10390, datë 3.3.2011 òPër plehrat e përdorimit për bimësinë, bëri që MBZHR të hartojë Ligjin nr.17/2020 òPër produktet plehëruese, me 70% ndryshime të ligjit të mëparshëm, me përparësitë e mëposhtme:

- Pasqyruar ndryshimi, që përfaqëson përmbajtjen e ligjit që nga termi òProdukt plehëruese, e cila është lënda, përzierja, mikro-organizmi ose çdo material tjetër, që përdoret vetëm ose i përzier me material tjetër, te bimët ose rizosferën e tyre me qëllim sigurimin me elementë ushqyes ose përmirësimin e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve.
- Klasifikon produktet plehëruese në 11 grupe të rëndësishme: produktet plehëruese inorganik ose mineral; produktet plehëruese organik; produktet plehëruese organo-mineral; produktet plehëruese bazuar në elementë ushqyes dytësorë; produktet plehëruese bazuar në mikroelementë; produktet plehëruese me veprim specifik; produktet plehëruese të veçantë.
- Korrektuesit (korrigjuesit); substratet e kultivimit (rritjes); përmirësuesit e tokës, materialet organike të destinuara për prodhimin e produkteve plehëruese organo-mineral.
- Përcakton strukturat përkatëse dhe detyrat e secilës prej tyre me mirëfunksionimin e kontrollit dhe monitorimit të produkteve plehëruese që nga miratimi për licensim të prodhimit, regjistrimi, tregtimi, si dhe në kryerjen e inspektimeve dhe të analizimit të tyre.
- Kënaq kërkesat aktuale të bujqësisë lidhur me trendin gjithmonë në rritje për sasinë, llojshmërinë dhe cilësinë e produkteve plehëruese, sidomos në zgjidhjen e shumë problemeve të lindura vitet e fundit për regjistrimin, tregtimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese në Shqipëri.
- Lejon tregtimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese vetëm nëse janë të regjistruara. Kjo ndikon në forcimin e gjurmueshmërisë së produkteve plehëruese si dhe mënjanon parregullsitë dhe shmangiet e mundshme ligjore në importimin, tregtimin dhe përdorimin e tyre.
- Procedura më të thjeshtuara regjistrimi, me dokumentacion më të qartë dhe me afate të shkurtuara dhe saktësuar qartë afatet e vlefshmërisë së regjistrimit të produkteve plehëruese si dhe përmbajtja e dokumentave të regjistrimit (certifikata dhe etiketa).
- Është përcaktuar gjurmueshmëria në të gjitha nivelet e prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese. Detyron prodhuesit dhe tregtuesit e produkteve plehëruese që të krijojnë sisteme për mbajtjen e të dhënave, të cilat mundësojnë identifikimin në çdo çast të produktit plehëruese si dhe çdo personi fizik apo juridik, që i ka furnizuar apo është furnizuar me produkte plehëruese. Për qëllimet e gjurmueshmërisë së produkteve plehëruese, nga drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve në ministri, mbahen òRegjistri i produkteve plehëruese, i cili përmban një seksion të veçantë për ata që lejohen në bujqësinë organike, si dhe òRegjistri i prodhuesve të produkteve plehëruese.
- Ndalon prodhimin, importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve plehëruese të paregjistruara; produkteve plehëruese me përmbajtje substancash të dëmshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë ose shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve ose një rrezik për mjedisin ose për sigurinë publike; produkteve plehëruese të falsifikuar; produkteve plehëruese të tjetërsuar; produkteve plehëruese me përmbajtje të padeklaruara.
- Parashikon kosto minimale mbi buxhetin e shtetit, krahasimisht përfitimeve. Konkretisht, janë parashikuar të ardhura të drejtpërdrejta shtesë në buxhetin e shtetit rreth 4-5 milion lekë/vit, nga regjistrimi dhe prodhimi i produkteve plehëruese, të cilat

do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë, standardeve dhe rritjen e eksporteve të produkteve bujqësore.

Rëndësi e veçantë i kushtohet informimit të grupeve të interesit nëpërmjet faqes zyrtare të MBZHR-së, medias së shkruar ose elektronike.

Ligji nr. 10390, datë 3.3.2011 òPër plehrat e përdorimit për bimësinë (që është shfuqizuar), ka përafruar Rregulloren e Bashkimit Europian nr.2003/2003 të Parlamentit dhe Këshillit Europian. Sqarojmë se ligji në fjalë nuk ka përafruar *acuqis* të BE-së, por i është referuar kësaj rregulloreje të BE-së, pasi përafrimin e ka bërë VKM nr 774, datë 07.11.2012, òPër rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat e listën e tipave të plehërave. Duhet theksuar se Rregullorja nr.2003/2003 e Parlamentit dhe Këshillit Europian, i referohet vetëm plehërave që qarkullojnë në vendet e BE-së, ndërsa kategoria tjetër regjistrohën. Direktiva BE 2016/681 e Parlamentit dhe Këshillit datë 27.04.2016, mbi përdorimin e të dhënave të regjistrimit í ..Numri CELEX 32016L0681, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.119, datë 04.05.2016, faqe 132-149, është reflektuar në ligjin e ri.

Bazuar në nenet 15 e 36 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 òPër licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, VKM-në nr. 538, datë 26.05.2009), Institucioni tjetër që përfshihet në vendimmarrjen për licencë të PPP, i cili vendos për mënyrën e organizimit të punës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të cilat janë miratuar në fazën e parë nga QKL-ja, është AKU-ja.

Është konstatuar se deri në kohën e kryerjes së auditimit, në MBZHR nuk është krijuar Sektori i Produkteve Plehëruese (SPP), siç përcaktohet në nenet 20,21,22 dhe 32 të Ligjit nr.17/2020.

Detyrat funksionale të SPP-së janë kryer nga Sektori i PMB-ve, gjë e cila ka sjellë mbingarkesë të stafit dhe mosefektivitet të punës në këtë fushë, si në nivel qendror ashtu dhe ato të varësisë.

Bazuar në pikat 3 dhe 4 të nenit 17 të ligjit nr.17/2020 òPër përdorimin e Produkteve Plehëruese, përdorimi i PP duhet të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të përdoruesve, të konsumatorëve, të kafshëve dhe të mjedisit. Rregullat e hollësishme për prodhimin, tregtimin, ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe aktet nënligjore për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve.

14. Gjetje nga auditimi

14.1 Në zbatim të nenit 32, të Ligjit nr.17/2020 òPër produktet plehëruese, MBZHR **nuk** ka hartuar vendimin për rregullat e hollësishme për prodhimin, tregtimin, ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese.

14.2 Në nenin 30, pika 1 e Ligjit nr.17/2020 citohet: òc) gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me nenin 6, pikat 1 e 2, të nenit 14, pikën 1, të nenit 18, si dhe pikat 1, 2 e 6, të nenit 19, të këtij ligji; ç) gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me nenin 27, si dhe në rast përsëritjeje të kundërvajtjeve administrative të parashikuara në pikat 1 e 2, të nenit 14, pikën 1, të nenit 6, si dhe pikat 1, 2 e 6, të nenit 19, të këtij ligji; **Ndërkohë që në nenin 19 të ligjit nr.17/2020 “Për produktet plehëruese”, nuk ekziston pika 6.**

14.3 Në nenin 30, pika 2 e Ligjit nr.17/2020 citohet: òPër shkeljet e dispozitave të këtij ligji, të cilat, sipas pikës 1, të këtij neni, përbëjnë kundërvajtje administrative, përveç masës së vënies së gjobës, e cila është dënim kryesor, vendosen edhe dënime plotësuese, si: masa e kthimit të ngarkesave, në rastin e shkeljeve të dispozitave të nenit 27, të òPër produktet plehëruese, **ndonëse në këtë nen nuk përcaktohet se ku konkretisht duhet të kthehet ngarkesa.**

Konkluzione

14. Përsa përshkruar në gjetjet 14.1.1 dhe 14.2, nenet respektive të Ligjit nr. 17/2020 bëhen të paimplementueshme.. Mospërcaktimi i procedurave si edhe i vendit të kthimit të ngarkesave të plehrave plehëruese bëhet shkak për abuzime dhe keqpërdorim të tyre, si edhe krijon risk për shëndetin e njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit.

14.1 Rekomandimi

MBZHR, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të përgatisë aktet nënligjore sipas përcaktimeve të nenit 32 të Ligjit nr. 17/2020, në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij ligji për garantimin e shëndetit të njerëzve e të kafshëve, mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi i produkteve plehëruese, rritjen e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve me elementët ushqyes, si dhe përmirësimin e cilësive fiziko-kimiko dhe të pjellorisë së tokës; si dhe të ngrejë strukturën përkatëse.

Menjëherë

14.2 Rekomandimi

MBZHR, të marrë masat për të propozuar ndryshimet ligjore në Ligjin nr. 17/2020 për:

- rishikimin e nenit 30, pika 1 në linjë me nenin 19 dhe plotësimin e këtij të fundit;
- plotësimin e nenit 30, pika 2, duke e plotësuar me përcaktimin e saktë të vendit dhe procedurave përkatëse për kthimin e ngarkesave.

Menjëherë

14.3 Rekomandimi

MBZHR, të marrë masat për përshtatjen e legjislacionit me rregulloren e BE-së, sa i takon periudhës kalimtare të plehrave të vendosura në treg sipas të gjitha rregullave, përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri;

Brenda datës 30.09.2022

15. Gjetje nga auditimi

MBZHR, në kundërshtim me nenet 20, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 17/2020 òPër produktet plehëruese, nuk ka hartuar plotësisht aktet nënligjore në zbatim të tij, brenda afateve kohore të përcaktuara, si edhe nuk ka krijuar Strukturën përgjegjëse për produktet plehëruese.

15. Konkluzioni

Ndryshimet dhe reformat e zbatuara vitet e fundit në MBZHR, kanë bërë që të mos të ketë ndarje të qarta të përgjegjësive dhe kompetencave për menaxhimin, monitorimin dhe analizimin e produkteve plehëruese. Në MBZHR nuk është krijuar struktura përgjegjëse për produktet plehëruese, funksion ky që kryhet si mbingarkesë e sektorit të PMB-ve dhe ka vonesa në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, dhe mungesë angazhimi të plotë për zbatimin e këtij ligji nga strukturat e varësisë.

15.1 Rekomandimi

MBZHR, në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij ligji për garantimin e shëndetit të njerëzve e të kafshëve, mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi i produkteve plehëruese, rritjen e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve me elementët ushqyes, të marrë masa dhe të ngrejë strukturën përgjegjëse përkatëse për produktet plehëruese.

Brenda datës 30.09.2022

Aktet ligjore të BE për regjistrimin, tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve.

1. Direktiva e Këshillit 79/117/EEC e 21 dhjetor 1978 në lidhje me ndalimin e vendosjes në treg dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve me përmbajtje të lëndëve vepruese të

caktuara. Ky akt është bazuar në hartimin e *listës negative*, pra mbi bazën e heqjes së lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve.

2. Direktiva e Këshillit 91/414/EEC e 15.07.1991 në lidhje me vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve. Ky akt është bazuar në hartimin e *listës pozitive*, pra mbi bazën e miratimit të lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve (Shtojca 1).

3. Rregullorja (EC) Nr.1107/2009 e Parlamentit Europian dhe Këshillit Europian e 21.10.2009 ÷Për hedhjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve÷ dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 79/117/EEC dhe Direktiven e Këshillit 91/414/EEC. Celex 32009R1107.

4. Rregullorja implementuese e Komisionit (EU) No 540/2011 e 25.05.2011 duke implementuar Rregulloren (EC) Nr 1107/2009 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, lidhur me miratimin e listës së lëndëve vepruese. Celex 32011R0540. Në këtë rregullore bazohet dhe urdhëri i ministrit nr.72, date 02.03.2017, ÷Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve÷, i ndryshuar.

Në Shqipëri, deri në vitin 1994 PMB-të janë tregtuar dhe përdorur pa një bazë të caktuar paraprake të regjistrimit të tyre. Pra nuk ka patur një rregull të përcaktuar ligjor.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7662, datë 19.01.1993, ÷Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve÷, hedhja në treg e PMB-ve, filloi të organizohet mbi një bazë të re (me regjistrimin e tyre).

Me ligjin nr. 9362, datë 24.3.2005, ÷Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve÷, të ndryshuar, është bërë një hap tjetër cilësor në fushën e PMB-ve, pasi u përcaktua *lejimi i regjistrimit të PMB-ve që janë regjistruar paraprakisht në një vend të BE-së*.

Me ligjin Nr. 105/2016, ÷Për mbrojtjen e bimëve÷ janë cituar aktet nënligjore që përshtasin legjislacionin e BE-së në fushën e PMB-ve.

Regjistrimi i PMB-ve sipas viteve.

Regjistrimi i PMB-ve në Shqipëri ka filluar *për herë të parë në vitin 1994*, dhe çdo vit ky proces ka evoluar dhe është përmirësuar, saqë tani është krijuar një përvojë e mirë në këtë fushë.

Në vitin 1994 kanë aplikuar për herë të parë në Shqipëri 2 aplikante dhe janë regjistruar 12 lloje PMB.

Aktualisht janë të regjistruara në Shqipëri 325 lloje PMB (sipas listës së publikuar në linkun e ministrisë, Qershor 2021).

Janë regjistruar dhe reregjistruar për vitet 2018-2021 gjithsej 86+33 PMB, të ndarë sipas viteve: viti 2018 janë regjistruar 21+8 PMB. viti 2019 janë regjistruar 15+1 PMB. vitin 2020 janë regjistruar 6+24 PMB dhe në vitin 2021 janë regjistruar 14 PMB.

Për vitet 2018-2021, janë hequr nga regjistrimi 174 PMB, të ndarë sipas viteve:

- viti 2018 janë hequr 98 PMB (97 lloje janë hequr pas rivlerësimit).

- viti 2019 janë hequr 18 PMB.

- viti 2020 janë hequr 12 PMB dhe vitin 2021 janë hequr 46 PMB dhe për të gjitha heqjet është njoftuar zyrtarisht çdo aplikant.

Numri i lëndëve vepruese me profil të *rrezikut të lartë është shumë i ulët (5 gjithsej)* dhe do të ulet më tej në të ardhmen, duke shkuar drejt heqjes së plotë.

Regjistrimi paraprak dhe hedhja në treg e PMB-ve bazohet në kërkesa rreptësisht të përcaktuara, ku kërkesat dhe rregullat e regjistrimit do të vijojnë të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme e në përshtatje dhe me legjislacionin Europian për PMB-të.

Në auditimin e kryer me zgjedhje për periudhën e auditimit, kemi marrë për shqyrtim praktikat

për të tre vitet 2018, 2019 e 2020, nga një procedurë të plotë të mbledhjes së Komisionit të Regjistrimit të PMB-ve (KRPMB), ku nga verifikim i kryer, rezultoi se:

- Për vitin 2018, është kryer mbledhja me datë 27.12.2018 e KRPMB, është mbajtur procesverbal i regjistruar me nr. 10700/1 prot, datë 20.12.2018, ku kanë marrë pjesë të pesë anëtarët e komisionit dhe pas shqyrtimit, është miratuar regjistrimi i 12 PMB-ve dhe riregjistrim të një PMB-je me emrin tregtar ZATO 50 ËG si dhe dy ndryshim formulimi 1 PMB, sipas listës mëposhtme:

Tabela 5: Lista e PMB-ve, miratuar për regjistrim datë 27.12.2018

Regjistrim		
Emri tregtar	Aplikanti	Prodhuesi dhe Linjat e Fabrikimit
FROMYL	Industrias Afrasa, SA.	Spanjë
AIRONE ËG	Isagro S.p.A	Itali
AMPLIGO 150 ZC	Syngenta Crop Protection AG	Zvicër
ATONIK	Asahi Chemical Europe s.r.o	Belgjikë
DIMBO 480 SL	Gharda Chemicals Limited.	Angli dhe Itali.
GALLUP SUPER 360	Barclay Chemicals Manufacturing Ltd	Irlandë
METOMOR F	Sharda Cropchem España SL	Indi dhe Kinë
MYCLOFIL 12.5 EC	Indofil Industries Limited	Indi
PROXIMO	Industrias Afrasa, SA.	Spanjë
RITUAL 12.5 EC	Industrias Afrasa SA.	Spanjë
WOPRO ALIEN ËG	Simonis B.V	Holandë
NOVATUTA	Novagrica Hellas SA	Greqi
Riregjistrim		
ZATO 50 WG	Bayer AG	Gjermani
Ndryshim në formulim		
SENCOR SC 600	Bayer AG.	Gjermani

Sqarojmë se: nga verifikimi i kryer në dokumentacionin e administruar dhe paraqitur nga aplikantët, nuk u konstatuan mungesë dokumentacioni si ligjor dhe teknik. Nga grupi i auditimit u verifikuan rastet e regjistrimit të tre PMB-ve, të cilat janë prodhuar: METOMOR F në Indi dhe Kinë me aplikant Sharda Cropchem España SL, ku rezultoi se ky lloj PMB-je është i regjistruar në Europë, konkretisht Spanjë, por prodhohet në Indi dhe Kinë sipas të dhënave të dokumentacionit teknik (Identiteti i PMB-së). Në këtë rast aplikanti nuk ka paraqitur të dhëna teknike të dosjes për lëndën vepruese, por ka paraqitur vetëm dokumentin që provon se ajo është mbrojtur në BE nga aplikanti, siç e kërkon pika 2, e kreut IV, e VKM 335, datë 06.06.2018. Pra nuk ka pengesa ligjore si nga legjislacioni europian, por dhe nga legjislacioni shqiptar konkretisht neni 19, pika 1,2 e 5, të ligjit nr.105/2016 òLigji për mbrojtjen e bimëveò, ku citohet:

Në nenin 19 òRegjistrimiò, citohet:

1. Të gjitha PMB-të që tregtohen ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit.
2. Në Republikën e Shqipërisë regjistrohen vetëm PMB-të, të cilat janë të regjistruara në një nga vendet e Bashkimit Europian.
5. Miratimi i lëndëve vepruese, i përbërësve të tjerë në përmbajtje të PMB-ve, i të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-ve, si dhe përditësimi i tyre, në përputhje me

legjislacionin e BE-së, bëhen me urdhër të ministrit.

Po kështu, është vepruar dhe me tre aplikimet e tjera me prodhues në Izrael konkretisht: PMB-ja me emrin tregtar KESTREL aplikanti òADAMA Agriculture BVò origjina/prodhuar Izrael. PMB-ja me emrin tregtar LEOPARD 5 EC, aplikanti òADAMA Agriculture BVò origjina/prodhuar Izrael, PMB-ja me emrin tregtar NICOGAN aplikanti òADAMA Agriculture BVò origjina/prodhuar Izrael dhe PMB-ja me emrin tregtar MIMIC, aplikanti Nisso Chemical Europe origjina/prodhuar në Japoni dhe Austri.

U konstatua se dosjet teknike të paraqitura ishin të plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 335, datë 06.06.20218 òPër miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve²⁰

Pra, siç shikohet, qëndron vlerësimi që rregullat për miratimin e regjistrimit dhe përdorimit të PMB-ve janë shumë strikte dhe të kontrollueshme, veçanërisht dhe nga institucionet përkatëse të BE-së.

- Për vitin 2019 u zgjodh dokumentacioni i hartuar për mbledhjen e KRPMB me datë 08.05.2019 me procesverbal të protokolluar me nr. 3963 prot., datë 16.05.20219 dhe rezultoi se në këtë mbledhje kanë marrë pjesë dhe nënshkruar të pesë anëtarët e komisionit dhe, pas shqyrtimit, është miratuar regjistrimi i 15 PMB-ve, si dhe reregjistrim të një PMB me emrin tregtar POLTIGLIA BORDOLESE DISPERS BLU, aplikant UPL Europe Ltd, e prodhuar në Angli, Hollandë ,Francë dhe Indi dhe prodhuar jashtë BE-së, por të regjistruara janë 11 PMB, sipas listës së mëposhtme:

Tabela 6: Lista e PMB-ve miratuar për regjistrim datë 16.05.2019

Regjistrim		
Emri tregtar	Aplikanti	Prodhuesi dhe Linjat e Fabrikimit
AZUMO 80 ÈG	Azufre y Fertilizantes Pallarés SA (AFEPASA).	Spanjë
BARBARIAN SUPER 360	Barclay Chemicals Manufacturing Ltd	Irlandë
BASAR	Galenika-Fitofarmacija d.o.o	Serbi
DAKOFABA	Serbios S.r.l.	Greqi
DASKOR 440 EC	Arysta LifeScience Benelux SPRL	Belgjikë
GASTOXIN	Detia Freyberg GmbH	Gjermani
KESTREL	ADAMA Agriculture BV	Izrael
LEOPARD 5 EC	ADAMA Agriculture BV	Izrael
MIMIC	Nisso Chemical Europe	Japoni dhe Austri
NICOGAN	ADAMA Agriculture BV	Izrael
OPTIX 80 DISPERS	UPL Europe Ltd	Angli, Francë dhe Indi
PENDIGAN	ADAMA Agriculture BV	Izrael
QUALY	ADAMA Agriculture BV	Izrael
SERCADIS PLUS	BASF Agro BV	Zvicër
SHARPEN	Sharda Chropchem Espana SL	Indi

²⁰ Ky vendim është përafuar pjesërisht me Direktivën 2009/128/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, 21 tetor 2009, për krijimin e një kuadri për veprim të Komunitetit për të arritur përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve (tekst me rëndësi për ZEE) numri CELEX: 32009L0128, Fletore Zyrtare e BE, seria 309, datë 24.11.2009, faqe 71-86.

Riregjistrim		
POLTIGLIA BORDOLESE DISPERS BLU	UPL Europe Ltd	Angli, Holandë, Francë, Indi.

Burimi:Proces verbal i KRPMB dhe regjistri i PMB-ve në MBZHR

- Për vitin 2020 është kryer mbledhja me datë 24.04.2020 të KRPMB (është zhvilluar online për shkak të pandemisë Covid 19) është mbajtur procesverbal, i regjistruar me nr. 3160 prot, datë 04.05.2020, ku kanë marrë pjesë dhe nënshkruar të pesë anëtarët e komisionit dhe, pas shqyrtimit, është miratuar regjistrimi i 23 PMB-ve dhe janë refuzuar 7 PMB. Dhe nga këto, 9 PMB nuk janë prodhuar në Europë, konkretisht sipas listës mëposhtme:

Tabela 7: Lista e PMB-ve miratuar për regjistrim datë 24.04.2020

Regjistrim			
Emri tregtar	Aplikanti	Vendi ku është regjistruar në BE	Prodhuesi dhe Linjat e Fabrikimit
COBRE KEY	Industrial Química Key SA	Spanjë	Spanjë
ABAMAX 1.8 EC	Rotam Agrochemical Europe Ltd	Greqi	Angli
CURAME 25 ËG	Manica SpA.	Portugali	Itali
FONTELIS	DuPont Hellas SA.	Greqi	Zvicer
ROCINANTE	Proplan-Plant Protection Company	Spanjë	Spanjë
AVALON	Galenika-Fitofarmacija doo	Austri	Serbi
BONACA	Galenika-Fitofarmacija doo	Sloveni	Serbi
PROMESA	Galenika-Fitofarmacija doo	Angli	Serbi
POLUX	Galenika-Fitofarmacija doo	Grqi	Serbi
QUANTUM R-OK	ADAMA Makhteshim Ltd	Spanjë	Izrael
BION 50 WG	Syngenta Crop Protection AG	Itali	Zvicer
GRIFON SC	ISAGRO SpA.	Çeki	Itali
ORTIVA TOP	Syngenta Crop Protection AG	Greqi	Zvicer
TARGA 5 EC	& Efthymiadis SA	Greqi	Francë
ACARIDOIL 13 SL	Vioryl SA	Greqi	Greqi
ECOTHRIN 5 SC	Vioryl SA	Greqi	Greqi

ESTIUOIL	Exclusivas Sarabia SA	Itali	Spanjë
DELMUR	Exclusivas Sarabia SA	Itali	Spanjë
CHALLENGE 600	Bayer doo	Slloveni	Gjermani
LYPHASE 36 SL	Vioryl SA	Greqi	Greqi
PROFILER	Bayer doo	Slloveni	Gjermani
PROSPER CS 300	Bayer doo	Austri	Gjermani
SIVANTO PRIME	Bayer doo	Slloveni	Gjermani
Mosmiratim regjistrimi			
ACETAMEX 20 SP			
ACRAMITE 480 SC			
KEYFOL ËG			
GEOXE 50 ËG			
DIASTAR MAXI			
PENDINOVA			
PILAROUND 360 SL			

Në VKM Nr. 335/2018 òPër miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëveò, përcaktohen procedurat e regjistrimit të PMB-ve. Në kushtet e mosfunksionimit normal të institucioneve dhe strukturave përkatëse kanë zgjatur procedurat e regjistrimit të PMB-ve, të cilat shoqërohen me humbje të faktorit òKohëò, si dhe pakënaqësi te grupet e ndryshme të interesit.

Bazuar në pikën 5.6.) paragrafi 5, Kreu II i VKM-së nr. 335, datë 6.6.2018 òPër miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëveò, dokumentet e regjistrimit (certifikata dhe etiketa) të PMB-ve të miratuara përgatiten nga sekretari dhe firmosen nga kryetari i komisionit brenda 10 ditëve, nga data e mbledhjes së komisionit. Në rastet e përmbushjes së kërkesave të përgjithshme, të përcaktuara në këtë vendim, dokumentacioni teknik i PMB-së, në dosje dhe në formë elektronike (CD), dërgohet në ISUV menjëherë pas përfundimit të verifikimit të kryer nga sekretari, por jo më shumë se 25 ditë, nga data e marrjes në dorëzim të dosjes.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe korespondencave të SPMB-së me kryetaren e KRPMB-ve u evidentuan vonesa dhe mosrespektim i afateve ligjore të përcaktuara në, zhvillimine mbledhjeve të komisionit për vitin 2020 për shkak të zhvillimit online, si edhe kthimin e përgjigjes nga ISUV-i lidhur me detyrimin ligjor të vlerësimit në procedurën e regjistrimit të PMB-ve. Kjo ka ardhur nga mospërmbushja e detyrimit ligjor që ka patur ISUV-i për të bërë vlerësimin e dokumentacionit teknik të përmbushjes së parametrave të regjistrimit të PMB-ve. Ky detyrim është i shprehur dhe në kërkesat ligjore të germës a), pika 1. 2.) e nenit 5 të Ligjit nr. 105/2016, ku citohet: *“Laboratori i analizave cilësore të PMB-ve, si dhe ai i mbetjeve të tyre në bimët e në produktet me origjinë bimore, pranë ISUV-it, ka për detyrë: a) vlerësimin e dokumentacionit të PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit të tyre.”* Ky mosveprim në përmbushje e detyrimit të ISUV lidhur me respektimin e afateve, ka sjellë pasojë vonesa të pajustificuara të kryerjes së procedurave të regjistrimit duke lënë hapësira për shmangie nga kadri ligjor dhe abuzime. Duke marrë në konsideratë trendin në rënie të përdorimit të PMB-ve, procedurat e regjistrimit të PMB-ve mund të përshpejtohen, pse jo duke marrë në konsideratë dhe parimet e njohjes reciproke me shtetet fqinje anëtare të BE-së. Por, kjo aktualisht është e pamundur pasi ky parim zbatohet mes vendeve anëtare të BE-së, që kanë rregulla të unifikuara për regjistrimin e PMB-ve.

16. Gjetje nga auditimi

-Në kundërshtim me Ligjin nr. 105/2016 òPër Mbrojtjen e Bimëveò dhe VKM-në nr. 335/2018 òPër miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëveò, ISUV-i, si strukturë përgjegjëse për regjistrimin e PMB-ve, nuk ka zbatuar afatet ligjore të përcaktuara për kthimin e përgjigjeve lidhur me detyrimin ligjor të vlerësimit teknik në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga subjektet e ndryshme, sipas detyrimit ligjor.

-Komisioni i Regjistrimit të PMB-ve, nuk ka respektuar afatet ligjore në zhvillimin e mbledhjeve (online) si dhe janë konstatuar vonesa 6-10 ditë në zbardhjen e vendimit nga data e vendimmarrjes së komisionit.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 45-50 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

Në lidhje me Projekt Raportin mbi Auditimin e Performancës, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 613/3 prot., datë 26.01.2022, grupi i auditimit i KLSH-së në përmbushje të pikave të programit të auditimit nr. 613/1 prot., datë 02.08.2022, me objekt "Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi dhe siguria ushqimore", ka paraqitur disa sqarime me shkresën e protokolluar në ISUV me nr. 165 prot., dt. 21.02.2022 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 613/4 prot., datë. 23.02.2022, si më poshtë:

Gjetja Nr.18 ku citohet: "Në kundërshtim me ligjin Nr 105/2016 dhe VKM Nr. 335/2018 ISUV, si strukturë përgjegjëse për regjistrimin e PMB nuk ka zbatuar afatet ligjore të përcaktuara për kthimin e përgjigjeve lidhur me detyrimin ligjor të vlerësimit teknik të dokumentacionit për këtë procedurë". Vonesat në vlerësimin teknik të PMB-ve për sa i takon ISUV ka ardhur si pasojë e deficiteve ligjore të cilat janë diskutuar në takimet e komisionit për regjistrimin e PMB-ve dhe si rrjedhojë kemi qenë të detyruar të dërgojmë propozimin lidhur me nevojat për ndryshimet ligjore në VKM 335/2018. Propozimi i dërguar në ministri me shkresë Nr.1186 Prot, datë. 05.12.2019. Mbas kësaj ministria miraton urdhrin Nr.174, datë 04.05.2020 "Për miratimin e të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-ve". Miratimi i këtij urdhri plotësoi vakancat ligjore dhe si rrjedhojë u harmonizua procesi i vlerësimit të dosjeve të PMB duke respektuar afatet kohore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket sqarimit të mësipërm nga ana juaj, shprehemi dakord me përmbushjen e detyrimit ligjor të ISUV brenda afatit kohor të përcaktuara.

16. Konkluzioni

Janë evidentuar vonesat dhe mosrespektim i afateve ligjore të përcaktuara për kthimin e përgjigjes nga ISUV-i lidhur me vlerësimin teknik të dosjes në procedurën e regjistrimit të PMB-ve, duke lënë hapësira për shmangie nga kuadri ligjor dhe abuzime.

16.1 Rekomandimi

MBZHR, të marrë masat për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien nga Komisioni i Regjistrimit të PMB-ve dhe ISUV për zbatimin dhe respektimin e afateve ligjore në procesin e regjistrimit, për të shmangur vonesat e pajustificuara që çenojnë integritetin e procesit të regjistrimit të PMB-ve.

Menjëherë dhe vijimësi

Në Agjendën 2030 të OKB-së për Zhvillimin e Qëndrueshëm, duke premtuar eliminimin e varfërisë së skajshme, uljen e pabarazisë dhe krijimin e një planeti më të gjelbër, ndër 17 Synime Globale të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-të), të cilat janë të ndërlidhura, universale, gjithpërfshirëse dhe të pandashme, dhe promovojnë të drejtat e njeriut dhe qëndrueshmërinë ekonomike, sociale dhe mjedisore, tre të parat janë:

Objektivi 1: Eliminimi i varfërisë në të gjitha format kudo.

Objektivi 2: Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe

nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.

Objektivi 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe²¹.

Komisioni Evropian me planet e tij për një politikë më miqësore ndaj mjedisit të Bashkimit Evropian për bujqësinë dhe biodiversitetin, të cilat janë pjesë e politikës kryesore të ÷Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, ka prezantuar strategjinë nga "Ferma në pirun" për të reduktuar përdorimin e pesticideve dhe antibiotikëve dhe për të përmirësuar produktet plehëruese.

Strategjia, e përbërë nga 27 veprime kyçe, synon "Të pajtojë sistemet tona ushqimore me shëndetin e planetit tonë, të sigurojë sigurinë ushqimore dhe të përmbushë aspiratat e evropianëve për ushqim të shëndetshëm, të barabartë dhe eko-miqësor"²².

Komisioni i BE-së për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore thekson se politika synon të reduktojë përdorimin e pesticideve dhe mbetjet ushqimore me 50%, deri në 2030. Pesticidet sintetike do të synojnë të zëvendësohen nga biopesticidet.

Është e rëndësishme që të krijohen kushte lehtësuese për regjistrimin e një kategorie të caktuar të PMB-ve, si:

- Rregullore e re e rritjes së bimëve (*po zëvendësohen me substanca bimore, duke kaluar gradualisht drejt përdorimit si produkte plehëruese me veprim specifik biostimulante bimore nga ekstraktetbimore, kryesisht nga algat e detit*), induktuesit e rezistencës.
- PMB-të bio me origjinë bimore, kërpudhore, bakteriale dhe virusale.
- Një gamë më e gjerë e herbicideve, pasi ende vazhdohet që të mos kenë vendin e duhur në përdorim tek ne.
- Stimulim i regjistrimit të PMB-ve të grupeve të reja kimike (brenda grupit të Insekticideve, Akaricideve, Nematocideve dhe Fungicideve) dhe që kanë impakt sa më të vogël mbi mjedisin ku përdoren dhe që lënë me pak mbetje tek bimët dhe produktet bimore, tek të cilat përdoren këto herbicide.

Lidhur me procesin e regjistrimit në Shqipëri, problem shqetësues janë PMB e fallsifikuara dhe të paregjistruara, të cilat nuk përfshihen në listat e PMB-ve të regjistruara në BE.

Me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 335/2018, me krijimin e KRPMB pranë MBZHR-së ky fenomen po reduktohet dhe lista e PMB-ëve të miratuara, që janë ato të regjistruara në BE publikohet online për të informuar grupet e nteretit.

Në mediat audiovizive, janë pasqyruar dukuri për hyrjen e pesticideve të fallsifikuara dhe të paregjistruara, të cilat kanë ndikuar negativisht te publiku për të krijuar një perceptim të gabuar lidhur me PMB-të.

Konkretisht:

- Sunfire 240 SC, ky insekticid i rrezikshëm është i ndaluar të përdoret në Shqipëri, pasi nuk është pjesë e listës së produkteve tëmbrojtjes së bimëve, të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, lëndave vepruese e të cilit (chlorfenapyr) është e ndaluar në Shqipëri dhe në Bashkimin Evropian²³.

²¹<https://www.dw.com/en/eu-presents-green-deal-farming-plan-to-half-pesticide-use/a-53511139>.

²²Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

²³ <https://top-channel.tv/video/sunfire-hyn-kontrabande-pesticidi-i-ndaluar-ne-treg-vjen-nga-serbia-dhe-greqia/> ²³
"Sunfire 240 SC"

- Pesticide të reja kontrabandë -helmet bujqësore kontrabandë, apo të pakontrolluara që hyjnë në tregun shqiptar, janë një fenomen deri para disa javësh i panjohur publikisht, por që ndodhte rëndom²⁴.

Në PRKE 2019²⁵ citohet se: *“Përveç miratimit të inspektimeve të bazuara te rreziqet, së bashku me fushat e tjera të sigurisë ushqimore dhe politikës veterinare, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe investimeve në objektet e pikave të kontrollit kufitar”*.

Kontrolli i parë i produkteve për mbrojtjen e bimëve kryhet ngainspektorët e AKU-së në pikat e inspektimit kufitar, të cilët siç deklarohet në pyetësor kanë mjaft vështirësi dhe mungesa të infrastrukturës inspektuese, mungesë burimesh njerëzore, etj. Nga të dhënat e marra nga DRAKU-të konstatohet se Portali Unik “*e-inspektimi*”, si sistemi i hedhjes dhe menaxhimit të të dhënave inspektuese online, fillimisht (2018) nuk ka gjetur zbatim për shkak se sistemi nuk pranonte inspektime vetëm me një inspektor, etj. Nga përgjigjet e pyetësorit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), konstatohet dhe është pranuar se nuk ka kryer analiza cilësore të PMB-ve, (për mungesë fondesh, *njoftuar me shkresë zyrtare dhe njoftim elektronik*) dhe për këtë arsye nga AKU për vitin 2018 nuk janë marrë mostrapër kontrollin cilësor të PMB-ve.

17. Gjetje nga auditimi

Është konstatuar se kontrolli i PMB-ve në pikat e inspektimit kufitar (PIK), **nuk** kryhet nëpërmjet sistemit online “*e-inspektim*”, i cili synon krijimin një sistemi modern inspektimesh, si dhe garanton procese të realizueshme në një kohë më të shpejtë, konkurrencë të lirë dhe transparente, në mbrojtje të interesit publik. Në verifikimin e kryer në disa pika kufitare si Vlorë, Gjirokastrë Korçë, rezultoi se infrastruktura është e papërshtatshme për kryerjen e inspektimeve.

17. Konkluzioni

Moskryerja e kontrollit në pikat e inspektimit kufitar (PIK) nëpërmjet sistemit online “*e-inspektim*”, si edhe infrastruktura e papërshtatshme për kryerjen e tyre, ndikon në faktorin ÷kohë÷, për një realizim me eficiencë më të mirë të procesit si edhe në mungesën e transparencës, veçanërisht për grupet e interesit dhe publikun.

17.1 Rekomandimi

MBZHR, në bashkëpunim me AKU dhe Inspektoriati Qendror (IQ) të marrin masat që kontrolli zyrtar në PIK të kryhet nëpërmjet sistemit online, të sigurohen kapacitetet inspektuese të duhura, si dhe të kryhen investimet në infrastrukturë, për të rritur eficiencën e punës.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi

AKU nuk i ka në eficiencë të plotë 4 laboratorët e analizave fitosanitare, për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe kapaciteteve laboratorike (mungesa kitesh dhe aparatura jashtë funksionimit). Në këto kushte, investimi prej 1,3 milion lekë, i kryer në vitin 2019 me fonde të BE-së, nuk ka rezultuar efikas.

18. Konkluzioni

Mos funksionimi me eficiencë të plotë i laboratorëve të analizave fitosanitare, cënon cilësinë e shërbimit të ofruar në kohën e duhur dhe nuk jep siguri për rezultatet e analizave.

18.1 Rekomandimi

MBZHR në bashkëpunim me AKU- në të marrë masat për vënien në eficiencë të plotë të laboratorëve rajonalë fitosanitarë të mbrojtjes së bimëve.

Menjëherë

²⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=QMltNeCiDCI>

²⁵ Progres Raporti 2019

Në vendin tonë ekziston një kuadër ligjor mbi tregtimin, transportin, ruajtjen, magazinimin dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB). Bazuar në këtë legjislacion, në vendin tonë lejohen të importohen, tregtohen dhe përdoren vetëm PMB-të e regjistruara. Përmbajtja e lëndëve aktive në formulim, kushtet e ruajtjes dhe përdorimit, duhet të jenë në përputhje me përcaktimet në etiketën e produktit.

Tregtimi i PMB-ve

Në nenin 20 të ligjit 105/ 2016, citohet se:

1. *Lejohet tregtimi me shumicë dhe me pakicë i PMB-ve të regjistruara.*

2. *Tregtimi me shumicë dhe pakicë i PMB-ve bëhet nga persona fizikë, të diplomuar në fushën e agronomisë, ose nga persona juridikë, të cilët duhet të punësojnë një ose disa persona, teknikë përgjegjës, të cilët janë diplomuar në këtë fushë.*

3. *Tregtia e PMB-ve përfshihet në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit nr.10081, datë 23.02.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Tregtimi me shumicë dhe me pakicë i PMB-ve me rrezik dhe i PMB-ve me rrezik të lartë kryhet me licencë, të lëshuar sipas kërkesave të legjislacionit, në zbatim të ligjit nr.10081, datë 23.02.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."*

Bazuar në VKM-në nr. 532, datë 11.09.2018, për miratimin e rregullave për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, bëhet tregtimi, transporti, ruajtja dhe magazinimi i PMB-ve. Ky vendim nuk ka përfrim me legjislacionin e BE-së, pasi çdo shtet ka të drejtën e rregullimit të këtij aktiviteti dhe për zbatimin e kësaj VKM-je janë të ngarkuara AKU dhe ISUV.

VKM-ja përcakton kërkesat për licencimin e veprimtarive të tregtimit me shumicë dhe të tregtimit me pakicë të PMB-ve si dhe kushtet dhe kërkesat gjatë kryerjes së këtyre veprimtarive pas licencimit, nga importi deri tek veprimtaria e shitjes me pakicë të tyre. Përcakton institucionet shtetërore dhe detyrat e secilit prej tyre në procesin e miratimit për licensim si dhe në kryerjen e inspektimeve (që është AKU) dhe të analizimit të mostrave të PMB-ve në treg (që është ISUV). Rëndësi e veçantë i kushtohet rregullave për tregtimin e PMB-ve të helmuesë, sidomos të PMB-ve që janë gaze helmuese ose që çlirojnë gaze helmuese (fosfina e çliruar nga formulimet me përmbajtje aluminium phosphide, magnesium phosphide), për të parandaluar dhe kufizuar helmimet aksidentale apo të qëllimshme të njerëzve, fenomen shqetësues prej vitësh me humbje jete. Ligji përcakton AKU-në si institucion për monitorimin e tregtimit të tyre nga importi deri tek përdoruesi i fundit.

Inspektimi i PMB-ve që ndodhen në treg, lidhur me plotësimin e kërkesave ligjore për tregtim, kryhet në bazë të planit vjetor të inspektimeve me bazë rrezik, të miratuar nga ministri i MBZHR dhe mbikqyrjen e Inspektoriatit Qendror.

Kontrulli për cilësinë e PMB-ve të vendosura në treg, kryhet në bazë të planit vjetor të marrjes dhe analizimit të mostrave, të miratuar nga ministri.

-Në zbatim të nenit 7 të Ligjit Nr. 105/2016, pavarësisht se të gjitha detyrimet që mbulon pasaporta bimorë aktualisht mbulohen nga Certifikata Fitosanitare e Brendshme, MBZHR nuk ka nxjerrë udhëzimin për kushtet dhe kriteret për autorizimin e prodhuesve të bimëve dhe produkteve bimorë, pasi nuk ka prodhues të autorizuar dhe nuk ka kryer miratimin e pasaportës bimorë, detyrim ligjor të DRB-ve. Nga përgjigjet e pyetësorëve, grupit të auditimit ju konfirmua se në draftamendimin e Ligjit nr.105/2016 për mbrojtjen e bimëve është parashikuar e plotë dispozita autorizuese, e cila do të zgjidhi dhe problemin e pasaportës bimorë.

19. Gjetje nga auditimi

-Si pasojë e mosmiratimit të kriterëve për autorizimin e prodhuesve nga MBZHR, ende vijon të mos ketë prodhues të autorizuar, në kundërshtim me kërkesat e nenit 7, të Ligjit nr. 105/2016 *ËPër mbrojtjen e bimëve*.

-Edhe pse në draft amendimin e Ligjit nr.105/2016 *ËPër mbrojtjen e bimëve* është parashikuar e plotë dispozita autorizuese, e cila do të zgjidh problemin e pasaportës bimore, deri tani rezulton se MBZHR ende nuk ka miratuar *ËPasaportën Bimore*, në kundërshtim me kërkesën ligjore të mësipërme.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 52-53 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

19. Konkluzioni

Mosnxjerrja nga MBZHR e udhëzimit për kushtet dhe kriteret për autorizimin e prodhuesve të bimëve dhe produkteve bimore; si dhe mosmiratimin e *ËPasaportës Bimore*, si detyrim ligjor, nuk i shërben rritjes së përgjegjësinë profesionale të përdoruesve të fundit të PMB-ve.

19.1 Rekomandimi

Me amendimin e Ligjit nr.105/2016 *ËPër mbrojtjen e bimëve*, të hartohet edhe udhëzimi për kushtet dhe kriteret për autorizimin e prodhuesve të bimëve dhe produkteve bimore; si dhe të përcaktohet e plotë dispozita autorizuese për pasaportën bimore.

Brenda datës 30.09.2022

Shitja e PMB-ve shumë helmuese lejohet vetëm për përdoruesit profesionistë, të cilët janë persona të diplomuar në fushën e agronomisë ose persona, të cilët i janë nënshtruar një trajnimit të përshtatshëm për përdorimin e PMB-ve shumë të rrezikshme dhe janë pajisur me dëshmi aftësie të veçantë për këtë përdorim. Lëshuesi i recetës mban përgjegjësi, në rast plotësimi të pasaktë të saj, për dëmin e shkaktuar te bimët ose produktet bimore të trajtuara.

-Në pikën 6 /b, të nenit 20, Ligjit nr. 105/2016 *ËPër Mbrojtjen e Bimëve* citohet: *“Në njësitë e tregtimit me pakicë të PMB-ve ndalohet shitja e PMB-ve helmuese dhe shumë helmuese pa recetë”*. Në VKM nr.532, datë 11.9.2018 *ËPër miratimin e rregullave për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve*, citohet: *“f) “Recetë”, formati për përshkrimin e PMB-së, i printuar dhe i lëshuar nga specialisti i diplomuar agronomë. Nga përgjigjet e pyetësorëve është konstatuar se bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, drejtuesit teknik të njësitë të tregtimit me pakicë të PMB-ve (të diplomuar në fushën e agronomisë) lëshojnë receta për tregtimin e PMB-ve helmuese dhe shumë helmuese.*

20. Gjetje nga auditimi

Referuar VKM nr. 532, datë 11.09.2018 *ËPër miratimin e rregullave për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve*, parashikohet përcaktimi i recetës, si një format për përshkrimin e PMB-së, që printohet dhe lëshohet nga specialisti i diplomuar agronom²⁶. Në njësitë e tregtimit me pakicë të PMB-ve ndalohet shitja e PMB-ve helmuese dhe shumë helmuese pa recetë nga agronomi i diplomuar, ndërkohë që në këto njësi nuk ka specialistë agronom, për lëshimin e recetës, të cilët të kenë marrë certifikatën e ushtrimit të këtij profesioni.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 54 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

20. Konkluzioni

Mungesa e specialistëve të diplomuar agronom të licencuar, (profesion i rregulluar) të cilët nevojiten për lëshimin e recetës në njësitë e tregtimit me pakicë për PMB helmuese dhe shumë helmuese, ka ardhur nga mungesa e strukturës së caktuar që të licensojë agronomët dhe sjellë përdorimin e PMB-ve pa respektuar kriteret e duhura.

20.1 Rekomandimi

²⁶ Kreu II, paragrafi 6

MBZHR të rishikojë bazën ligjore për licencimin e specialistëve të diplomuar agronom, të cilët do të lëshojnë recetën në njësitë e tregtimit me pakicë për PMB helmuese dhe shumë helmuese.

Brenda datës 30.09.2022

Siguria e PMB. Etiketimi dhe paketimi

Etiketa e ushqimit përmbledh një grup informacioni që përcjell tek konsumatorët karakteristikat e produktit dhe këto informacione mund të ndikojnë në vendimet rreth blerjes së produkteve ushqimore. Siç dihet, ekziston një marrëdhënie e fortë midis etiketës ushqimore dhe sjelljeve të konsumatorit. Përmes aktivitetit të blerjes dhe konsumit, konsumatorët shprehin kulturën e tyre dhe përcaktojnë identitetin e tyre duke treguar gjithnjë e më shumë vëmendje për aspektet sociale dhe mjedisore që lidhen me bujqësinë. Etiketimi i produkteve ushqimore po bëhet gjithnjë e më shumë një element strategjik për diferencimin e produkteve në të gjithë zinxhirin e furnizimit, pasi ndikon në sjelljen strategjike të prodhuesve, që janë pjesë e zinxhirit të furnizimit dhe vetë evolucionit të etiketës. Roli i etiketës është thelbësor për të siguruar informacion të saktë në lidhje me produktet ushqimore. Me të njëjtën përgjegjësi kërkohet dhe ambalazhimi dhe etiketimi i PMB-ve si në hyrje nga importi, por dhe në ripaketim me sasi më të vogla për vetë specifikat që kanë kërkesat e fermerëve shqiptarë.

-Në pikën i. të paragrafit 1.2, të kreut VI, të VKM-së nr. 335, datë 06.06.2018 òPër miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëveò, përcaktohet se òEtiketa e PMB-ve përmban: Datën e skadencës së PMB-së, ruajtjen sipas kërkesave të përcaktuara në dosjeò.

Në ligjin për mbrojtjen e bimëve dhe në VKM-të përkatëse, nuk parashikohet një metodologji për PMB-të e skaduara, ripërdorimin e tyre, për të rifutur në lojë ato që i janë nënshtuar analizave nga laboratorit i akredituar dhe parametrat e tyre janë të njëjta me ato të dosjes së regjistrimit.

Nga përgjigjet e pyetësorëve u evidentua shqetësimi se gjatë inspektimeve të kryera nga institucionet përkatëse, janë bllokuar në njësinë e tregtimit me pakicë (farmaci bujqësore) dhe shumicë, ose janë kthyer tek furnizuesi i shumicës PMB-të e skaduara dhe ato jashtë listës së PMB-ve të regjistruara në RSH.

Deri më tani është vepruar bazuar në pikën 2/ç, të nenit 43, të Ligjit nr.10 433, datë 16.06.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò. Sasitë e skaduara, bllokohen nga AKU në njësitë e tregtimit me pakicë dhe shumicë, në disa raste, kthehen tek tregtuesi i shumicës me faturë kthimi. Më tej në inspektimet e planifikuara verifikohet statusi i tyre. Bllokimi në njësitë e tregtimit me pakicë dhe shumicë nuk i jep zgjidhje problematikës, pasi përbën rrezik si dhe krijon problematika në marrëdhëniet midis grupeve të interesit të tregtimit të PMB-ve.

-Në procesin e ambalazhimit dhe paketimit të PMB-ve në vendin tonë, ka disa elementë që duhen marrë në konsideratë dhe nuk përbëjnë rrezikshmëri nëse PMB-të përdoren si duhet. Këto ndihmojnë fermerët në përdorimin me ekonomikitet dhe efektivitet të tyre.

Ndër to mund të përmendim: sipërfaqet e vogla të tokës për fermë që kërkojnë paketime të vogla, duke ulur rrezikun ndaj përdoruesve, ruajtjen e efektshmërisë, zvogëlimin e mundësive për abuzim dhe ruajtjen e mjedisit.

21. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi rezultoi se MBZHR ende nuk ka hartuar udhëzimin mbi rregullat specifike për ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 24, të Ligjit nr. 105/2016 òPër Mbrojtjen e Bimëveò.

21. Konkluzioni

Moshartimi nga MBZHR i udhëzimit për rregullat specifike për ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve, ka sjellë problematika në menaxhimin dhe ruajtjen gjatë përdorimit të PMB-ve.

21.1 Rekomandimi

MBZHR, të ngrejë një grup pune, ku të përfshihen specialistë edhe nga institucionet e varësisë për të draftuar e më pas miratuar udhëzimin për rregullat specifike të ambalazhimit dhe etiketimit.

Brenda datës 30.09.2022 dhe në vijimësi

-Në pikën 4, të nenit 22, të Ligjit nr. 105/2016 për Mbrojtjen e Bimëve janë përcaktuar rregullat që duhet të plotësojnë magazinat në rastin e tregtimit me shumicë, si dhe në mjediset e tregtimit me pakicë. Për më tepër, këto rregulla janë edhe kushtet dhe kriteret për licencim të subjekteve që kërkojnë të ushtrojnë aktivitetin e tregtimit me shumicë dhe/ose pakicë të PMB-ve.

-Në nenin 25 të Ligjit nr.105/2016, për Mbrojtjen e Bimëve, ku bëhet fjalë për asgjësimin e PMB-ve dhe ambalazheve të tyre, në pikën 1, citohet: *“Ambalazhet dhe materialet e tjera, që duhet të asgjësohen, janë: a) PMB-të e papërdorshme, për shkak të skadimit ose për arsye të tjera, përjashtuar rastet kur ato i janë nënshtruar analizave nga laboratorit i akredituar dhe parametrat e tyre janë të njëjta me ato të dosjes së regjistrimit”*. Bazuar në këtë nen tregtuesit me shumicë të PMB-ve, për PMB-të e përmendura më sipër janë të detyruar të largojnë ato nga territori i Republikës së Shqipërisë, ose të bëjnë djegien (inçinerimin) e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndotjen e mjedisit.

Asgjësimi i PMB-ve me djegie (inçinerim), brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet nga subjekte të specializuara për këtë qëllim, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat. Nga përgjigjet e pyetësorëve, na u vu në dukje se gjatë inspektimeve të kryera nga institucionet përkatëse janë bllokuar në njësinë e tregtimit me pakicë (farmaci bujqësore) dhe shumicë PMB-të e skaduar ose ato jashtë listës së PMB-ve ose janë kthyer tek furnizuesi i shumicës. Gjatë periudhës objekt auditimi, në AKU nuk është depozituar asnjë kërkesë në lidhje me monitorimin dhe ndjekjen e procedurave të asgjësimit të PMB-ve dhe ambalazheve të tyre konform legjislacionit në fuqi, gjë kjo që lejon shumë hapësira për abuzim në dëm të mjedisit dhe përdorimit të tyre me skadencë apo me veprime anësore në produktet bujqësore. Në zbatim të nenit 25, të Ligjit nr.105/2016 dhe në nenin 47, të Ligjit nr.10463, datë 22.09.2011²⁷, për menaxhimin e integruar të mbetjeve, të ndryshuar, në Shqipëri nuk ka një kompani të licencuar që të kryejë procesin e incinerimit të mbetjeve të PMB-ve, asgjësimin e PMB-ve dhe të ambalazheve të tyre. Është përgjegjësi ligjore e vetë subjektit të tregtimit me shumicë të angazhohet në procesin e asgjësimit, ndërkohë që ai e ka këtë detyrim ligjor në kriteret e licencimit. Kthimi në vendin e origjinës është i pamundur. Me VKM nr. 232, datë 26.04.2018, është rishikuar VKM nr. 177, datë 06.03.2012 për ambalazhet dhe mbetjet e tyre, propozuar nga Ministria e Mjedisit dhe bazuar në ndryshimet ligjore, por nuk është miratuar udhëzimi i MBZHR dhe MTM, për asgjësimin e PMB-ve dhe të ambalazheve të tyre, sipas detyrimeve ligjore. Ky udhëzim është parashikuar të miratohet në vitin 2022. Asgjësimi i PMB-ve është pjesë e asgjësimit të mbetjeve në përgjithësi dhe parashikohet nën përgjegjësinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

22. Gjetje nga auditimi:

Edhe pse sistemi i menaxhimit të të dhënave në AKU është deri diku funksional, për të rritur eficiencën e tij, nevojitet të jetë më i aksesueshëm. Në AKU, sistemi i të dhënave për kontrollet e kryera deri në vitet 2017-2018 ka qenë i hedhur në sistemin AKU-net. Me implementimin e sistemit online *“e-inspektim”*, ky i fundit është funksional por nuk ka askes nga të gjitha

²⁷Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

strukturat e AKU-së, të nevojshme për tu përfshirë në proces.

Një problem tjetër është që vetëm një pjesë e inspektorëve në terren është trajnuar mbi përdorimin e sistemit online *ë-inspektim* nga Inspektoriat Qendror (IQ), pasi ka patur rekrutime të reja të inspektorëve të terrenit.

Nga auditimi i kryer në DRAKU-të konstatohet se funksionimi i sistemit *online "e-inspektim"* administrohet nëpërmjet Inspektoriat Qendror (IQ), i cili realizon suportin teknik për funksionimin e sistemit me kërkesë të inspektorëve të DRAKU-ve.

22. Konkluzioni

Mungesa e aksesit në sistem si dhe mungesa e trainimit të inspektorëve për përdorimin e këtij sistemi, ndikon direkt në menaxhimin efektiv të kohës përgjatë zinxhirit të kontrollit të PMB-ve.

22.1 Rekomandimi

AKU në koordinim me IQ duhet të marrë masa për të trajnuar inspektorët e terrenit të DRAKU-ve që janë ende të patrajnuar për sistemin online *"e-inspektim"*. Gjithashtu, për një menaxhim më të mirë të punës duhet të rishikohet mundësia e mbulimit me akses në sistemin *"e-inspektim"* edhe nga struktura të tjera brenda DPAKU-së, të cilat kane role specifike në të gjithë procesin.

Gjatë vitit 2022 e vijimësi

Përdorimi i qëndrueshëm i PMB-ve është një proces përmbyllës i rëndësishëm në zinxhirin e përdorimit të PMB-ve i cili bazohet në nenin 23 të ligjit si më poshtë:

"1. Përdorimi i qëndrueshëm i PMB-ve duhet të sigurojë uljen e rreziqeve dhe ndikimeve të tyre në shëndetin e përdoruesve, konsumatorëve, kafshëve dhe mjedisit si dhe kontrollin e integruar të parazitëve.

2. PMB-të përdoren nga përdoruesi i fundit, duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet, që jepen në dokumentin e regjistrimit të tyre.

3. PMB-të shumë helmuese përdoren vetëm nga përdoruesit profesionistë, të cilët janë persona të diplomuar në fushën e agronomisë ose persona, të cilët i janë nënshtruar një trajnimit të përshtatshëm për përdorimin e PMB-ve shumë të rrezikshme dhe janë pajisur me dëshmi aftësie të veçantë për këtë përdorim.

4. PMB-të helmuese përdoren nga përdoruesit profesionistë, të cilët janë persona të diplomuar në fushën e agronomisë ose nga persona, të cilët i janë nënshtruar një trajnimit të përshtatshëm për përdorimin e PMB-ve helmuese dhe janë pajisur me dëshmi aftësie për këtë përdorim."

Bazuar në VKM nr 317, datë 15.05.2019, *ËPër miratimin e rregullores për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit, realizohet përdorimi i qëndrueshëm i PMB-ve. Ky vendim është përafshuar pjesërisht me Direktivën 2009/128/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, 21 tetor 2009, për krijimin e një kuadri për veprim të Komunitetit për të arritur përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve, numri CELEX:32009L0128. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria 309, datë 24.11.2009, faqe 71-86. Për zbatimin e kësaj VKM-je ngarkohen, AKVMB dhe AREB. Dëshmia e aftësisë është pa afat dhe shoqërohet me vërtetim të gjendjes shëndetësore, që lëshohet çdo 2 vjet. Dëshmitë e aftësisë regjistrohen në një regjistër të veçantë që administrohet nga agjencia rajonale e shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve pranë AKVMB-së, e cila nuk ka filluar të funksionojë si një strukturë e mirëfilltë, pasi nuk ka të miratuar as statut dhe as rregullore.*

Të drejtën për të përdorur PMB-të helmuese ose shumë helmuese, e kanë të gjithë personat që janë të pajisur me dëshmi aftësie të veçantë. Këto persona quhen përdorues profesionistë dhe rritin nivelin e sigurisë lidhur me mbetjet e PMB-ve në bimët dhe produktet bimore.

Për ritjen e nivelit të sigurisë lidhur me mbetjet e PMB-ve në bimët dhe produktet bimore, sistemi i gjurmueshmërisë duhet të identifikojë trajtimin e fundit me PMB para vjeljes. Prodhuesi të deklarojë pranë strukturës përgjegjëse si dhe te qendra e grumbullimit të bimëve dhe produkteve bimore datën e trajtimit të fundit para vjeljes si dhe emrin e PMB-së së përdorur. AREB këshillon dhe ndjek prodhuesit e bimëve dhe produkteve bimore për përdorimin e sigurt dhe efikas të PMB-ve.

Nga intervistat dhe përgjigjet e pyetësorëve, mbështetur dhe në dokumentacionin e administruar nga grupi i auditimit, është evidentuar se fermerët mbeten të pamonitoruar në përdorimin e PMB-ve dhe si rezultat në disa raste nuk respektohet kategoria, përdorimet jashtë etiketës apo në disa raste tejkalimi i dozave të përdorimit. Nga ana tjetër vonesat në marrjen e përgjigjeve mbi 10 ditë nga ISUV për analizimin e PMB-ve pengojnë marrjen e masave në kohë për veprime të mëtejshme në zbatim të ligjit si dhe garantimin e PMB-ve cilësore në treg për fermerët të cilët paguajnë për këto, në rastet kur dalin jashtë normave të lejuara me certifikatat e analizave. Pra krijohet një situatë e paadministrueshme dhe konfuze me pasoja ekonomiko sociale për të gjitha grupet e interesit që përfshihen në këto procese.

23. Gjetje nga auditimi

Konstatohet se në disa raste fermerët mbeten të pamonitoruar në përdorimin e PMB dhe nuk mbajnë të dokumentuar shërbimet agroteknike për kulturat bujqësore duke mos u dokumentuar respektimi i karencës²⁸, përdorimet jashtë etiketës apo tejkalimi i dozave të përdorimit.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 56-58 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

23. Konkluzioni

Në mungesë të monitorimit dhe mungesë të regjistrimit tip për dokumentimin e shërbimeve agroteknike në përdorimin e PMB-ve për kulturat bujqësore, fermerët rrezikojnë të mos respektojnë karencën dhe të tejkalojnë dozat e përdorimit.

23.1 Rekomandimi

MBZHR, të marrë masat për forcimin e monitorimit të fermerëve dhe të rishikojë aktet ligjore dhe nënligjore të cilat do të disiplinojnë dhe ngarkojnë me përgjegjësi fermerët në mbajtjen e dokumentacionit të nevojshëm për gjithë zinxhirin e shërbimeve agroteknike të kulturave bujqësore në fermë.

Brenda datës 30.09.2022 dhe në vijimësi

4.2.2 A janë efektive strukturat përgjegjëse për kryerjen e proceseve sistematike të zhinxhirit funksionues të PMB dhe sigurisë ushqimore?

Krijimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave në secilin hap të zinxhirit të kontrollit, duke mbuluar të gjithë zinxhirin nga niveli qendror në atë lokal, është thelbësor për organizimin e një sistemi eficient të menaxhimit të PMB-ve sidhe kontrollit në përdorimin e tyre. Megjithatë ka arritje në kapacitetet zbatuese të SPMB-së, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), ISUV-it, janë krijuar institucione të reja si AKVMB-ja, por nga auditimi konstatohet se kapacitetet njerëzore kanë qenë të kufizuara në fushën e vlerësimit të riskut dhe monitorimit të mbetjeve, menaxhimit të PMB-ve, kritereve mikrobiologjike, ndotësve, etj. Nevojitet përmirësim i planifikimit brenda sistemit të inspektimit, monitorimit, përdorimit, gjurmueshmërisë në të gjitha nivelet e prodhimit bimor me rrezik, objekteve të tjera ose PMB-ve, që janë ose priten të jenë të lidhura me shëndetin e bimëve, në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes së tyre, sipas procedurave të vendosura.

Bazuar në nenin 27 të Ligjit nr. 105/2016 òPër mbrojtjen e bimëve, prodhuesit e bimëve dhe

²⁸Koha e nevojshme e rritjes së bimës.

tregtuesit e PMB-ve krijojnë sistemin për mbajtjen e të dhënave, të quajtur bazë të dhënash, dhe garantojnë procedurat, të cilat mundësojnë identifikimin e tyre në çdo çast. Në përmjet të tyre dhe në bazë të identifikimit të çdo personi fizik apo juridik, i cili i ka furnizuar apo është furnizuar me bimë, prodhime bimore me rrezik, objekte të tjera ose PMB.

AKU disponon bazën e të dhënave²⁹ për Operatorët e Biznesit që ushtrojnë aktivitetin në fushën e inputeve bujqësore, pjesë e të cilëve janë edhe Operatorët e Biznesit (OB) që ushtrojnë veprimtarinë e importit, tregtimit me shumicë dhe ose pakicë të PMB-ve.

Menaxhimi i mbetjeve të PMB-ve të papërdorshme, ambalazhet, sendet e ndotura gjatë punës gjatë punës, etj, janë shqetësime serioze për ruajtjen e mjedisit dhe nëpërmirësimin e cilësisë së jetës në RSH. Në këtë aspekt, një problem i madh mjedisor në Shqipëri është mungesa e impianteve ricikluese. Ka një nevojë të theksuar për përmirësimin e mbrojtjes mjedisore duke ndërtuar impiante ricikluese, duke investuar në pajisje dhe ambiente për ripërpunimin, trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve.

Në laboratorin e referencës në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë³⁰, në fushën e mbrojtjes së bimëve kryhen analiza sistematike të produkteve për mbrojtjen e bimëve (p.sh. pesticidet). Analizat e fundit të mangësive të monitorimit dhe kontrollit të PMB-ve, si edhe të sistemit të sigurisë së ushqimit tregojnë se ka nevojë për përmirësime të mëtejshme të sistemit ekzistues, si duke rishikuar dhe ndryshuar bazën ligjore, ashtu edhe duke përmirësuar koordinimin dhe alokimin e detyrave dhe përgjegjësive. Ekziston nevoja për bashkëpunim dhe komunikim më të mirë midis autoriteteve kompetente të sistemit të monitorimit dhe kontrollit të PMB-ve, sigurisë së ushqimit në nivel qendror, autoriteteve qendrore dhe zyrave lokale përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit dhe planeve të veprimit në fushat e mësipërme.

24. Gjetje nga auditimi

Edhe pse në pikën 2 të nenit 29 të Ligjit nr. 17/2020 citohet se, importuesit dhe prodhuesit e produkteve plehëruese, për produktet janë të detyruar t'ia largojnë ato nga territori i Republikës së Shqipërisë ose të bëjnë djegien (incinerimin) e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndotjen e mjedisit, rezultoi se ende nuk është miratuar udhëzimi i përbashkët i MBZHR dhe MTM, për asgjësimin e PMB-ve dhe të ambalazheve të tyre, sipas detyrimeve ligjore të ligjit mësipërm. Në pikën 2 të nenit 29 të Ligjit nr. 17/2020 citohet se: "Importuesit dhe prodhuesit e produkteve plehëruese, për produktet plehëruese të përmendura në shkronjën òaò, të pikës 1, të këtij neni, janë të detyruar t'ia largojnë ato nga territori i Republikës së Shqipërisë ose të bëjnë djegien (incinerimin) e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndotjen e mjedisit."

Gjithashtu rezultoi se ende nuk është miratuar udhëzimi i përbashkët i MBZHR dhe MTM, për asgjësimin e PMB-ve dhe të ambalazheve të tyre, sipas detyrimeve ligjore të ligjit mësipërm.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 58-59 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

24. Konkluzioni

Mungesa e udhëzimit për largimin/asgjësimin e PMB-ve dhe të ambalazheve të tyre, si një detyrim ligjor për MBZHR dhe MTM, ka ndikuar në uljen e interesit për licensimin e kompanive të cilat do të kryejnë procesin e incinerimit të mbetjeve të PMB-ve si dhe asgjësimin e PMB-ve dhe të ambalazheve të tyre, duke bërë që ky proces ende të mos realizohet duke mbartur rrisht për shëndetin e qytetarëve.

24.1 Rekomandimi

MBZHR së bashku me MTM, nëpërmjet ngritjes së një grupi të përbashkët pune, të marrin masa për të hartuar udhëzimin e përbashkët për largimin/asgjësimin e PMB-ve dhe të ambalazheve të tyre.

Brenda datës 30.09.2022 dhe në vijimësi

²⁹ Planin vjetor me baze rrisht i miratuar.

³⁰ Fletorja Zyrtare Viti 2014 ó Numri 169 Faqe|8521³⁰

Në përgjigjet e pyetësorëve përcaktohet se problemi më i rëndësishëm në menaxhimin e PMB-ve, është monitorimi i zinxhirit në përdorimin e tyre, duke filluar nga: shitja me pakicë, Libri i fermës deri te përdoruesit e fundit, të cilët duhet të jenë të trajnuar dhe pajisur me Dëshmi Aftësie. Pra, inspektimi dhe monitorimi konsiderohet si elementi i rëndësishëm në menaxhimin e PMB-ve.

Për të kryer inspektimet e subjekteve të tregtimit me shumicë dhe/ose pakicë të PMB-ve, nga 12 Drejtoritë Rajonale të AKU-së, zbatohet plani me bazë risku i kontrolleve zyrtare për vitet respektive (2018, 2019, 2020), i miratuar nga MBZHR. Në këtë plan janë pasqyruar të gjithë subjektet që kanë numrin NIPT, dhe kanë marrë licencat përkatëse për ushtrimin e aktivitetit. Planit është ndarë në 12 muajt e vitit.

Në bazë të planit vjetor të inspektimeve nga ana e Drejtorëve Rajonalë të AKU-së gjenerohen në sistemin *de-inspektimit* inspektimet e çdo muaji pasardhës. Për të kryer inspektimet ditore drejtori rajonal çdo ditë gjeneron nga sistemi autorizimin e inspektimit ku përcaktohen të gjithë të dhënat e subjektit: emri, adresa, numri NIPT/NUIS, objekti i inspektimit, kohëzgjatja e tij, si edhe emrat e inspektorëve që do të kryejnë inspektimin. Gjatë inspektimit të këtyre subjekteve nga ana inspektorëve të AKU-së plotësohen listë verifikimet në të gjithë rubrikat e saj, më pas plotësohet proces verbali i inspektimit dhe vendimit përfundimtar. Në rast se gjatë inspektimit konstatohen shkelje ligjore për subjektin merret masa administrative siç parashikohen në legjislacionin në fuqi. E gjithë procedura e inspektimit kryhet nëpërmjet sistemit “*e-inspektim*” si dhe të gjithë dokumentet e plotësuar gjatë inspektimit gjenerohen nga ky sistem. Theksojmë faktin se akses për futjen në sistem dhe gjenerimin e dokumentacionit të plotësuar e kanë inspektorët rajonal të DRAKU, Kryeinspektorët Rajonal si dhe disa persona përgjegjës në Inspektoratin Qendror (IQ).

25. Gjetje nga auditimi

Në nenin 28, të Ligjit nr.105/2016 *oPër Mbrojtjen e Bimëve* nuk parashikohet përshkallëzimi i masave ndëshkuese duke filluar nga *oParalajmerim* e deri në *oGjoba*, konkretisht parashikohet vetëm masa administrative *oGjobe*, duke filluar nga 50 mijë lekë, duke e vendosur subjektin e tregtimit me pakicë, nën masa shtrënguese të forta administrative.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 57-58 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

25. Konkluzioni

Mungesa e përshkallëzimit të masave administrative, jo vetëm që krijon klimë jo mbeshtetese ndaj subjekteve, por as nuk i shërben garantimit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve e ushqimeve për kafshë në Republikën e Shqipërisë, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e misionit të AKU-së.

25.1 Rekomandimi

MBZHR në amendimet që po bën për Ligjin nr. 105/2016 *oPër Mbrojtjen e Bimëve*, të vlerësojë me përparësi rishikimin e masave administrative, duke vendosur përshkallëzimin nga paralajmërimi deri në gjobë, konform procedurave administrative në RSH.

Brenda datës 30.09.2022 dhe në vijimësi

Nënpvetia e tretë me komponentët e saj

4.3 A janë parashikuar burimet financiare dhe operationale për realizimin e proceseve të menaxhimit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore?

4.3.1 A kanë qenë të mjaftueshme burimet financiare për kryerjen e proceseve sistematike të zinxhirit funksionues të PMB dhe sigurisë ushqimore si edhe mbrojtjen ndaj epidemive të

parazitëve?

Fondet e planifikuara në PBA 2018-2020 për PMB dhe sigurinë ushqimore.

Në aktivitetin e saj ekonomik financiar Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për realizimin e objektivave të saj dhe përmbushjen e detyrimeve në zhvillimin bujqësor/blektoral e sigurinë ushqimore, ka planifikuar për çdo vit buxhetor 2018-2020, fondet e saj dhe veçanërisht për zbatimin e kontrollit të zinxhirit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore, në totalin e MBZHR për tre vite që është në vlerën 29,166 milion lekë.

Nga kjo vlerë, janë akorduar fonde nga buxheti i shtetit për sigurinë ushqimore (këtu bejnë pjesë dhe PMB-të) në vlerë totale 5,025 milionë lekë, ose 17.2 % e fondeve për bujqësinë, ndërkohë që siguria ushqimore është prioriteti i dytë i MBZHR pas zhvillimit bujqësor të vendit. Bashkimi Europian ka financuar nëpërmjet Grantit vlerën 1,3 milion lekë për "Fuqizimi i laboratorëve të sigurisë ushqimore".

Sipas strukturës buxhetore fondet e akorduara janë të mbështetura në programet buxhetore të paraqitur në pasqyrën e mëposhtme:

Tabela 8: Programet buxhetore

Emërtimi i programit	Në milionë lekë		
	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Shpenzime për fond pagash	1,562	1,582	1,728
Shpenzime operative	3,508	2,366	2,455
Investime të brendshme	1,661	2,463	2,997
Investime të huaja	2,521	2,693	3,630
Siguria ushqimore	2,060	1,462	1,503
Shpenzime në Mbrojtje bimësh	0	41	72
Investime të huaja	233	198	240
Grant i BE "Fuqizimi i Laboratorëve të Sigurisë Ushqimore"	0	1,3	
Totali i programeve	9,252	9,104	10,810

Burimi: DB në MBZHR

Më konkretisht:

- Në vitin 2018 janë akorduar 9,252 milionë lekë për MBZHR, prej të cilave 2,060 milionë lekë janë për sigurinë ushqimore për shpenzime paga e shtesa dhe shpenzime operative, kjo zë 22% e totalit buxhetor. Investime të brendshme në vitin 2018 për PMB-të nuk ka. Në këtë vit kemi investime në Bujqësi në vlerën totale 4,182 (1,661+2,521) milion lekë ose 45% e totalit të fondeve buxhetore, nga kjo: në zërin e investimeve të brendshme është financuar vlera 1,662 milion lekë ose 18% e totalit dhe Investime të huaja janë në vlerën 2,521 milion lekë. Për sigurinë ushqimore nuk ka investime dhe donacione apo grante nga BE e donatorë të ndryshëm.

- Në vitin 2019 janë akorduar 9,104 milionë lekë për MBZHR, prej të cilave 1,462 milion lekë për sigurinë ushqimore për shpenzime paga e shtesa dhe shpenzime operative, kjo zë 16% e totalit buxhetor. Investime të brendshme në vitin 2019 për PMB-të nuk ka. Në këtë vit kemi investime në Bujqësi, në vlerën totale 5,156 (2,463+2,693) milion lekë ose 56.6% e totalit të fondeve buxhetore, nga kjo: në zërin e investimeve të brendshme është financuar vlera 1,662 milion lekë ose 18% e totalit dhe Investime të huaja janë në vlerën 2,521 milion lekë. Për

sigurinë ushqimore nuk ka investime dhe donacione, por kemi Grant nga BE në vlerën 1.3 milion lekë. Ky investim i vetëm i kryer nga BE është bërë me objekt "Fuqizimi i laboratorëve të sigurisë ushqimore si pjesë e programit IPA 2013, ku sipas analizës analitike të përdorimit të këtij Granti, rezulton se:

Janë kompletuar e vendosur 38 pajisje laboratorit për analizimin e parazitëve (siguria ushqimore) me 1 035 005 Euro e konvertuar në 1,3 milion lekë, nga këto kemi:

a. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare ka marrë furnizim vendosje 34 komplete laboratorit me vlerë 14 000 Euro /komplet pajisje laboratorit plus vlera e insatlimit , në total kemi vlerën 926 057 Euro .

b. DRAKU Korçë janë instaluar 2 komplete pajisje laboratorit ne vlerë 54 474 euro dhe

c. DRAKU Gjirokastër instaluar 2 komplete pajisje laboratorit ne vlerë 54 474 euro. Në vlerësimin e situatës buxhetore në lidhje me PMB-të dhe sigurinë ushqimore, kemi vetëm këtë investim dhe kjo nuk është shoqëruar me investime pasardhëse në Drejtoritë e tjera të AKU, ku dhe nevoja është shumë e madhe.

- Në vitin 2020 janë akorduar 10,810 milionë lekë për MBZHR, prej të cilave 1,503 milion lekë për sigurinë ushqimore për shpenzime paga e shtesa dhe shpenzime operative, kjo zë 14% e totalit buxhetor. Investime të brendshme në vitin 2020 për PMB-të nuk ka. Në këtë vit kemi investime në Bujqësi në vlerën totale 6,627 (3,630+2,997) milion lekë ose 61.3% e totalit të fondeve buxhetore, nga kjo: në zërin ÷ Investime të brendshme është financuar vlera 2,997 milion lekë ose 18% e totalit dhe Investime të huaja janë në vlerën 3,630 milion lekë. Për sigurinë ushqimore nuk ka investime direkte.

Sipas treguesve të paraqitur shikohet se nga MBZHR, megjithëse si institucion ka patur investime të brendshme dhe të huaja për tre vitet 2018-2020 në vlerë të përgjithshme prej 15,965 milion lekë ose 54.7% e fondeve që ka përdorur në vlerë totale 29,166 milion lekë (9,252+9,104+10,810), konstatohet se për sigurinë ushqimore nuk ka patur investime të qenësishme dhe që të kenë patur impakt pozitiv në rritjen e treguesve të sigurisë ushqimore, si në investimet në infrastrukturë laboratorë, medikamente laboratorike (kite, etj) ambiente kontrollit në PKK-të, trajnime të burimeve njerëzore, etj.

Mungesa e vlerësimit objektiv dhe me përgjegjësinë e duhur të gjendjes së infrastrukturës së Drejtorive Rajonale të AKU-së, ku laboratorët janë jashtë funksionit, mungojnë pajisjet e tyre dhe nuk ka kite e mjete të tjera ndihmëse për kryerje analiza të shpejta, etj., ka sjellur dhe mos pasjen e kujdesit të duhur dhe programimit të investimeve për ndryshimin e gjendjes së sistemit të kontrollit dhe monitorimit të zinxhirit të tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore. Kjo për nevojat e menjëhershme, siç është rasti i objektit të kontrollit të PMB-ve në Portin e Vlorës, ku është një kjoskë që nuk plotëson as kushtet minimale të punës për marrjen, ruajtjen dhe dërgimin për analiza të mostrave që merren nga hyrjet e PMB-ve në PKK Vlorë, laboratorët në Drejtoritë Rajonale të AKU-së, etj

26. Gjetje nga auditimi

Në auditimin e kryer në lidhje me investimet e kryera nga MBZHR dhe njësitë vartëse si AKU dhe ish Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë (kthyer agjenci ARVMB e rikthyer DRVMB), është konstatuar se mungon një analizë e situatës dhe gjendjes së nevojave për investime për të rritur parametrat e sigurisë ushqimore dhe kontrollin e monitorimin e tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve, në të gjithë zinxhirin e tyre si në laboratorë, ambiente bashkëkohore, mjete ndihmëse laboratorike, trajnime, etj. Nga audimi, rezulton se megjithëse në zbatimin e politikave të zhvillimit bujqësor e blektoral dhe aktivitetet e fushave të tjera të këtij institucioni, për periudhën 2018-2020 janë kryer investime në vlerën totale 15,965 milion lekë (nga të cilat: investime të huaja në vlerën 8,844 milion lekë, ndërsa financuar nga buxheti i shtetit në vlerën

7,121 milion lekë), në fakt **nuk** rezulton të jetë adresuar ndonjë fond për sigurinë ushqimore dhe PMB-të, përveç një investimi të kryer, në kuadrin e projektit IPA 2013 me objekt "Fuqizimi i laboratorëve të sigurisë ushqimore me vlerë 1,3 milion lekë.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 60-62 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

26. Konkluzioni

Mungesa e investimeve nga fondet buxhetore për sigurinë ushqimore dhe veçanërisht për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrollit të PMB-ve mbart rrisje që mund të ndikojnë negativisht në ngritjen e një infrastrukture funksionale dhe efektive. Po kështu, mungesa e prioritarizimit ndaj sigurisë ushqimore dhe kontrolli i zinxhirit të tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve, passjell mungesë financimesh në investime afat shkurtër dhe afatgjatë në këtë fushë.

26.1 Rekomandimi

MBZHR në bashkëpunim me njësitë e varësisë, pjesë e institucioneve përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin e zinxhirit të tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve, si kontribues kryesor në rritjen e treguesve të sigurisë ushqimore, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për të analizuar situatën dhe gjendjen e infrastrukturës, mjeteve, ambienteve dhe logjistikës ndihmëse e burimeve njerëzore në AKU, DRAKU, ISUV dhe AKVMB dhe DRVMB, për periudhën në vijim, duke përcaktuar qartë nevojat dhe llogaritur fondet e duhura për investime. Për këtë, duhet forcuar incentivat për thithjen e fondeve si nga donatorë të huaj ashtu dhe nga buxheti i shtetit, në të mirë të rritjes së sigurisë ushqimore.

Brenda datës 30.09.2022 dhe në vijimësi

Analiza e shpenzimeve operative të kryera nga AKU, ISUV, AKVMB & Aparati I MBZHR(SPMB)

Në auditimin e kryer bazuar në informacionin e paraqitur nga subjekti MBZHR, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, ku bëjnë pjesë dhe treguesit financiar të shpenzimeve operative të kryera për të gjithë sistemin e zinxhirit të tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve, si pjesë kontribuese kryesore në rritjen e sigurisë ushqimore në vend. Grupi i auditimit vlerësoj që të bëjë një analizë të këtyre treguesve për të tre vitet 2018-2020 të periudhës objekt auditimi. Konkretisht:

Në referim të pasqyrës së mëposhtme si pjesë përbërëse e buxhetit të programit 04220 "Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit", janë shpenzimet e fond pagash dhe ato operative që janë përdorur për personelin, që ka në objekt të punës së tyre mbrojtjen e bimëve. Ky personel është përkatësisht në Aparat të MBZHR-se janë 3 punonjës(SMB) dhe personeli në 4 Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (ish Drejtoritë e Bujqësisë dhe AKU dhe Drejtoritë Rajonale me punonjësit që kanë në sektorin e PMB-ve dhe në PKK. Shpenzimet operative të tre vitet vetëm për Sigurinë ushqimore është në vlerën 3,839 milion lekë. Kjo sipas viteve është: viti 2018 vlerën 1,517 milion lekë, viti 2019 vlera 1,194 milion lekë dhe viti 2020 vlerën 1,128 milion lekë, ku siç shikohet në të tre vitet kemi një rënie të shpenzimeve

Si për fond page dhe shpenzimet operative, gjë kjo që flet se kemi patur shkurtime të numrit të punonjësve dhe specialistëve, ku nga grupimi i ish Drejtorive Rajonale të Bujqësisë kemi pakësim të shpenzimeve operative në të dy vitet pasardhëse 2019-2020 në krahasim me vitin 2018. Ristrukturimi i institucioneve të varësisë të MBZHR duke përqëndruar ato në katër drejtori, ka sjellur dhe pasojë të shkurtimit të numrit të specialistëve të mbrojtjes së bimëve dhe mos mbulimi plotësisht i territorit në vend me specialistë dhe kanë çenuar zinxhirin e përdorimit të PMB-ve deri tek fermeri. Kjo mungesë e personelit dhe mungesa e theksuar e bashkëpunimit me specialistët e AKU-së dhe specialistët e Drejtorive të Bujqësisë në 61 bashkitë e vendit, ka ulur kontrollin dhe monitorimin e përdorimit të PMB-ve dhe të sigurisë ushqimore.

Tabela 9: Treguesit e realizimit të buxhetit për PMB-të viti 2018-2020

Milion lekë

Siguria Ushqimore	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Totali
<i>SHPENZIME për Fond Pagash</i>	751	580	614	1,945
<i>SHPENZIME Operative</i>	766	614	514	1,894
Totali	1,517	1,194	1,128	3,839

Në tabelën 9 shikohet se në total kemi rritje të shpenzimeve operative në planifikimin e tyre, por në zbatimin e buxhetit për PMB-të kemi një mos realizim të theksuar, kjo ka ndodhur në të tre Zerat e shpenzimeve si në fond page +sigurime shëndetsore e shoqërore dhe në shpenzime operative. Në zërin shpenzime operative për vitin 2018 kemi një realizim buxheti në masën 31%, pra nga 12,563 milion lekë planifikuar, janë realizuar 3,909 milion lekë, vitin 2019 kemi një realizim buxheti në masën 33%, pra nga 19,264 milion lekë planifikuar, janë realizuar 6,831 milion lekë dhe në vitin 2020 kemi një realizim buxheti në masën 87.7%, pra nga 21,796 milion lekë planifikuar, janë realizuar 19,135 milion lekë.

Ky ndryshim në vitin 2020 është shoqëruar dhe me rritjen e numrit të analizave të kryera nga ISUV dhe në laboratorët rajonal.Po të shikohet nga institucionet kontribuese dhe kanë për detyrës kontrollin dhe monitorimin e tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve planifikimi ka qene i pa bazuar dhe i pa mbështetur në nevojat reale, por janë planifikuar buxhete me vlera të panevojshme dhe përdorimi i tyre është në masën 31-77.7 %, gjë kjo që tregon dhe për paaftësi menaxhuese nga strukturat e bazës, në drejtim të përdorimit të parasë ekthimin e tyre në të mirë publike, pra të rritjes së sigurisë ushqimore. Po kështu dhe në vlerësimin e planifikimit dhe përdorimit të buxhetit në zërin Paga e sigurime shëndetsore e shoqërore, konstatohet se planifikimi është me rezerva dhe shumë i lartë, ndërkohë që numri i punonjësve në planifikim është rritur +16 vetëm në vitin 2020, por dhe kjo në raport me fondin e përdorur më pare në dy vitet parardhëse, nuk është në proporcion të drejtë me pagat për punonjës. Kjo tregon se dhe këtu nuk kemi një analizë të saktë të përdorimit të burimeve njerëzore, planifikimi i nevojave dhe eficaenca e përdorimit të tyre në raport me përmbushjen e detyrimeve ligjore për PMB-të.

Sipas VKM për miratimin e strukturës së MBZHR numri i punonjësve në fakt në raport me planifikimin është shumë i ulët, konkretisht. në vitin 2018 nga 79 punonjës janë punësuar 57 punonjës, ose me personel të munguar -21 punonjës ose punuar me kapacitet të burimeve njerëzore prej 72%, në vitin 2019 nga 96 punonjës janë punësuar 60 punonjës ose me personel të munguar -36 punonjës ose punuar me kapacitet të burimeve njerëzore prej 62.5% dhe në vitin 2020 nga 96 punonjës janë punësuar 69 punonjës ose me personel të munguar -27 punonjës ose punuar me kapacitet të burimeve njerëzore prej 72%. Sa analizuam më sipër rezulton se nga MBZHR me strukturat e saj nuk ka një menaxhim të mire të burimeve njerëzore, ku dhe pse Qeveria ka planifikuar numer punonjësish dhe fond page, nuk është arritur që tëësohet numuri i duhur dhe të bëhej rekrutimi i specialistëve të fushave përkatëse, kjo do të rriste ndjeshëm eficaencën e produktit të burimeve njerëzore të këtyre institucioneve në rritjen e sigurisë ushqimore.

27. Gjetje nga auditimi

Në lidhje me financimin nga buxheti i shtetit të aktivitetit të institucioneve, pjesë e kontrollit dhe monitorimit të PMB-ve, është konstatuar se nga këto institucione **nuk** ka patur një planifikim të drejtë të fondeve buxhetore dhe si pasojë as përdorim të drejtë të tyre, mbështetur

në një analizë të thelluar buxhetore referuar viteve parardhëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Metodologjinë e planifikimit dhe hartimit të buxhetit në njësitë publike dhe ligjin organik për buxhetin e shtetit. Konkretisht, fondet buxhetore për shpenzime operative në dy vitet 2018-2019, janë realizuar në masën 31% e 33%. Është konstatuar se nuk është plotësuar numri i punonjësve sipas strukturës së miratuar në njësitë e varësisë si AKU dhe DRAKU.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 62-64 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

Konkluzione:

27. Mosrealizimi i investimeve në fushën e sigurisë ushqimore, tregon për mungesë fokusi ndaj kësaj fushe të rëndësishme për shëndetin publik, si dhe procese të dobëta planifikimi.

28. Mosplotësimi i vendeve vakante mbart rrisje për cënimin e objektivave institucionale në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe tregon paaftësi menaxhuese të burimeve njerëzore.

27.1 Rekomandimi

MBZHR, në bashkëpunim me strukturat e varësisë AKU, ISUV dhe AKVMB dhe Drejtoritë rajonale, të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për të analizuar situatat buxhetore të tyre për tre vitet 2018-2020, duke analizuar shkaqet që kanë ndikuar në mosplanifikimin e duhur buxhetor, si dhe arsyet e mospërdorimit të fondeve sipas planifikimit buxhetor. Sa më sipër të evidentohen dhe të reflektohen në planifikimet në vijimësi duke ndjekur metodologjitë e diktuar nga aktet nënligjore të dala për zbatimin e buxhetit të shtetit.

Brenda datës 30.09.2022 dhe në vijimësi

27.2 Rekomandimi

MBZHR në bashkëpunim me strukturat e varësisë AKU, ISUV dhe AKVMB dhe Drejtoritë rajonale, të marrin masa për të analizuar arsyet dhe nxjerrë përgjegjësitë për mosplotësimin e vazhdueshëm të vakancave e mosrekrutimit. Gjithashtu, strukturat përgjegjëse në MBZHR, të marrin masa për të hartuar një program të veçantë për zhvillimin e burimeve njerëzore nepermjet trainimeve specifike, rekrutimin dhe rritjen e efikasitetit të burimeve njerëzore, në funksion të rritjes së përgjegjshmërisë për kontrollin dhe monitorimin e tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore.

Brenda datës 30.06.2022 dhe në vijimësi

Të ardhurat e krijuara nga PMB-të.

Të ardhurat e krijuara nga PMB-të përbëhen nga dy lloje: Pagesë tarife për dhënie licenca (Farmaci bujqësore) dhe Regjistrimi PMB-ve në MBZHR për lejimin, tregtimin dhe përdorimin e tyre. Nga këto dy burime të ardhurat për periudhën objekt auditimi 2018-2020 (sipas pasqyrës më poshtë) janë në total 19 milion lekë, përkatësisht nga: (i) Dhënie licence vlera 0.417 milion lekë. dhe (ii) Regjistrimi i PMB-ve në vlerë 18.6 milion. Siç vihet re, këto të ardhura janë në vlerë shumë të vogël, krahasuar me shpenzimet në total që kryhen për PMB dhe sigurinë ushqimore.

Kontributi i PMB në buxhet ka ardhur në rritje nga 4.4 milionë lekë në vitin 2018 në 8.8 milionë lekë në vitin 2020, ndërkohë që buxhetimi i fondeve për zërin shpenzime operative për programin Siguria Ushqimore, për periudhën objekt auditimi ka ardhur në rënie nga 21 % në vitin 2018 në 14 % në vitin 2020. Këto të ardhura arkëtohen të gjitha në buxhetin e shtetit dhe nuk ju lihet subjekteve për përdorim.

Tabela 10: Pasqyra e të ardhurave nga PMB për vitet 2018-2020

Në lekë

Vitet	Lloji i të ardhurave			Derdhur në buxhet
	Liçenca (farmaci bujqësore)	Regjistrimi i PMB-ve	Totali (2+3)	
1	2	3	4	5
Viti 2018	118,000	4,300,000	4,418,000	4,418,000
Viti 2019	289,100	5,494,938	5,784,038	5,784,038
Viti 2020	10,000	8,800,000	8,810,000	8,810,000
Totali	417,100	18,594,938	19,012,038	19,012,038

Përpunoi: Grupi i auditimit

5. PËRMBLEDHJA

Qeveria shqiptare i konsideron politikat për Produktet e Mbrojtjes së Bimëve (PMB) dhe sigurinë ushqimore si një prioritet të rëndësishëm të saj, nën përgjegjësinë e MBZHR-së, si institucioni qendror përgjegjës për krijimin e kuadrit ligjor, koordinimin e harmonizimit të legjislacionit me kuadrin ligjor të BE-së dhe zbatimin e tij. Në fushën e sigurisë së ushqimit, çështjeve veterinarë dhe fitosanitare, përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve ka për qëllim mbrojtjen e bimëve bujqësore nga parazitët, me ndikim sa më minimal në sigurinë ushqimore, shëndetin e njerëzvedhe mbrojtjen e mjedisit.

Mos përdorimi i PMB-ve, cënon sigurimin e ushqimit të nevojshëm për njerëzimin dhe nuk garanton një shëndet cilësor. Ushqimet e prodhuara pa përdorimin e PMB-ve janë më të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve si rezultat i përmbajtjes së fitotoksinave.

Përdorimi i PMB-ve ndihmon në ruajtjen e mjedisit dhe biodiversitetit, pasi për të njëjtën sasi ushqimesh nga bujqësia organike do të përdorej 65-200 % më tepër tokë e kultivuar e do kishim pasoja si: rritja e erozionit, dëmtimi i peisazhit, florës dhe faunës së egër deri në zhdukjen e shumë specieve të egra.

Përdorimi i PMB-ve është i domosdoshëm për sigurimin në sasi dhe cilësi të ushqimit me një impakt të lartë social. Asnjëherë nuk mund të garantohej që rreziku nga përdorimi i tyre është zero.

Bazuar në kuadrin rregullator kombëtar e ndërkombëtar, PMB-të janë kimikatet më të testuara dhe kontrolluara në botë, të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së jetës së njeriut.

Kostoja e lartë e prodhimit përbëhet nga tre elementë:

- Vlefshmëria e lëndës kimike zë 1/3 e kostos,
- shqyrtimi i biologjisë zë 1/3 e kostos,
- testimi për mbetjet, toksikologjinë dhe mjedisin zë 1/3 e kostos.

Pra të tre elementët i shërbejnë qëllimit për *Mbrojtjen shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe sigurisë ushqimore*.

Shqetësimet në rritje lidhur me aplikimin e PMB-ve dhe kërkesat në rritje për ushqim e drejtojnë vëmendjen drejt sigurisë së ushqimit, si dhe në rregullimin global të prodhimit të ushqimit. Që sistemi i sigurisë së produkteve ushqimore të jetë sa më efikas, institucionet shtetërore dhe ato të financuara nga shteti kontribuojnë në krijimin e legjislacionit, sigurinë e vazhdueshme dhe rigoroze të shëndetit dhe kontrollin e cilësisë, aplikimin e njohurive shkencore në praktikë dhe edukimin e konsumatorëve në fushën e ushqimit. Përsëritja e çështjeve që lidhen me përhapjen e ushqimit të dëmshëm për shëndetin, rastet e kontaminimit të ushqimit, shfaqja e sëmundjeve të reja lidhur me ushqimit dhe ndotja e ekosistemeve nga substanca të huaja, të cilat rezultojnë në ndotjen e zinxhirit ushqimor për shkak të ndotjes së mjedisit, ka një efekt të rëndësishëm në

sjelljen e konsumatorëve në tregun e ushqimit.

Në MBZHR, para dhe gjatë periudhës objekt auditimi janë kryer reforma strukturore të cilat **nuk** i kanë shërbyer plotësisht rritjes së efektivitetit të menaxhimit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore. Për të qenë më efektive dhe eficiente, ristrukturimet duhet të shoqërohen me rritjen e numrit të stafit profesional, duke respektuar kriteret sipas formimit, profesioneve në fushën e bujqësisë, trajnimet dhe testimet e tyre, sidomos të strukturat për mbrojtjen e bimëve në gjithë zinxhirin e menaxhimit të PMB-ve, por edhe të kapaciteteve administrative. Ndryshimet në strukturat administrative të institucioneve të MBZHR-së nuk janë kryer bazuar në, nevojat, kompleksitetin, kriteret të qarta vlerësuese, politikat për një menaxhim më të mirë të PMB-ve, si edhe praktikat më të mira. Pra kjo tregon një mosefektivitet të ndryshimeve të shpeshta strukturore në realizimin e qëllimit të menaxhimit të PMB-ve. Mungesa e referencave ligjore në fushën e mbrojtjes së bimëve, afatet kohore të ngritjes dhe miratimit/rishikimit të funksioneve të strukturave të reja, në VKM Nr. 683, datë 03.09.2020 për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, bëjnë që reformat strukturore në fushën e mbrojtjes së bimëve, të jenë jo të plota, joeficiente dhe të pambështetura në aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Është konstatuar se bordi i AKU-së për periudhën e auditimit ka funksionuar pa kryetar Bordi të emëruar, veprim i cili është në kundërshtim me pikën 4 të nenit 64 të Ligjit Nr. 9863, datë 21.01.2008 për ushqimin, të ndryshuar. Pamvarësisht se ka përparim në kapacitetet zbatuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), ISUV-it, si dhe janë krijuar institucione të reja si AKMBV-ja dhe drejtoritë rajonale përkatëse DRVMB, *kapacitetet njerëzore vijnë të jenë të kufizuara në fushën e vlerësimit të riskut dhe monitorimit të mbetjeve, kriterëve mikrobiologjike dhe ndotësve*. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në fushat e politikave të bujqësisë, menaxhimit të PMB-ve, politikave të sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare duhet të përmirësohen duke futur një qasje më të integruar në punën e përafrimit midis fushave të politikave, koordinimit të përmirësuar brenda dhe ndërmjet ministrive me përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës. Mos kthimi ose vonesat mbi 10 ditë në marrjen e përgjigjeve të analizave nga ISUV, ka bërë që AKU, të mos kryejnë kohë marrjen e masave për bllokimin e tregtimit të PMB-ve që kanë rezultuar jo konformë. Për të shkuar më tej, vonesat në marrjen e përgjigjeve nga institucionet shtetërore përkatëse, krijojnë premisa për vënien në eficiencë të laboratorëve privat.

Në PRKE për vitin 2020³¹ theksohet se në lidhje me sigurinë e përgjithshme ushqimore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer kontrole të rregullta zyrtare në përputhje me planin vjetor të bazuar në rreziqe dhe ka marrë masat përkatëse, duke përfshirë paralajmërime, gjoha, konfiskim dhe asgjësim të ushqimit jo të konsumueshëm dhe pezullim të aktivitetit, por kapacitetet ievlerësimit të rrezikut bazuar në opinionin shkencor mbetet i dobët dhe duhet të përmirësohet. Vështirësitë dhe mungesat e infrastrukturës inspektuese kanë sjellë uljen e eficiencës së kontrollit të produkteve për mbrojtjen e bimëve. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), nuk ka kryer analiza cilësore të PMB-ve, (për mungesë fondesh, *njoftuar me shkresë zyrtare dhe njoftim elektronik*) dhe për këtë arsye nga AKU për vitin 2018 nuk janë marrë mostrapër kontrollin cilësor të PMB-ve.

Regjistrimi paraprak dhe hedhja në treg e PMB-ve bazohet në kërkesa rreptësisht të përcaktuara, ku kërkesat dhe rregullat e regjistrimit do të vijnë të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme e në përshtatje dhe me legjislacionin Europian për PMB-të.

Është e rëndësishme që të krijohen kushte lehtësuese për regjistrimin e një kategorie të caktuar

³¹ PRKE 2020

të PMB-ve si:

- Rregullatore e re e rritjes së bimëve, induktuesit e rezistencës.
- PMB-të bio me origjinë bimore, kërpudhore, bakteriale dhe virusale.
- Një gamë më e gjërë e herbicideve, pasi ende vazhdohet që të mos kenë vendin e duhur në përdorim tek ne.
- Stimulim i regjistrimit të PMB-ve të grupeve të reja kimike (brenda grupit të Insekticideve, Akaricideve, Nematocideve dhe Fungicideve) dhe që kanë impakt sa më të vogël mbi mjedisin ku përdoren dhe që lënë me pak mbetje tek bimët dhe produktet bimore, tek të cilat përdoren këto herbicide. Mosparashikimi i konstatimit i PMB-ve të skaduara në njësitë e tregtimit me pakicë, të vendosura për tregtim jashtë afatit të përdorimit dhe masat administrative përkatëse, sjellin probleme në farmacitë. Bllokimi në njësitë e tregtimit me pakicë nuk i jep zgjidhje problematikës, pasi përbën rrezik si dhe krijon problematika në marrëdhëniet midis grupeve të interesit të tregtimit të PMB-ve. Në procesin e ambalazhimit dhe paketimit të PMB-ve në vendin tonë, është e nevojshme që importuesit të zbatojnë kërkesat ligjore për vendosje direkt në ambalazhe dhe të realizojnë etiketimin në gjuhën shqipe dhe të kuptueshme. Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit, garantohet jo vetëm nga përdorimi i PMB-ve, por dhe nga produktet plehëruese për ushqyerjen e bimëve, përmirësimin e cilësive fiziko-kimike dhe rritjen e pjellorisë së tokës. Ky proces arrihet nëpërmjet përcaktimit të rregullave për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe organizimin dhe funksionimin e strukturave përkatëse.

Gjatë periudhës objekt auditimi, Ligji nr. 10390, datë 03.03.2011, òPër plehrat e përdorimit për bimësinë së bashku me paketën nënligjore, nuk i është përgjigjur në nivelin e duhur trendit të ri të regjistrimit, tregtimit dhe përdorimit të plehrave dhe në shumë raste të tjera ka lënë hapësira për abuzime, sidomos tek kategoria òEC Fertilizersò, të cilat zenë pjesën më të madhe në sasi dhe llojshmëri të plehrave që importohen, duke lejuar përdorimin e tyre pa u regjistruar më parë. Plehra të regjistruara (jo òEC Fertilizersò) për vitet 2018-2019 janë 341 lloje plehrash³² deri në Janar 2020. Ky ligj nuk ka patur të përcaktuara rregulla të qarta për, prodhimin e produkteve plehëruese në vend, kontrollin nga prodhimi deri te përdorimi, procedurat e regjistrimit të plehrave për përdorim për bimësinë, tregtimin dhe etiketimin e tyre. Ndryshimet dhe reformat e zbatuara vitet e fundit në MBZHR, kanë bërë që të mos të ketë ndarje të qarta të përgjegjësisë dhe kompetencave për menaxhimin, monitorimin dhe analizimin e produkteve plehëruese. Në MBZHR nuk ka patur të përcaktuar strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e plehrave për përdorim për bimësinë.

Pavarësisht legjislacionit aktual, problemet e hasuara në lidhje me inputet bujqësore ku përfshihen tre grupet (plehërat për përdorimin e bimësisë, materiali mbjellës dhe shumëzues bimor dhe produktet për mbrojtjet e bimëve), nxjerrin në pah domosdoshmërinë e trajtimit sipas një paketë më të plotë ligjore dhe një strukture të mirë përcaktuar për hartimin, implimentimin dhe monitorimin e saj, si në nivel qendror dhe lokal.

Për rritjen e nivelit të sigurisë lidhur me mbetjet e PMB-ve në bimët dhe produktet bimore, *sistemi i gjurmueshmërisë duhet të identifikojë trajtimin e fundit me PMB para vjeljes*. Fermerët në disa raste mbeten të pamonitoruar në përdorimin e PMB dhe si rezultat nuk respektohet kategoria, përdorimet jashtë etiketës apo tejkalimi i dozave të përdorimit.

MBZHR për periudhën e auditimit ka patur programe buxhetore për investime të huaja dhe të brendshme, si dhe një Grant nga BE me objekt "Fuqizimi i laboratorëve të sigurisë ushqimore"

³² <https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Lista-e-plehrave-janar-2020.pdf>

si pjesë e programit IPA 2013 me vlerë 1,3 milion lekë, por konstatohet se nuk ka të programuar e zbatuar asnjë program buxhetor për investime nga burime të brendshme apo të huaja për sigurinë ushqimore dhe veçanërisht për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrollit të PMB-ve.

Mungesa e dhënies së rëndësishme që ka siguria ushqimore dhe kontrolli i zinxhirit të tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve, ka sjellur si pasojë, që ky proces të lihet në aspektin dytësor e tretësor të politikëbërjes së MBZHR dhe mos të kemi financime me program investimesh afat shkurtër dhe afatgjatë.

Megjithëse Qeveria Shqiptare, në planin e buxhetit të MBZHR-së dhe institucioneve të varësisë që janë pjesë e detyrimit ligjor për kontrollin, monitorimin e tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve, për tre vitet 2018-2020 i ka mbështetur me fonde dhe numër punonjësish, nga institucionet e mësipërmenuk është bërë plotësimi i duhur i trupave kontrolluese e monitoruese respektivisht: viti 2018 me 21 punonjës më pak, krahasuar me planifikimin, viti 2019 me 36 punonjës më pak, krahasuar me planifikimin dhe viti 2020 me 27 punonjës më pak, krahasuar me planifikimin. Kjo tregon paaftësi menaxhuese të burimeve njerëzore dhe mungesë planifikimi të pabazuar në nevojat objektive në përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Angazhimi i plotë i MBZHR-së dhe strukturave përgjegjëse të cilat janë pjesë e zinxhirit të menaxhimit të PMB-ve, me qasje të re e më të përgjegjshme drejt përafrimit të politikave bujqësore me BE-në, si dhe në mbështetje të të gjitha grupeve të interesit, do të ndikojë në perceptimin pozitiv të qytetarëve lidhur me përdorimin e PMB-ve dhe sigurinë ushqimore. Kjo ndikon në garantimin e shëndetit të tyre dhe rritjen e cilësisë së jetës, si një kusht drejt integritetit evropian.

GRUPI I AUDITIMIT:

B.L., p/grupi

M.L., anëtare

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A. J.